

Diktatori

AGRON BAJRAKTARI

AGRON BAJRAKTARI

DIKTATORI

Novela

UEGEN

Redaktor: Dr. Eris Rusi

Shtëpia Botuese UEGEN, Tiranë, 2017

Design: Studio grafike UEGEN

www.uegen.com

uegeni@gmail.com

©: Autori & Shtëpia Botuese UEGEN

ISBN 978-9928-0.....



Unë dhe unë

Pra, ti do të dish se kush i ka shkruar këto fjalë? Të them të drejtën, nuk e di nëse unët e dytë supozohet ta dinë ekzistencën e tyre, por ja që unë e di. Fakti që shprehem kështu mund të quhet tekë e fatit, ose e rastësisë (nëse s'beson në të parën), por çfarëdo që të dish për Agronin, mos e beso! Unë nuk jam ai! Në fakt ai është Agroni i vërtetë, por bëmat që tregohen janë të miat. Ekzistenca e një uni të dytë, e imja, tregon se ai nuk i ka këllqet e duhura për të përjetuar ato që prrallit me fjalë. Pra, shënoje: unë jam Agroni!

Lindja ime mund të quhet lojë e fatit ose e rastësisë (zgjidh sipas rehatisë), por qëndrimi im në jetë është përtej të dyjave. Që të shpëtosh nga një not i padëshiruar, duhet të mbytesh. Dhe një mbytje e vlefshme, është ajo e cila në vend që të të vdesë, të ringjall. Unë jam mbytja e Agronit! Por që të kup-



tosh krimin tim, në fillim duhet të flas për frikën e tij ndaj ujit.

Agroni e dashuron notin. Sa herë që uji ftues i detit i shfaqet para syve, ai turret menjëherë drejt dallgëve dhe pluskon mbi to, herë duke lëvizur krahët e përzhitur nga dielli, herë duke ndenjur pa lëvizur, me detin që kujdeset për mosmbytjen e tij. Por ai ka një dëshirë të tmerrshme brenda vetes. Një që e gërryen si uji shkëmbin. Ai do që të zhytet.

Do që të kridhet në thellësinë e errët të ujit, por nuk mundet. Ka frikë! Frikë nga mendimet, nga vetë imagjinata kur ta ketë kokën nën ujë.

Ai nuk ka frikë nga monstat e detit. Ka frikë nga monstat e mendjes. Por unë i them se që një monstër të vdesë, ai duhet të përballet me të, ta mbysë.

(Zhytu! Zhytu!)

Por ai nuk më dëgjon dhe trupi i tij i lëmuar nga rrezet pluskon qetazi mbi detin e rehatisë, duke harruar se monstat nuk vdesin thjesht sepse ne vendosim të mos përballemi me ta. Monstat janë përherë aty, në errësi, duke pritur momentin e duhur për të dalë në sipërfaqe e të gllabërojnë çdo gjë që u del përpara.

(Zhytu! Zhytu!)

Ai e ka dashuruar gjithmonë detin. Që në vogëli, kur i ati e merrte me vete, ai u rrëmbye çmendurisht pas ujit dhe qiellit. Dielli përvëlues, zhurma e ëmbël e dallgëve, anijet në horizontin e pakapshëm, freskia



e pishave që përkëdhelen nga flladet e perëndimit; ai mendoi se kjo ishte parajsa. I klasifikoi të gjitha: pulëbardhat ishin engjëjt, rëra ishte livadhi i premtuar dhe pasditeve bëhej hesapi i mrekullive, kur të gjithë mblidheshin rreth zotit, diellit, e mallëngjehe-shin nga rrezet e fundit të dashurisë. Dhe deti!

Deti ishte imagjinata e zotit, e ai kridhej çdo ditë në ujërat e tij. Notonte e pluskonte, por asnjëherë nuk zhytej. Kishte frikë. Frikë nga monstat.

(Zhytu! Zhytu!)

Por ai nuk zhytej. Parajsa mjaftonte e tillë. Pastaj zoti kishte thënë se atje në thellësi lëngonte ferri. As drita e tij nuk hynte aty. Ç'të kërkonte ai në atë vend? Atje kishte djaj. Dhe kështu notonte mbi det, mes diellit dhe errësirës, mes parajsës dhe ferrit, me shpresën se monstat e thellësisë nuk ishin monstat e frikës së tij.

Pikërisht këtu fillon historia ime. Unë jam Agroni! Unë jam monstra e errësirës, blasfemia e parajsës së premtuar.

Unë jam frika e Agronit!

Ai nuk u zhyt dhe në fund monstra doli nga thellësia. Por ai nuk e di këtë. Ai mendon se një frikë e braktisur është një monstër e shkatërruar. Gabim, Agron! Gabim! Një frikë e braktisur është një monstër e krijuar. Por ti vazhdo dhe plusko, largoji sytë nga errësira. Parajsa mbetet parajsë, për sa kohë harrohet ferri.



Dhe ai noton, e bashkë me të zoti shkëlqen, pulëbardhat këndojnë e pishat vazhdojnë të përkëdhelen nga të tjera flade perëndimesh. Por kur nata bie, kur ai fle, unë dal krahëhapur në errësirën e pamasë dhe... zhytem!





Diktatori

Zotëri, më falni, është kjo ndenjëse e lirë? Falemin-derit... Sa bosh sot ky tren. Të më ndjeni, flas shumë. Sidomos kur udhëtoj me tren. Ja përse s'mund të ulem në sedilje vetëm; do mendonin se jam i çmendur. A jam? Sigurisht që po. Por s'dua ta marrin vesh të tjerët.

Do të jeni duke menduar me vete, vallë përse nuk do të donte njeriu të mos qëndronte në qetësi gjatë një udhëtimi me tren. Tek e fundit, arsyeja përse trenat ekzistojnë nuk është transporti, por të menduarit në heshtje, pa lëvizur, ulur ndenjor në një sedilje që nuk e ka kontrollin e makinerisë. A nuk është çliruese ndjesia e të lëshuarit në muskujt e vëmendjes; të lejosh për pak kohë që njerëz të panjohur të jenë në kontroll të jetës sate? Çliruese, apo jo? E frikshme, kur e mendon pak më thellë, por çliruese. Por nganjëherë gjërat e frikshme janë ato me



çlirueset. Natyrë e çuditshme kjo e jona. Sigurisht, ama, nëse këtë e shohim me pasqyrën e logjikës. Çdo gjë që e quajmë të çuditshme e quajmë të tillë thjesht sepse nuk përkon me atë që na thotë logjika. Por vë bast që edhe logjika, kjo gjë kaq e prerë dhe e ftohtë, është e ndryshme te ne të dy. Çfarë? S'e besoni? Pra, ju jeni i mendimit të zakonshëm që ajo mbretëron kudo njëlloj. Mirë bëni. Dy plus dy bëjnë katër si në këtë vagon, ashtu dhe në tjetrin. Sidoqoftë, unë e kisha fjalën për diçka tjetër... E vlerësoj që po ma zgjasni dorën, por më mirë le të mos prezantohemi. Shkëmbimi i emrave e bën çdo gjë më personale. Më mirë të mbesim të huaj. Sigurisht, të diturit e emrave të njëri-tjetrit nuk është se na jep ndonjë informacion të madh për atë çka jemi në të vërtetë, por përsëri jep diçka. Më mirë të mbetemi të huaj. Me siguri që në majën e gjuhës suaj keni pyetjen përse. Përgjigja është shumë e thjeshtë. Të huajit, një të huaji kaq perfekt sa ju mund t'i them çdo gjë fare lehtë. Sigurisht që koha nuk na premtonte që t'ju them çdo gjë, fundja ky është një udhëtim i shkurtër, por edhe në kaq pak kohë mund të përmbledhet në fije të holla struktura e kësaj gjithçkaje që gumëzhin në mendjen time, dhe unë dua, që në fund të këtij udhëtimi, të mos mbaj asgjë me vete. Nëse zbrazem tek ju dhe e di se kush jeni ka gjasa që më vonë të pendohem, dhe në bazë të emrit ta gjej se ku jetoni dhe të vij e të marr atë çka ju kam dhënë. S'e dua këtë. Dua që kur të zbres nga



ky tren, atë që ta jap, ta jap përgjithmonë. E bukur kjo fjalë, ë? Përgjithmonë. Ka kaq shumë premtim në të, është një gënjeshtër aq e bukur, sa duhet të jetë se s'bën e vërtetë.

Nuk besoni tek e gjithmonshmja? Pra, na qenkeni skeptik. Mirë. Pikërisht për një bashkëbisedues të tillë kisha nevojë. Monolog, do të jeni duke më korrigjuar në mendjen tuaj, por besomëni, nganjëherë monologjet janë dialogjet më të mira. Dhe përse jeni skeptik? Mos u përgjigjini, lejomëni mua. Në fakt, e ç'ka për t'u përgjigjur këtu. Mjafton të hidhni një sy drejt kohës, kësaj lavireje kaq të zhdërvjelltë, që ta kuptoni se e përjetshmja është iluzioni i atyre që nuk mund të mësohen me ndryshimin. Por kjo nuk është tërësisht përgjigjja: «...i atyre që nuk mund të mësohen me vdekjen»; ose, edhe më saktë, «...i atyre që nuk mund të mësohen me idenë e vdekjes». Ja, kjo është piktura e plotë e përgjigjes suaj. Por a nuk është pikërisht kjo arsyeja përse përjetësia është pasioni përfundimtar?

Interesante kjo punë: të mos besosh tek ajo që dëshiron më së shumti! Sigurisht, ama, besimet tona ndryshojnë nga momenti në moment në bazë të interesave të çastit. Ja, për shembull, ju tani me siguri jeni duke dëshiruar që unë ta mbyll gojën. Jo? Sa i sjellshëm që jeni. Por nuk keni përse të tregoheni i tillë. Mirësjellja mbivlerësohet. Në përpjekje për të qenë përherë i mirë ju mund të bini në grackën e të



gënjyerit. Nuk mund të jeni i mirë me të gjithë, harrojeni. Do vijë një ditë kur do ju duhet të gënjeni, ose përndryshe do ia thyni zemrën tjetrit me fjalët tuaja të vërteta. Le të tregohemi të rritur. Interesante kjo fjali: le të tregohemi të rritur. Do të thotë që vetëm të rriturit na e paskërkan monopolin e të qenit të vërtetë. Dhe, ironike ose jo, pikërisht këta nuk janë të vërtetët. Ja, ju me mirësjelljen tuaj, a nuk detyroheni të gënjeni thjesht sepse nuk doni që t'ia thyni zemrën bashkëbiseduesit? E ku ka maturi në këtë veprim? Pse, ky është thelbi i «le të tregohemi të rritur»? Pallavra, zotëri. Them, e s'dimë se ç'them. Në këtë rast, vetëm një qenie mund të jetë me të vërtetë e drejtë: fëmija. Sepse, mes të qenit i drejtë dhe të qenit i mirë ka një ndryshim të madh. Mund të jesh i drejtë dhe i keq, por asnjëherë të jesh edhe i mirë, edhe i keq. Dhe fëmija mund të tallet me ty, sepse ashtu është ai, moskokëçarës, s'do t'ia dijë për kërcënimet e tua boshe prej të rrituri. Ai ta thotë të vërtetën troç në fytyrë. Kjo, sigurisht, deri në momentin kur t'i futësh në kokë ato idetë e tua të mëdha prej të rrituri dhe ta detyrosh që të dëshirojë të bëhet si ti. Pra, nga të drejtë, e ktheve në të mirë. Sa shumë që e duam këtë të mirën, ë?

Do të ishte e padrejtë nëse do të thosha që unë nuk gënjej. Në fakt, unë jam ndër njerëzit më gënjeshtarë që kam njohur ndonjëherë. Jam bërë plotësisht i vetëdijshëm për këtë gjë vetëm kohët e



fundit, besojeni. Mund të jeni duke pyetur me vete (sepse jeni shumë i sjellshëm për të pyetur me fjalë) se si ka mundësi që zgjati kaq shumë? Më lejoni t'ju kundërshtoj. Siç e shihni dhe vetë, jam akoma i ri. Sidoqoftë, jam i mendimit që nuk mund të quhet «shumë», përderisa e kam zbuluar tashmë. «Shumë» është atëherë kur e zbulon diçka dhe, nga frika prej asaj që ke zbuluar, ose thjesht nga indiferenca, ti e lejon të ikë përsëri dhe i rikthehesh avazit të përditshëm. Por fakti që unë ndodhem në këtë tren është prova ime më e fortë që nuk është dhe aq vonë për mua. Jam duke u larguar nga ai që kam qenë, kjo është lidhja e këtij treni me gënjeshttrat e mia. Me të kam ardhur në këtë qytet, para shumë vitesh, dhe me të po largohem. Siç thotë dhe një filozof që e kam përzemër, disa veprave (unë guxoj t'i ndryshoj fjalët e tij e të them: disa jetëve) u dihet fundi që në fillim. Ajo që dua të them, është se disa fillime janë të njëjta me fundet e tyre. Fillimi i gënjeshtrave të mia? Më në fund një pyetje e vërtetë! Në fëmijëri, e kur tjetër. E kuptoj rrudhjen e ballit tuaj mosbesues. Nga njëra anë them se fëmija është qenia më e vërtetë, ndërsa nga ana tjetër broçkullis se karriera ime si gënjeshtar paskërka filluar në fëmijëri. Do të çuditeshit se sa shumë ndërlidhen gënjeshttra me të vërtetën. Pikërisht në fëmijëri kuptova se me anë të broçkullave mund të kuptoja të vërtetën e njerëzve. Kjo është si të thuash: e zbulova etjen për ujin duke



luajtur me zjarr. Pa kuptim? Skepticizmi juaj mund të luftohet vetëm me shembuj.

Si shqiptar që jam, që në vegjëli me është ushqyer koncepti i rëndësishëm i besës. E dëgjoja aq shpesh, saqë ajo ishte për mua si një zot në vete, një tokëz e paarritshme nga mendja, por që e gjeja përherë në sytë dhe veçanërisht në gojën e të rriturve përreth. Dhe isha aq shumë i fiksuar që ta përvetësoja atë veti, që t'i bëja krenarë të tjerët, saqë njëherë, kur isha me familjen në plazh, ndodhi diçka që mund ta them me plot gojë se ishte pika ime e kthimit në atë që po mundohem të braktis tani. Gjatë pikut të mesditës, femijët detyroheshin me se s'bën të flinin. Ishte një traditë e filluar kushedi qëkur dhe e vazhduar verbërisht, si çdo traditë që ndiqet për të respektuar dituritë e të moçmëve. Por unë atë ditë s'flija që s'flija dot. Gjaku im femënor gurgullonte. Donte jetë, e ndjeja, veçse nuk mund ta kuptoja. E jetoja jetën, por nuk isha i vetëdijshëm për të.

Gjithmonë e kam cilësuar këtë gjë si dhuratën me të fuqishme të fëmijërisë. Sidoqoftë! Pra, këtë dhuratë unë e ndjeja nëpër të gjithë trupin. I mbyllja sytë, sepse kisha frikë mos merrja ndonjë të rrahur të mirë nëse ime më do hetonte se nuk jam duke fjetur, por sytë lëviznin gjithë shpejtësi poshtë qepallave, sa kisha frikë mos do më shpërthenin.

Ndenja ashtu për disa minuta, me sytë e mbyllur, kur papritur ndjeva praninë e një të rrituri. Si e dija



që ishte një i rritur? Nga frymëmarrja, sigurisht. Ke parë ndonjë vocërrak që shfryn gjithë shpirt, që thith ajër pa zhurmë dhe e nxjerr përjashta sikur të jetë duke nxjerrë gurë nga miniera? Se ç'ndodh me ajrin në brendinë e të rriturit, një dreq e di... Këtë të rriturin në fjalë, e ndjeja që po afrohej gjithnjë e më afër. U frikësova aq shumë, saqë hapa sytë, edhe pse u përpoqa me gjithë shpirt që t'i ndalja. I rrituri qeshi (ishte xhaxhai im) dhe bëri me gishtin tregues se sa i prapë po tregohesha. Dhe, që t'i bie shkurt, më detyroi... ose jo, nuk mund të them që më detyroi. Këtu qëndron tani e gjithë kleçka e historisë sime. Ai nuk më detyroi të flija. Ai më futi në grackë. Përmendi emrin e perëndisë sime, përmendi fjalën «besë». Pra, edhe pse ti mund ta shikosh sikur ai më detyroi që të flija duke më bërë që t'i jepja besën, për mua në ato momente ajo ishte një dhuratë, ishte një ftesë në mbretërinë e tij. Dhe e di më të fortën? Sapo nga goja ime dolën fjalët që përçuan besën se do të flija, dhe sapo xhaxhai doli nga dhoma, nuk u deshën më shumë se dy çapitje sysh që të më kaplonte gjumi. E kupton?! Ja, ky është momenti, kur duke qenë i vërtetë, kam gënjyer për herë të parë. Ky ka qenë çasti, kur perëndinë e padukshme të xhaxhait, të vërtetën absolute të jetës se tij, unë e përdora për të gënjyer trupin tim, për të gënjyer vetë mendjen time që të flinte. Deri pak më parë ajo nuk më kishte dëgjuar. I isha përgjëruar që të ma vinte veshin, se



përndryshe do të vuanim të dy nga ndonjë e rrahur e nënës, por vetja ime as që kishte pasur ndërmend të me dëgjonte. Por sapo u paraqit rasti madhështor për të njohur dhe përqaftuar të vërtetën hyjnore të të rriturve, tak-krrak, mendja ime u ça në dysh. U thye në mes, si një shpinë e vjetër, si një relikte antike. Një fëmijë? Në ato momente unë isha i lashtë, e mjaftonte një puhizë pranvere që të ma treste hirin e ndotur. Ky, i dashur zotëri, ka qenë momenti kur zbulova burimin e etjes së përhjetshme duke djegur veten vullnetarisht.

T'i gënjesh të tjerët? Është goxha e lehtë. E kam provuar sa e sa herë për të marrë atë që doja. Mbaj mend fjalët e fundit të sime mëje para se të vdiste. «Ke qenë një diktator i vogël», më thoshte, «por ke qenë diktatori im». E mrekullueshme dashuria e nënës, apo jo? T'i fal ato mëkate që vetes s'do t'ia falte dot kurrë. Ç'diktator mund të jetë një fëmijë? Në fakt, çdo diktator është një fëmijë. Cili është funksioni kryesor, ose më saktë qëllimi kryesor i një diktatori? T'i detyrojë të tjerët të bëjnë çfarë do ai. Pikërisht si fëmija. Nga kjo fare thjesht mund të dilet në përfundimin se çdo fëmijë është në vetvete një diktator, por që ka inferioritetin e trupit; nuk ka akoma as zërin e trashë e të thellë, as sigurinë e eksperiencës dhe, më e rëndësishmja, se ka vendosur ende siç duhet në jetë diktaturën e tij apo të saj. Sidoqoftë, me ato që më thoshte ime më, e kuptoja se



me të vërtetë kisha qenë një i tillë. Dhe s'kisha pasur fare nevojë për zërin e trashë. Ia fusja një kuje aty, një të qare gjithë ngashërimë, sa nga frika mos do pësoja ndonjë gjë, ata ma plotësonin çdo tekë që mendja ime feminare mund të imagjinonte. Edhe nëse dëshiroja që im atë të qëndronte në një këmbë para meje, ai e bënte këtë gjë. Por jam i sigurt se ai nuk ma bënte qejfin për të njëjtat arsye si të nënës.

Nëna, siç e thashë, është sakrifikuese, të nderon mëkatin me shpresën se do e shndërrojë në virtyt. Ndërsa ati, ai qeshte duke bërë të gjitha llojet e akrobacive për mua sepse shikonte një pjesë të vetes tek unë. Në sytë e tij shëmbëllehej dëshira më e madhe që trashëgimia e mendjes së tij të mbijetonte edhe pas asgjësimit. Nuk është e mjaftueshme që sperma vetëm të mbijetojë. Ajo duhet gjithashtu të jetë e njëjllojtë me burimin që e solli në jetë. Dhe shkëlqimi i syve të tij, ai shkëlqim i eksitimit që më kishte sjellë në jetë, ishte i njëjtë me atë që dëshmoja kur më plotësonte tekat.

Por, i dashur zotëri i huaj, diktatura, në vetvete, përtej çdo të keqeje që ndjell, ka vetëm një të mirë: është e vërtetë ndaj vetes. Secili diktator e bën atë që bën sepse e beson me të vërtetë. Dhe duke e besuar deri në asht, deri në koren e qenies së tij apo të saj, ai vendos të gjithë forcën e jetës për ta vënë në zbatim. Pra, edhe pse i çmendur, është i vërtetë.

Ai bën çdo gjë që ka në dorë për të qenë vetvetja.



Fakti që ka lindur i tillë është përtej tij. Nuk ka faj. Kush e ka fajin? Një dreq e di, edhe pse dyshoj ta dijë qoftë edhe ai. Sidoqoftë, nga kjo del që te fjalët e fundit të nënës sime për mua (fjalë të mëdha, apo jo? Kush është ai që mund të mburret se nëna e ka quajtur diktator në frymën e fundit, e përsëri t'i buzëqeshë?), mund të gjendet këshilla më e fuqishme që mund të më ketë dhënë ndonjëherë, edhe pse kjo fare e pavetëdijshme. Duke me rikujtuar formën time të vërtetë, atë të urdhëruesit, më tha që t'i rikthehem përsëri vetes. Por siç ta thashë pak me parë, unë e kisha prerë fijen lidhëse me veten në momentin që e kisha këmbyer shpirtin për një copëz gjumë. Pra, e thënë shkurt, unë kisha shitur shpirtin për t'u pranuar në botën e të rriturve.

Ah, po vijnë ëmbëlsirat! Doni një? E keni nga unë, ja, urdhëroni. E ç'janë dy para, harrojeni, kjo është fare pak krahasuar me praninë tuaj prej të huaji. E patë ç'këmbë kishte ajo shitësja? Jo? Sa keq. Sidoqoftë, ku e lamë? Tek shitja e shpirtit...

Të jesh i vetëdijshëm për diçka dhe të dish se ajo diçka ekziston, këto janë dy gjëra të ndryshme. Të parën, siç të thashë në fillim, s'ka shumë që e kam zbuluar; ndërsa e dyta, ajo u bë pjesë e imja që në momentin e Ndryshimit të Madh. Kisha zbuluar manipulimin e vetes. Dhe ky nuk ishte zbulim më pak i rëndësishëm sesa shpikja e rrotës. Në mos më i rëndësishëm. Mund të mendosh se tani më rrëmbeu eu-



foria dhe po e teproj, por imagjinoje pak: rrota mund të të transportojë nga një pikë e botës në një tjetër, por ajo s'mund të të fusë në zemrat e të tjerëve. Përshkimi i botës në rehati as që mund të krahasohet me ngrohtësinë dhe pasionin jetësor që ndjen kur njerëzit të rrahin shpatullat sepse je duke vepruar pikërisht siç dëshirojnë ata.

Nga kjo fjali, e shikoj tek picërrimi i syve tuaj, që po mendoni pikërisht për këtë gjë: që isha shndërruar në të kundërtën e asaj që isha në të vërtetë, pra, e thënë ndryshe, isha bërë një antidiktator. Picërrimi u largua; kjo do të thotë se këtë po mendonit. Pra, logjika e njerit vagon përkoka me të vërtetë me atë të vagonit tjetër. Sidoqoftë! Besoj se edhe ti e ke provuar vërshimin e vrullshëm të emocioneve kur e gjithë njerëzia të buzëqesh sepse je sjellë në mënyrën e duhur. Dhe ti mund të pyesësh fare lehtë: cila është mënyra e duhur? Ka vetëm një mënyrë t'i bësh të gjithë të buzëqeshin përnjëherësh: t'i kënaqesh të gjithë.

Mund të kesh dëgjuar ndoshta që kjo është e kundërta e suksesit, që është e pamundur t'i kënaqesh të gjithë sepse do të dali se s'bën një syresh të cilit i ndryshojnë tekat çdo sekondë. Por jo. Kjo tekë është e përhershme dhe e patjetërsueshme. Kot thonë që nuk ka natyrë njerëzore. Ka që ç'ke me të. Është pikërisht kjo për të cilën po flas; në palcën e shoqërisë ku jetojmë, që e gjithë kjo ndërmarrje kolosale, që filloi para dhjetë mijë vjetëve dhe s'duhet



dhe shumë që të përfundojë, duhet të ketë se s'bën disa themele që askush s'mund t'i kundërshtojë. Dhe s'mund t'i kundërshtojnë për faktin e vetëm se kanë qenë vetë ata që i kanë ndërtuar. Një arkitekt i zoti nuk del kundra punës së tij më të mirë. Dhe puna më e arrirë e këtyre njerëzve dhjetëmijë vjeçarë është se kushdo që zgjedh mënyrën e tyre të jetesës, është përherë i bekuar. Qoftë ai edhe një kriminel, edhe pse e dënojnë, në heshtje e bekojnë që të paktën e ka bërë krimin brenda kufijve të mënyrës së tyre. Por nëse ai është qoftë dhe një gjeni që mundohet të bëjë më të mirën për njerëzimin, por që rastis të mos i mendojë disa gjëra siç i mendojnë ata, që nuk i ka themelet absolute si të tyret por pak ndryshe, atëherë ata e kryqëzojnë. Nuk tregojnë pikë mëshire për të. Shndërrohen në formën e tyre primitive, në kafshë. Si të thuash ata janë të civilizuar vetëm brenda idesë që i kanë thënë vetes se ç'është një civilizim. Një hap larg atij kufiri dhe instinkti i shtazës brenda tyre kthehet turravrap. Dhe, për më tepër (lejomë të citoj përsëri atë filozofin aq të dashur për mua) ata përpiqen me gjithë forcë (dhe ja dalin) që të jenë të lumtur vetëm brenda atyre kufijve. Nëse papritur shfaqet nga asgjëja një mënyrë e re për të qenë i lumtur – sepse, këtë duhet ta sqarojmë, nuk ka vetëm një mënyrë për të qenë i lumtur; duhet të këtë të paktën po aq sa ka edhe njerëz, po për këta syresh, për këta arkitektë, të jesh i lumtur jashtë asaj që ata quajnë lumturi



është sikur të bësh gol nga jashtë fushës – pra, nëse shfaqet kjo mënyra e re, ata thonë «stop». Nuk quhet. Skualifikohesh. Je jashtë lojë. Të japin njëherë një paralajmërim, një karton të verdhë, por pastaj, po e përsërite, out!

Tani mund të pyesësh fare mirë, si mund të përjashtohesh nga një shoqëri që mbërthen çdo gjë që të kap syri? Me fjalë të tjera, si mund të jetosh larg shoqërisë, ndërkohë që shoqëria është gjithë çka është? Pyetje e goditur. Pyetja më e goditur gjer më tani. Nuk e besoj të ketë një përgjigje, ama; ose, përgjigje ka, por nuk më pëlqen. Është tepër e errët. Vetmia dhe vetëvrasja nuk kanë qenë ndonjëherë për mua. Diktatorët nuk e vrasin veten deri në momentin që besimi i tyre për madhështi shteron. Por kjo është kleçka: besimi për madhështi nuk shteron kurrë. Prandaj jam skeptik kur më thonë që filan diktator vrau veten. Ose ndoshta e ka vrarë. Tani që e mendoj, e paskërka një arsye përse diktatori mund të vetëvritet: kur të tjerët duan t'ia rrëmbejnë madhësinë. Ai (ose ajo) me parë pranon të vdesë me të, në pronësi të tij, sesa t'ia marrin të tjerët. Esenca urdhëruese përshkon edhe një hap: bëj çfarë të them unë, por mos guxo të më diktosh çfarë do ti. Vetiu lind pyetja, po urdhëruesit kush i urdhëron? Duhet të ketë se s'bën një fije të hollë ku janë të shkruara Dhjetë Urdhëresat. Do të ishte e mërzitshme të dëgjoje vetëm urdhra që vijnë nga epshi vetjak. Dhe fare mirë e shoh në fy-



tyrën tënde përgjigjen: ato fije, pikërisht ato fije janë themelet që sapo të përmenda.

Atëherë, më pyesni ju, si pres unë që ky tren të jetë shpëtimi im, kur mundësi arratisjeje nuk ka? Me pëlqen vëmendja juaj, o i huaj. Pikërisht për këtë arsye jam kaq i lumtur që jeni ju dhe jo një i njohur këtu me mua. Ky tren nuk është shpëtimi im. Mund të ketë qenë dikur, kur nuk kishte mjet më të shpejtë, por ja që sot aeroplani dhe helikopteri të gjejnë brenda minutës. S'kam nga t'ia mbaj. Atëherë, thoni ju, përse po ikni? Sepse, zotëri i dashur, çdo ikje nga një vend është një kthim te një tjetër. Edhe brenda kufinjve ka zona, të cilat, nëse ua gjen vendndodhjen, mund të jetosh në qetësinë tënde. Këtu puna bëhet paksa e koklavitur, sepse, ajo zonë nuk ka të bëjë dhe aq me faktin se jam duke u larguar fizikisht nga ky qytet. Zona për të cilën po flas është mendja. Tani, sigurisht që duhet ta sqarojmë që në fillim se, njeriu i civilizimit perëndimor, pasi zbuloi dhe pushtoi të gjitha botët e këtij planeti dhe pasi i shndërroi në shëmbëllimin e imazhit të vet (në esencë, puna që bën një zot), kuptoi që nuk mund ta ndajë truporen nga mendorja. Pra, i duhej t'i futej trurit e shpirtit, me çfarëdolloj mënyre, me çekan a me gënjeshtër. Nuk mjaftonte transformimi trupor. Duhej dhe ai më radikali, ai më i mrekullueshmi, t'i mësonte skllavërit ta dashuronin skllavërinë e tyre. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohej mbretërimi i përjetshëm.



Dhuna trupore arrin deri në caqet e vdekjes. Dashuria shpirtërore përshkon përjetësinë...

Pikërisht nga kjo përjetësi po përpiqem të arratisem. Një diktator që nuk do përjetësi! E kupton ku ka arritur puna?!

Shoh pakëz paqartësi në shikimin tuaj. Më lejoni t'jua kthjelloj. Nëse do ju pyesja tani, gjë që po e bëj, më mirë të jetonit përjetësisht por i sëmurë, i kontrolluar çdo sekondë nga doktorë që ju thonë se ç'mjekime duhet të merrni, se ç'operacione duhet të bëni (çuditërisht të gjitha në tru), apo të jetonit për një kohë të shkurtër, por shëndosh si kokrra e mollës, siç ju ka bërë e shtrenjta nënë, cilën do të zgjidhni?

Përgjigja është e vetëkuptueshme. E shoh tek merr frymë në sytë tuaj, në perden e zezë që sapo ju ra përtokë dhe ua qartësoi shikimin. Më në fund, mik!

o o o

S'e dija që ky tren ndalej në një stacion gjatë rrugës. E mendoja si një udhëtim të pandërprerë, prandaj dhe zgjodha këtë orar. Por e paskam pasur gabim. Se mos është hera e parë. Duhet të mësohemi me gabueshmërinë tonë, i dashur zotëri, edhe pse është një ndër gjërat më të bezdisshme për njeriun. Ta mbash veten për leshko, ndërkohë që e mendon veten si



shëmbëlltyrën e zotit, nuk është dhe aq e lehtë.

Sidoqoftë, shpresoj të mos vijnë shumë njerëz në kabinën tonë. Përse? Siç ta thashë në fillim, s'dua të më pandehin të çmendur nga ato që them. Por kjo s'përbën dhe aq problem për mua. E shikoni se unë flas me zë të lartë. Më tepër dua të mos e ndot imazhin tuaj. Përse do ta ndotja imazhin tuaj? Na shikoni, ju lutem, jam një çunak në krahësim me ju. Akoma s'kam kaluar gjysmën e të njëzetave, ndërsa ju duke-ni fare lehtë kaluar gjysmës së shekullit. Po habiteni? S'më pandehët kaq? Mos ju ndryshoi mendimi ndaj bisedës? Mos tani që morët vesh për djaloshërinë që përshkon dejet e mia, e gjithë biseda s'ka më kuptim, sepse, në asnjë mënyrë s'do ta lejonit një çunak t'ju fliste për të tilla gjëra, ndërkohë që ju i keni provuar të gjitha në atë kurrizin tuaj të bërë butak nga pesha e kohës? Është mjekra, e di. Ajo më bën më të vjetër. Interesante se si leshi tregon maturi...

Pra, nuk u habitët nga mosha ime, por nga fakti që në një moshë të tillë po flas të tilla mendime. Në vend që të jem duke shijuar nektarin e ëmbël të fuqisë rinore, pyesni ju veten, pse dreqin po largohem nga një qytet kaq i madh, në të cilin mund ta gjej fare lehtë atë nektar, pasi aty mbledhen lule nga çdo anë e botës. Për me tepër, ç'dreqin dua që kthehem në Shqipëri! Të thashë në fillim, po i largohem përjetësisë. Por ka dhe një arsye tjetër, këtë ju e nuhatët, sepse, as Shqipëria nuk përjashtohet nga qytetërimi që



ajo përpiqet të kopjojë në çdo hap. Fjalët tuaja janë kaq të vërteta, sa që vetëm një arsye mund t'i mundë: vdekja, pikërisht e kundërta e përjetësisë; po kthehem për një varrim. Kush? Një nënë, një mike, një fëmijë. E ç'rëndësi ka kush vdes, përderisa shkaktarja e saj nuk është fundi i kohës! Nëse diçka nuk mbaron në mënyrë të natyrshme, kjo do të thotë që kemi futur ato duart tona të ndyra për ta përçudnuar sipas tekave tona. Gjithmonë më ka mahnitur fakti se si një realitet objektiv mund të përdhunohet në këtë mënyrë nga subjektivja... Prandaj, më thoni, ju lutem, si mund të jetoj ndër kohë që jeta përdhohet? Nëse do të ishit i fundit njëri në botë, do të kishte rëndësi jeta për ju? E natyrshme: jeta pa njerëzit, në një pikë a tjetër, bëhet e padurueshme. Pra, në vend që të palloj nektaret e luleve të rinisë, preferoj të revoltohem.

Kur u zgjuat këtë mëngjes, me siguri që nuk e menduat se do të takoni një diktator në revoltë. Zakonisht ndodh e kundërta, të tjerët ngrihen në revoltë kundër tij. Por ja që gjithçka është kokëposhtë tashmë. Vdekja në mënyra të pazakonta është bërë aq e zakonshme sa që shprehja e dashurisë duket si mëkat. Dhe ju e dini se ç'të bën mëkati. Të bën të turpshëm, të kthen drejt heshtjes dhe nga frika mos të bëjnë me gisht, nuk e përsërit më. Pra, ne nuk e përsërisim dashurinë. Por shumëzohet vdekjen. E kanë vrarë këtë miken time? Pyetje me vend. Por ç'është vdekja, ju pyes? Mjafton të marrësh frymë që të quhesh i



gjallë? Teknikisht po. Por e kam fjalën, nëse i ke vënë vetes detyrën që të udhëheqësh ose të jesh pjesë e një qytetërimi, atëherë kjo nuk është e mjaftueshme. Pra, duhet të ketë dhe një shpirt, një mendësi që e përcakton njeriun e gjallë. Një majmun lakuriq, apo një majmun i veshur me kostum të shtrenjtë: ma thoni pakëz diferencën? Mikja ime u vra nga majmunët e veshur me rroba të shtrenjta, ja si u vra ajo. Kjo është diferenca.

Pas pyetjes *kush*, vjen përherë pyetja *pse*, apo jo? Pra, pse e vranë? Lejomëni t'jua kthej pyetjen: quhet vetëvrasja vrasje? Ja të marrim si shembull një djalë të ri, që pasi iu përdhos nderi nga filan njeri, ai e vrau atë. Si pasojë djali vihet në burg. E kuptueshme. Arsyja e vdekjes së viktimës? Përdhosi nderin e tjetrit. Pyetja ime është kjo: a quhet vetëvrasja vrasje nëse shkaku i saj është i heshtur, s'bën aq bujë sa nderi i humbur, por është i shurdhër, është i mbrujtur ndër vite në kokën e vrasësit të vetes? Sepse, që një njeri të zgjedhë papritur që jeta s'ia vlen më të jetohet, kjo është ngjarje e madhe. Do të thotë që ai ose ajo e paskërka gjetur më në fund përgjigjen e pyetjes që na zbardh flokët, se ç'kuptim ka jeta! I vetëvrari na e tregon me shembull që s'paskërka. Por kur vjen ai moment që një jetë e re, në kulmin e rinisë dhe energjisë së vet, vendos që papritur të zgjedhë asgjënë? Kur njerëzit s'kanë kuptim, ja kjo është përgjigja që po kërkon jashtë dritares. E thënë shkurt, i dashur



zotëri, bota mund të jetë e njohur vetëm nëse njerëzit na lejojnë që ta njohim veten. Në esencë, universi ku jetojmë nuk na e përmbush nevojën për të gjetur kuptim. Kështu që na mbetet vetëm njeriu. Vetëm tek njerëzit që na rrethojnë, te shoqëria ku jetojmë mund ta gjejmë shpëtimin e mendjes nga çmendia. Mikja ime nuk mundi ta duronte dot vrasjen e përditshme që i bëhej shpirtit të saj. Kishte heshtur gati çdo ditë, kishte luftuar përherë me një revoltë të heshtur, por erdhi një ditë kur fija u shkëput dhe vendosi të zgjedhë heshtjen e përhershme.

Unë? Unë po shkoj të çoj respektet e mia të fundit.

Gjithashtu dhe të vendos diktaturën time. Mund ta mohoj sa të dua, por ky jam unë. Ti thua që s'do më lejojnë? Që do më vrasin? Edhe mund ta bëjnë. E kanë bërë dhe më parë. Por, vallë, i nderuar mik, a nuk kam të drejtë ta vë diktaturën time? Ç'kërkoj fundja? Të mbretëroj mbi atë që më takon: mbi veten time. S'jam duke kërkuar më shumë. As në fëmijëri nuk kam kërkuar ndonjëherë më shumë. Edhe nëna, kur më quajti ashtu, më quajti sepse e kishte parë dellin tim për të qenë zaptuesi i vetëm i vetes sime. Por e harrova mbretërinë time, e harrova kur rashë në gjumë diktator dhe u zgjova skllav. Por tani jam duke u kthyer. Jam duke kërkuar mbretërinë time mbrapsht. E nëse më vrasin rrugës, e çë? Revoltën time s'mund ta lë të heshtur. Dua gjak. Dua që djersa ime t'ua mbulojë fytyrën armiqve të mi, padronëve



të shpirtit tim të fjetur. Edhe nëse më mbysin, dua që të paktën të jem padroni i vdekjes sime. Fryma e fundit në qoftë, dua që ajo të jetë e imja!

Të më ndjeni, ju lutem, për zellin e tepruar. Erdhi fundi i udhëtimit dhe e ndjej që tani pezmin e tokës që kam për të shkelur. E ndjej që kërkon të më zaptojë përsëri, kërkon gjakun tim, sepse në dheun e vet ajo pandeh se unë jam i saj, që rastësia e lindjes sime brenda atyre kufinjve sikur i jepkërka një lloj autoriteti mbi të ardhmen time. Por ajo ende se di që kam ardhur për të rigjetur atë që kam humbur.

O do kalbem në fund të saj, o do fluturoj drejt qielit, i lirë me në fund nga skllavëria. Lamtumirë, zotëri i huaj. Të uroj atë që ja uroj dhe vetes: revoltohu, miku im. Ndaj vdekjes, ndaj jetës, ç'të jetë, kërko dhe gjej diçka ndaj së cilës të revoltohesh. E kur të mbarosh me këto, do të jesh gati për luftën e vërtetë; do të jesh gati për t'ju kundërvënë vetes. Të gjitha betejat e tjera janë veçse përgatitje për këtë.

Por ju i dinit të gjitha këto, apo jo? E shoh në shikimin tuaj. Ju jeni kaq i sjellshëm, më keni lejuar të flas gjatë gjithë udhëtimit, edhe pse pikërisht këto janë arsyet pse kurrizi ju është bërë më i butë se barku! Se nuk ju kam pyetur, ç'harraq dhe egoist që u tregova: po ju? Përse po ktheheni? Po ktheheni, apo jo? Atëherë, përse? Diktator edhe ju? Ah, tani e kuptoj përse heshtët. S'është hera e parë që e keni bërë këtë udhëtim, apo jo? Kështu është kjo



mesele? Shko e kthehu? Pra, s'mbaroka kurrë. Një betejë e humb, një tjetër e fiton? Ashtu qoftë! A më shkurajuat? Përkundrazi. Tani të paktën e di se ia dilet kësaj loje. Ju jeni prova ime. Dhe kjo mjafton... Ndoshta do të takohemi përsëri në këtë tren. Ndoshta do na përkojnë humbjet e betejave në të njëjtën ditë, por deri atëherë... Lamtumirë, i nderuar. Lamtumirë deri në betejën tjetër!







Kulla e ngujimit

A skush nuk e dinte nga kishte ardhur. Të parët e kishin parë disa fshatarë që po lëvronin tokën qindra metra jashtë fshatit. I kishte përshëndetur me kokë, pastaj kishte vazhduar rrugën pa u ndalë. Fshatarët, kishin menduar se ai po merrte atë rrugë kalimthi, por kur ishin kthyer, banorët e tjerë u kishin folur për një të panjohur të çuditshëm që kishte hyrë në kullën e ngujimit e nuk kishte dalë më që andej. Të habitur kthyen kokën andej, vendosën dorën në ballë në formë strehe për të penguar fijet e fundit të diellit dhe picërruan sytë që të kapnin sadopak siluetën e të panjohurit.

Edhe i panjohuri kishte harruar nga kishte ardhur. Nuk është se nuk e mbante mend, por e gjitha shfaqej aq rrëmujshtë në mendje, saqë veç një ndjesi e vakët e diçkaje nga e cila donte të arratisej, i regëtinte diku në brendësi.



Për t'u arratisur, kishte marrë udhën, një udhë të panjohur, ashtu siç ishte ai për fshatarët që sapo kishte takuar rrugës.

Në fund të kësaj rrugice, kishte arritur në një fshat. Disa dhjetëra shtëpi, të ndërtuara afër njëra-tjetrës, gumëzhnin nga njerëzit që merrnin e jepnin me jetët e njëri-tjetrit. Në të djathtë të fshatit kishte parë një kullë, e cila, për një çast fare të shkurtër, i kishte ndjellë një ndjesi të harruar qyshkur. Ashtu i rraskapitur siç ishte, kishte marrë drejt saj. Përreth kullës toka ishte djerrinë. Barishte, ca pemë të kalbura dhe zogj të ngordhur që pështirosnin ajrin përreth e detyruan të mbante fytyrën të zhytur në mëngë gjithë kohës. Atmosfera nuk ndryshoi as kur hyri brenda. Nuk kishte pothuajse asgjë, përveç disa shkallëve të pjerrëta, që të çonin një kat më sipër. Ngjiti shkallët, vetëm për të zbuluar se ai kat ishte si ai poshtë, gjithashtu me shkallë që të çonin më lart.

Dyshemeja nuk qe e lagur dhe rrezet e fundit që thyheshin në ngjyrën e kadifenjte të drurit të kalbur, reflektoheshin në sytë e tij. Gjithë kujdes, provoi me këmbë vendet e sigurt ku mund të shtrihej dhe pasi gjeti një cep mjaftueshëm të qëndrueshëm, u shtri për të fjetur. Kur u zgjua, asgjë nuk kishte ndryshuar. Kalbëzimi i drurit, tek e shihte ashtu me sytë e mbufatur nga gjumi pa ëndrra, i dukej i njëllotë me atë që ndiente përbrenda.

Fërkoj sytë me duart e mbledhura grusht dhe pas



një hopi vuri re në cepin kundruall, një lopatë që mbështetej e heshtur në mur. E mori në dorë, e solli në ajër disa herë, dhe pasi pa që ajo ishte në gjendje, mendoi se do të ishte mirë të punonte tokën rreth kullës.

Kur doli jashtë, dielli përcëllonte. Hoqi bluzën e rreckosur, dhe lëkura sikur mori frymë më lirshëm. E hodhi rrobën diku tutje, vendosi kapelën dhe iu fut punës. Mbaroi aty nga mesdita. Ajo që i ishte dukur sikur do të mbaronte vetëm pas disa ditësh, kishte mbaruar brenda disa orëve, ndaj ndihej krenar me veten. Barishtet i kishte mbledhur në një vend dhe duhej vetëm një shkrepëse për t'i tretur në flakë. Në fillim mendoi që të digjte gjithashtu edhe trupat e kafshëve të ngordhura, por pastaj ndryshoi mendje.

Hapi disa gropa të vogla, futi trupat e braktisur nga jeta dhe i mbuloi përsëri me dhé. Për të zgjidhur problemin e ndezjes së zjarrit iu desh të mendohej disa minuta. Pasi nuk gjeti ndonjë zgjidhje, mendoi se do ishte mirë të kërkonte në fshat. Me siguri që fshatarët do e ndihmonin.

U rregullua në mënyrën më të mirë që mundej, drejtoi rrobat, pastroi fytyrën me ujin e një rrëkeje të vogël aty pranë dhe me një buzëqeshje krenare për punën e bërë, mori drejt fshatit.



o o o

Jetën e fshatarëve vështirë se mund ta trazojë nga përditshmëria e saj, por ky i panjohur, përveçse përbënte një risi, nga fakti se ku kishte vendosur të jetonte dhe për më tepër, pa pyetur askënd, ishte gjithashtu dhe një shqetësim.

Kjo për faktin sepse ai ishte i panjohur. Nuk ishin mësuar më të tillë gjë. Aty të gjithë njiheshin. Të gjithë e dinin se kush ishte kush, kush donte apo urrente kë, se cili zot ishte i njërit dhe cili i tjetrit. Madje, njohja e tyre shkonte deri në atë pikë, sa e dinin ç'mendonte tjetri. Nuk ishte çudi që ky i panjohur, përbënte një shqetësim.

Kur ai u kërkoi një shkrepëse, në fillim ata u stepën. Ç'do të bënte vallë me të? Mos do të vinte ndonjë zjarr dhe fshati i tyre do të shkrumbohej? Por kur panë buzëqeshjen e tij të pafajshme e paqësore, mendimet iu zbutën dhe bujaria (e trashëguar ndër gjenerata, a e lindur bashkë me zemrën e tyre; kjo nuk mund të specifikohet asnjëherë), i detyroi t'ia dhuronin shkrepësen e kërkuar.

I panjohuri u ngazëllye nga zemërgjerësia e fshatarëve dhe pasi i falënderoi, u kthye drejt kullës. Ndezi barishtet dhe zjarri u kthye sakaq në shkrumb e hi.

Nga fshati zjarri nuk mund të vihej re. Por sytë e pircërruar të fshatarëve, të ndihur nga kureshtja gërrye-



se, u munduan të vërejnë tymin e hollë e të zi. Të tilla shenja s'janë të mira, menduan ata, pastaj u kthyen drejt fshatit, drejt sigurisë që kishin njohur që në djep.

o o o

Edhe pse në dhomat brenda kullës nuk kishte asgjë, atij i pëlqente të shtrihej në dyshtemenë e fortë të katit të fundit dhe përmes një vrime në çati, të vështronte qiellin e natës.

Nganjëherë, tek humbiste në numërimin e pikave të shndritshme në qiell, i dukej sikur bëhej njësh me to. Të tillë bukuri nuk kishte dëshmuar ndonjëherë. Nga njëri cep i syrit tek tjetri, pafundësia shpalosej përpara tij dhe, siç kishte dëgjuar, ajo nuk ishte aspak fundi i asaj pafundësie. Ajo vazhdonte më tej, shumë më larg cepave të syve, përtej errësirës që mbulonte natën. Ç'mendje duhej vallë që ta kuptojë gjithë atë madhësi? Si mund ta imagjinojë diçka të tillë, kur syri mund të sillej vetëm deri tek kufiri i lëkurës rreth vetes? Këto mendime e ngadhënjenin, herë–herë dhe e ngrinin në këmbë, por jo në këmbët e tij fizike. Një hije brenda tij ngrihej mbi të dhe i qëndronte tek këmbët. Ky bënte të kthehej që t'i zbulonte fytyrën, por çdo herë, hija kthehej përnjëherësh me të. Ishte si të mbyllje sytë përpara pasqyrës dhe t'i hapje aq



shpejt, sa të shpresoje që ta gjeje reflektimin tënd në pasqyrë akoma me sy mbyllur. E pamundur! Por ishte pikërisht kjo pamundësi, e shpalosur kaq papritur në heshtjen e vetmisë, që e ngadhënjente edhe më. Dhe ishte ky ngadhënjim dhe pasion i papritur që i dhanë fuqinë të bënte atë që në fillim i ishte dukur tepër e vështirë. Në ditët në vazhdim rregulloi çdo gjë rreth kullës dhe pasi ishte bindur që nuk kishte ç'të rregullonte më jashtë, ju kthye brendisë. Me drurë të mbledhur përreth, ndërtoi një krevat. Në njërën anë të krevatit vendosi një gardërobë të vogël, me sirtarë të vegjël, dhe në anën tjetër një tavolinë, ngjyra e së cilës ishte e njëjtë me atë të dyshemesë.

Për të pajisur krevatin me dyshek, i erdhi përsëri në ndihmë fshati.. Ata, bujarë por dyshimtarë, i huanjtën një dyshek të vjetër, dhe herën e parë që trupi i tij u shtri mbi të, yjet lart në qiell sikur u afruan më shumë. Pafundësia u bë më e kapshme dhe në atë mendim, ai zgjati duart që ta merrte në përqafim.

o o o

Edhe pse kishte qenë traditë qindra vjeçare e fshatit që të ftonte në shtëpinë e tyre njerëz, qofshin ata të njohur a të panjohur, jeta e çuditshme e këtij djaloshi i kishte vendosur përballë një dyshimi gërryes. Ç'bën-



te ai atje? E dinte ai që ajo kullë ishte kullë ngujimi? Që ishte përdorur jo për jetesë, por për mbijetesë? Dikush duhet t'ia thoshte. Dikush duhet t'i tregonte se nuk bënte të jetonte atje, i vetëm, dhe se duhej të jetonte ose në fshat, nëse ndokush do ishte i gatshëm dhe mjaftueshëm bujar që ta merrte në shtëpinë e tij, ose ta drejtonte tek një fshat tjetër. Ndokund do kishte se s'bën fat. Vetëm në atë vend të mos jetonte më! Kaluan disa ditë duke fjetur mbi këto mendime, por në fund askush nuk doli vullnetar për ta marrë në shtëpinë e tij.

Ishin gati duke u dorëzuar, kur dikush dha idenë brilante që të bëhej një festë dhe ta ftonin të panjohurin. Kur ai të shihte harenë dhe lumturinë e fshatit, do të bindej që të mos jetonte më atje, në kullë, i vetëm. Pastaj do shihnin dhe bënin.

U vendos. Dy syresh shkuan të dera e kullës, disa metra larg saj. Nuk guxonin të afroheshin më. Vendosën duart rreth gojës dhe thirrën me të madhe. Nuk u desh shumë që një kokë e vogël të dallohej nga dritarja më e lartë e kullës. Koka po u buzëqeshte, por fshatarët nuk mund ta vinin re. Kulltari atëherë u ul poshtë dhe pasi kuvendoi me ta për disa minuta, u kthye përsëri brenda në kullë, i lumtur nga ftesa e papritur e fshatarëve.



Të tillë festë fshati nuk kishte dëshmuar ndonjëherë. Gosti, verë dhe raki, muzikë nga më të hareshmet, epope dhe himne, gjermime deri në fundin e thesit folklorik; të gjitha këto hynin në zemrën e djaloshit si shigjetë. Të gjithë ishin të lumtur; fshatit, më në fund po i kthehej siguria e dikurshme. Ajo që ata e kishin menduar si rrezik nuk kishte qenë gjë tjetër veçse një shqetësim i kotë. Mendime të këqija të ardhura nga kushedi ç'botë. Ai ishte si ata. Qeshte si ata. Hante si ata. Këndonte dhe kërcente si ata. Burrat e fshatit, më në fund, mund të pleqëronin me të, të mbledhur të gjithë rreth zjarrit. Vajzat e reja, ca të mbledhura kokë me kokë, të tjera të fshehura pas pemëve të oborrit, hidhnin shikime dredharake drejt tij. Si nuk u kishte shkuar ndërmend më parë? Një festë ishte përgjigja e duhur. Hareja i bashkonte të gjithë. Hareja ishte e përbashkëta e çdo njeriu, qoftë ai dhe një që ka humbur udhën e përfundon pa dashje në një kullë të mallkuar.

Edhe pse mendja e djaloshit ishte vjedhur nga hareja, diçka në brendinë e tij e detyronte të kthente kokën drejt kullës. Nuk ishte i sigurt përse. Në e merrte malli për shtratin e butë, që e kishte ndërtuar me duart e tij, apo mos kishte frikë se pafundësia e gjetur atje në katin e fundit do i largohej përsëri – ai nuk e dinte cila ishte arsyeja. E vetmja gjë që kishte filluar t'i



ndizej në zemër ishte një mall i çuditshëm dhe i flaktë për kullën vetmitare.

Përpiquej ta mbyllte atë ndjesi brenda vetes, të mos e shfaqte në shikimin që hidhte mbi secilin atje në festë, dhe mund të thoshe që fshatarët, pak nga dehja dhe gëzimi, pak nga mendjelehtësia që askush nuk do të ishte aq i marrë sa ta braktiste atë hare të pafund, nuk do ta vinin re fytyrën e tij që kthehej drejt kullës. Por ata sy kërkues, që shikonin vashat duke kërcyer, por që në brendi përgjëroheshin të ktheheshin në katin e sipërm të kullës, ishte tepër e vështirë t'i fshihje.

Në fillim bënë sikur nuk kuptonin gjë, por kur djaloshi u largua papritur nga festa dhe mori drejt kullës; këtë askush nuk mund të hiqej sikur nuk e kishte parë.

«Për çfarë na merr ai?» thërrisnin burrat.

«Nuk i pëlqejmë zotërisë sate?» pyesnin vashat në heshtje, duke kthyer kokën për të parë në i kishte dëgjuar ndokush.

«Ç'fyerje. E si mund ta lejojmë një veprim të tillë? A jemi në fshati që kemi qenë gjithmonë, apo jo? Me të vërtetë do e lejojmë një të panjohur si ky, të na marrë nëpër këmbë?»

Mjaftuan këto fjalë, të menduara nga të gjithë, por të shprehura nga dy vetë, pikërisht ata që kishin shkuar te kulla për të çuar ftesën, që e gjithë turma të merrte flakë dhe të bënte drejt kullës.

Derën e gjetën të mbyllur. Në fillim nuk guxuan t'i afroheshin, por nervi bëri të veten dhe trokitën gjithë



forcë, sikur të kishin trokitur të gjithë përnjëherësh.

Djaloshi, ndërkohë, ishte shtrirë në dysheme dhe sapo kishte filluar numërimin, kur dëgjoi një zhurmë të shurdhër nga poshtë. Nxori kokën në dritare, për të parë një turmë njerëzish, me lopata dhe zjarre nëpër duar, duke kërkuar që ai të ulej poshtë.

Nuk dinte ç'të bënte. E shihte qartë, edhe pse nga aq lart, se në ato fytyra nuk kishte mirëkuptim. Bujaria e tyre fillonte dhe mbaronte te pika kur ti ishte me ta. Që atje, nuk ishte i sigurt se kush flakëronte më shumë, zjarri që kishin në duar, apo ai që kishin në sy.

Me të kuptuar këtë, ai u qetësua disi kur u kujtua se e kishte mbyllur derën me çelës. Pastaj u largua nga dritarja dhe shpresoi që pas një farë kohe ata do të lodheshin dhe do ta linin të qetë.

o o o

Pothuaj kishte mbyllur sytë, kur një tjetër zhurmë e shurdhër u dëgjua nga poshtë. Ishte e disata herë që përpiqeshin ta hidhnin portën në tokë, por pa sukses. Nga kureshtja hodhi sytë përsëri drejt turmës, kur pa se ajo ishte shpërndarë.

Më në fund, mendoi, por mendimi iu zu në grykë, kur vuri re secilin prej tyre me degë pemësh në duar, dhe po i hidhnin në tokë rreth kullës. Disa të tjerë, ki-



shin shishe të çuditshme dhe derdhnin një lëng në tokë, pastaj i hidhnin ato brenda dritareve të kullës.

Frika shpoi zemrën e djaloshit. Kështu do digjej brenda! Përse? Përse po e bënin këtë gjë? Ç'u kishte bërë? Mund ta bënin? Kishin aq zemër? Ose më saktë, kishin aq pak zemër? Apo zemra nuk merrte pjesë në këtë lojë?

Djaloshi u ngrit në këmbë i trembur dhe iu bë sikur hija iu largua nga trupi. Zhurma poshtë këmbëve, në katet më poshtë, i shkaktoi drithërima në trup. Ata po vinin! Nuk kishin hyrë ende brenda. Ishte e pamundur që dera të digjej a të hidhej poshtë. Por përsëri, po vinin. Me mënyrat e tyre. Gjithmonë e gjenin një mënyrë. Do e digjinin për së gjalli! Do ia merrnin krevatin që kishte ndërtuar me duart e veta. Do ia merrnin dyshekun e butë. Do ia vidhnin vendin e preferuar, atje në katin e sipërm; atje, ku ndiente se pafundësia ishte mikja e tij.

Zhurma afrohet gjithnjë e më shumë. Çdo instinkt i tij është bërë i ndjeshëm. Një erë e çuditshme mbulon ajrin. Përpara syve, aty ku është, i shtrirë në dyshe, kalon një re e madhe e zezë. Por ja! Diku mes resë, në një hapësirë që ajo nuk e ka pushtuar akoma, ai mund të vërejë një copëz qiell. Nata sapo ka rënë. Yjet sapo kanë dalë. Dhe pafundësia është dhe njëherë në sytë e tij.





Konica

E diel, mëngjes

Kam menduar se fshati do më jepte shtysën e duhur drejt muzës, por kam menduar gabim. E gjithë vera më shkoi dëm në kërkim të diçkaje që ndoshta as që është aty.

Dhjetëra ditë ecje përgjatë rrugicave me baltë, qindra orë të kaluara në vetminë e frikshme të maleve shqiptare nuk nxorën asnjë zë, asnjë personazh a histori nga brendësia ime. Ky takim i stërzgjatur me veten, larg njerëzve e larg qytetit, veçse më groposi më thellë në mjerim...

Ndoshta ky udhëtim që i panevojshëm, sepse siç më ka thënë njëherë një mike, unë nuk jam Prusti që të shkruaj totalisht në vetmi. Ndoshta jam prej atyre shkrimtarëve që s'mund të bëjnë pa qytetin e rrëmujën. Pa njerëzit dhe problemet e tyre groteske. Ja pse ndo-



shta, ngaqë më bëri ta kuptoj këtë gjë, ky udhëtim s'qe dhe aq i kotë.

U vendos. Nesër, me të lindur dita, do kthehem në qytet.

E hënë, darkë

Nuk kam menduar ndonjëherë se do më merrte malli për qytetin. Ndoshta është e vërtetë që vetëm largimi nga një vend na e shpalos siç duhet dashurinë që kemi për të (e njëjta dhe për njerëzit?). Kur shoh llambadarët e rrugëve të metropolit, errësira totale e natës në mal më duket kaq e largët e kaq e kotë. Siluetat e njerëzve që shkojnë e vijnë përgjatë rrugicave më bëjnë t'i hedh në harresë shtigjet ogurzeza të maleve që ngjisja në kërkim të diçkaje, që siç duket e kisha lenë pas, këtu në qytet, i cili tashmë s'më duket më aq i ftohtë si në fillim të verës. Sa i trashë e fodull jam treguar. Ftohjen nuk e kishte qyteti. E kisha unë...

E martë, mëngjes

Gjendja e pakët e parave nuk më lejon të kaloj një tjetër natë në hotel. Më duhet të flas me ndonjë të njo-



hur, të më japë ndokush ndonjë strehë mbi kokë derisa të mbaroj librin (që ende s'e kam filluar?), ose më e pakta të përkthej ndonjë pjesë të mirë për ndonjë shtëpi botuese.

Nga mesdita do t'i shkoj për vizitë teta Emës. Mesa mbaj mend ajo ka një dhomë bosh që nga koha kur i vdiq i shoqi. Më patën ardhur fjalë që nuk flenë më në dhomën bashkëshortore pasi e ndjekin fantazmat e së kaluarës. Me siguri nuk e ka dhënë me qira, pasi, si besnike dhe moraliste që është, s'ia lejon vetes të nxjerrë pará nga dhoma ku ka fjetur me të shoqin. Por si lëmoshë ama, po.

Si një nder për një të afërm në nevojë. Besnikëria ndaj kujtimit të asaj dhome mund të «blihet» vetëm me idenë se ajo po e lëshon litarin e besës për diçka më të mirë. Dhe ç'është më e mirë se ndihma ndaj një shkrimtari të madh, që do ta bëjë të famshëm gjithë fisin e saj? Madje pastaj mund edhe të mburret, sesi dora e saj më shtyu në rrugën drejt suksesit...

E martë, darkë

Siç e prisja, zemra e tetos u zbut sapo dëgjoi rrëfimin e rrugëtimit tim të pafrytshëm shpirtëror, dhe më afroi (ende pa ia kërkuar unë), dhomën e saj të shtrenjtë.



Me çuditi diçka e re në jetën e saj. Siç duket kishte pësuar një paralizë gjysmake në duar dhe gjatë ditës vinte një vajzë e re, bijë e disa qiraxhinjve disa dyer më tej, për t'i pastruar shtëpinë. U habita pasi ajo kish namin e keq të një amvise fanatike, që s'lejon askënd t'ia prekë shtëpinë, por hamendja ime që e saktë. Vdekja e zbut njeriun.

E premte, mëngjes

Në orën tetë, siç më kish thënë tetoja, ia behu vajza e re.

Quhet Kamila. Bukuria e saj nuk më goditi me të parën, por si një gonxhe që kërkon më shumë kohë nga vetja, ajo u hap disi me vonë. Kuptova se ajo që e bukur veç kur më shikonte; kur sytë i treste mbi komodinë, në televizor, mbi rrjetat e merimangave nëpër mure, ajo nuk kishte ndonjë paraqitje kushedi se çfarë, madje që fare e zakonshme, si dikush që e di se do ta hasësh sapo të dalësh në rrugë. Por kur sytë e saj binin mbi të mitë, i gjithë koncepti teorik i bukurisë përçohet menjëherë nga bota e ideve tek trupi i saj.

Dhe më bëhej se ajo që e vetëdijshme për pushtetin që posedonte, pasi luante me mua në një mënyrë gati sadiste.

Me këtë dua të them se ajo e mbante shikimin më



shpesh larg meje sesa mbi mua. Një amatorë e pafajshme, kur e kupton se ti je skllav i syve të saj, të sheh pa ndërprerje për orë të tëra. Por jo Kamila. Ajo e din-te se esenca e përjetësisë së skllavërisë është mungesa dhe jo pasja. Uria e jo ngopja.

Dhe ajo kënaqej, shkrihej kur më shikonte ashtu të etur për një pikëz ujë.

E martë, darkë

Më në fund e shtiva në dorë Kamilën. Gjithë këto ditë ngarje pas saj si macja miut, ajo u lëshua më në fund në krahët e mi. Sadizmi i saj mori fund, vetëm për t'i lënë vendin mazokizmit të fshehur.

Kur dora ime preku trupin e saj, e dija se tashmë ajo qe e imja, e se rolet qenë këmbyer. Sytë nuk i peshojnë më me aq lehtësi mbi objektet e ftohta rreth shtëpisë. Ato më kërkojnë mua... Por tani jam unë ai që i largon... Sa e çuditshme natyra e njeriut.

E premte, darkë

Vetëm tani më ra ndërmend se s'kam shkruar asnjë fjalë për librin tim. Rehatia e shtëpisë së tetos, të pa-



surit një strehë mbi kokë, ushqim në tavolinë e më së shumti, prania e Kamilës më kanë bërë ta harroj atë që e quaj misionin tim në tokë. Më duhet t'ia filloj sa më shpejt, para se tetoja ta kuptojë zemërgjerësinë e saj të tepruar e të më flakë në rrugë.

E diel, mëngjes

Sot, teto Ema ra e sëmurë në shtrat. Doktorit tha se është thjesht një grip i lehtë, pra asgjë për t'u shqetësuar.

E diela është dita kur unë dhe Kamila takohemi për të bërë seks, pasi siç e ka bërë zakon qëkur s'mbahet mend, tetoja del të bëjë shëtitje nga liqeni për disa orë dhe në jemi të lirë të bëjmë ç'të duam. Gripi na i prishi planet, por Kamila siç duket që eksituar tepër, kështu që pasi u siguruam për gjumin e thellë të tetos, dolëm nga apartamenti për t'u futur në një tjetër aty pranë. (Kamila nuk pastron vetëm shtëpinë e tetos, por gati gjithë dhomat e atij kati). Të them të drejtën, nuk isha fort i sigurt për atë gjë, por këmbëngulja e Kamilës ishte ngjitëse, kështu që e ndoqa pa bërë zë brenda në apartament.

Sipas Kamilës, njerëzit e asaj shtëpie nuk ishin gati kurrë në shtëpi, por që sidoqoftë e paguanin një shumë të majme për ta mbajtur pastër. Shuma e lekëve ia



kishte shuar kureshtjen për të pyetur se pse pastrohej një shtëpi ku rrallë vinte kush, kureshtje e cila iu ndez vetëm kur e pyeta unë.

Por eksitimi i trupave tanë doli mbi pyetjet e kota dhe me gojët e bashkuara e sytë e vulosur kërkonim me duar derën e dhomës së gjumit.

Kam menduar se nuk ka gjë më të frikshme se ecja përgjatë një shtegu të errët nëpër mal, por kam menduar gabim. Prandaj e lëshova atë britmë tmerri kur hymë në dhomë.

Kamila ishte me shpinë nga dhoma, ende me sytë e mbyllur, ndërsa unë sa i kisha hapur pak për të pika-sur krevatin. Atëherë e pashë...

Një plak shtrihej (i vdekur?) mbi krevat. Kamila u tremb nga britma ime, dhe instinktivisht ma mbuloi gojën me dorë.

«Ç'ke?» më pyeti me sy.

«Atje!» bëra unë me gisht.

Ajo u kthye me fytyrë nga dhoma dhe fjalët që tha më futën edhe me thellë në habi (frikë?).

«Atje çfarë? S'ka gjë atje.»

«Me të vërtetë nuk e sheh?»

«Të shoh çfarë!»

«... Asgjë. Asgjë. M'u bë se pashë një merimangë të madhe.»

E hutuar, Kamila pa përreth.

«Oh, po kjo dhomë është gjithmonë e mbyllur. Më kanë thënë të mos hy kurrë këtu pasi është bosh e s'ka



nevojë për pastrim. Mashtruesit! Gjithë ky krevat i madh... Do e kenë harruar hapur... Me të vërtetë pe merimangë?»

«Po.»

«Epo s'do mend. Përderisa s'më lënë ta pastroj. Eja, shkojmë në kuzhinë më mirë. Mbi tavolinë, si thua?»

Pohova lehtë me kokë, por në atë moment seksi ishte gjëja e fundit që kisha në mendje.

E diel, darkë

Që kur iku Kamila, s'mendoj gjë tjetër veç atij plakut të vdekur. Kush ishte ai? Me të vërtetë ishte i vdekur? Pse nuk e pa Kamila? Pse e pashë vetëm unë? Prandaj e mbanin atë dhomë të kyçur? Pra, s'është truri im ai që krijon halucinacione, që imagjinon gjëra që s'janë, përndryshe ata s'do ta mbyllnin nëse s'kanë ç'të fshehin?

Por në fund të fundit, ajo është shtëpia e tyre e mund të bëjnë ç'të duan. Sidoqoftë është e dyshimtë që s'e lënë Kamilën të hyjë brenda. Kanë frikë mos do shohë plakun. Por ajo s'e pa. E pashë vetëm unë...

Dhe dera që harruar hapur. Qe harruar, apo ishte gjithmonë ashtu? Mos e ka ngatërruar Kamila me ndonjë shtëpi tjetër? Jo, s'ka se si. Diçka e tillë vështirë të ngatërrohet. Sa veta vallë i kërkojnë pastrueses



të mos pastrojë? Kamila s'është ngatërruar. Dhe unë s'jam çmendur.

Apo jam? Jo (s'jam?).

E hënë, mëngjes

Kureshtja po me gërryente së brendshmi. S'kisha rrugë tjetër veçse t'ia merrja Kamilës çelësat fshehurazi, e të shkoja të faktoja (mos?)ekzistencën e plakut. Nuk e dija se ç'doja të arrija, pasi s'qe puna ime e, shumë mirë mund ta harroja (siç harrojmë çdo gjë që i themi vetes ta harrojë), e ta hidhja atë histori pas krahëve, por diçka s'më lejonte. Diçka brenda meje donte të dinte se kush ishte ai plak...

Ngaqë Kamila më kishte thënë se aty nuk vinte kush, u futa në apartament sikur të isha në shtëpinë time. Por kur erdhi radha e dhomës së plakut, u ndala para saj si dhjaks.

Nuk isha dridhur në errësirën e malit, ndërsa këtu, te dorëza e një dhome, trupi më fërgëllonte nga frika.

Mora frymë thellë dhe u futa...

Ishte e vërtetë. Mendja s'mund të bëjë të njëjtën shaka dy herë. Plaku ishte mbi krevat. Nuk lëvizte. S'qe mbuluar me asgjë. Mbi trup kishte një kostum serioz dhe tek afrohesha, mund të betohesha se me çdo hap, fytyra e tij, edhe pse e rrudhur nga koha, më ishte e



njohur.

Kisha të drejtë. Atë njeri e njihja. Dhe jo vetëm si fytyrë. Edhe si shpirt, si mendje. Unë dhe ai plak ngjasonim në pikën me të rëndësishme njerëzore. Ishim të dy shkrimtarë.

M'u desh pak kohë ta merrja veten nga habia e njëkohësisht një lloj lumturie absurde, derisa fakti i pakundërshtueshëm e i vetëm që kishte rëndësi me ra në fund të mendjes. Ai njeri, i madhi Faik Konica, kishte vdekur shumë kohë me parë... Ai që futur në varr... Ai kishte vdekur e që varrosur në një varr shumë larg prej aty... Ai...

Çmenduria ime, në atë çast, m'u duk fare e arsyeshme.

Kamila s'kish si ta kishte parë, pasi ai nuk ishte aty... Por ai ishte aty!

Më duhej ta prekja. Kur njeriu nuk beson, për ta faktuar (mos)ekzistencën e objektit që s'besohet, e njëkohësisht për ta zhbindur veten nga e mbinatyrshmja, duart shkojnë instinktivisht drejt tij. (Arsyeja shpjegon çdo gjë!) Por arsyeja ime u ça në dysh kur mishi im preku mishin e tij... Pa vetëdije u plandosa në një karrige aty pranë, e mbeta si i ngjuar duke ia parë sytë.

Se dija ç'prisja. Ndoshta mendoja se prekja ime do ta ringjallte (vallë pse kisha menduar në fillim se ai ishte i vdekur?) Ndoshta *shpresoja* që ai të ringjallej. Një mendje e tillë i duhej Shqipërisë si kurrë më parë. Gjithë çka



dija për natyrën e shqiptarit të vjetër e dija prej tij. Në një farë mënyre, ai ishte ura lidhëse mes së kaluarës së mendësisë së paraardhësve të mi me atë timen.

Po lundroja në të tilla mendime, kur sytë m'u vodhën nga një objekt i fshehur poshtë nënkresës. E kuptova menjëherë se ishte një libër, ashtu siç e mora fill me mend se ishte i Konicës. Metafora që tepër e fuqishme për të mos qenë e vërtetë (mendja që i prehej poshtë kokës).

Kisha të drejtë. Ishte libri i tij. Në kopertinë që shkruar me të madhe emri Konica. Por çuditërisht s'kishte titull. Shfletova gjithë e më kureshtar dhe prisja që do t'më mjaftonte të lexoja një faqe për ta kuptuar se për ç'libër bëhej fjalë, por jo. Një, dy, tri faqe dhe asnjë fjalë nuk kumboi e njohur. Stili po. Stili ishte domosdo i Konicës. Do ia njihja me vetëm dy fjali. Por konteksti që i panjohur.

Kjo më habiti, pasi gjithmonë isha mburrur ndër njerëz për njohurinë time të thellë të veprës koniciane, derisa një tjetër mendim më tha se ndoshta faji s'që imi. Faji s'që i askujt, pasi ai libër ishte një vepër e re, e panjohur, e pabotuar, e palexuar...

Ekzaltimi që po më përvidhej nga korja e shpirtit m'u pre në gjysmë nga diçka që ma solli zemrën në grykë.

Dy sy po me vështronin gjithë ngulm duke ma ngujuar trupin në vend, sa dhe britma që kishte marrë rrokullimën nga skutat e frikës, për t'u shpërndarë



nëpër dhomë në formën e një britme çjerrëse, m'u kthye mbrapsht nga dhëmbët që kafshonin gjuhën, e vdiq duke jehuar mbyturazi në çdo pjesë lëkure.

Do mund të betohesha se ajo ndodhi kish zgjatur me orë të tëra, por në të vërtetë s'di a qenë as dhjetë sekonda, kur Konica i mbylli sytë. Përsëri.

Nuk kisha si t'i thosha vetes që ajo gjë s'kish ndodhur, se mendja ime po krijonte gjithfarësoj gjërash nga frika. Ajo gjë kishte ndodhur e për këtë mund ta vija dorën në zjarr.

Por pse kishte ndodhur? Pse i hapi Konica sytë? Si mund të ngjallet i vdekuri?

Nëse s'do të kisha filluar të rilexoja librin, gjithë themelet e botës që mendoja se njihja do shkërmoqeshin e unë do qëndroja pezull në ajër pa asnjë copëz absolutizmi ku t'i mbërtheja thonjtë.

Fjalët e Konicës më përpinë të tërin. Mendimi i tij qe aktual si kurrë më parë. Ishte sikur ai ta njihnte deri në thelb edhe shqiptarin e shekullit të njëzetën. (Apo shqiptari s'kishte ndryshuar pavarësisht shekujve?)

Faqet ndoqën njëra-tjetrën dhe unë u pushtova nga ajo ndjesia e paqtë, që ma kishte vjedhur zemrën qëkur s'e mbaj mend, ajo ndjesia e t'u harruarit në shpirtin e një libri edhe kur vdekja t'i ngulte sytë nga krevati përbri.



o o o

Këtë herë s'ishte Konica ai që më bëri të kërceja përpjetë, por një zhurmë diku jashtë. Nga frika mos do t'më gjenin në një vend ku s'duhej të isha, e për me tepër, fjala të shkonte në vesh të tetos, u turra me shpejtësi drejt derës, duke harruar, për një çast fare të shkurtër, se ç'dreqin kërkoja aty.

Vetëm kur mbërrita në dhomën time, kuptova se e kisha librin ende në dorë.

E hënë, darkë

Tani që m'u qetësua disi gjaku, mund të arsyetoj pak më kthjellët. S'ka kuptim që ekzistenca a mosekzistenca e plakut të më rëndojë më mbi krye, pasi s'kam ku t'i gjej përgjigjet. Nëse ai s'është, atëherë kjo do të thotë se jam duke e krijuar në mendjen time (kjo shpjegon pse Kamila nuk pa gjë). Nëse ai është, atëherë truri s'po më bën shaka, po që sidoqoftë, për një arsye a tjetër, Konicën mund ta shoh vetëm unë. Pra, s'ka kuptim ta lodh mendjen me pyetje përgjigjet e të cilave s'kam ku t'i gjej (nëse s'dua të kompromentohem). Ai që me intereson është libri. Ai është copëza e realitetit ku mund të mbahem



sadopak e të mos vetëklasifikohem si i marrë.

Për t'u siguruar, i thashë Kamilës të ma sillte në kuzhinë librin që kisha harruar mbi krevet, e ajo ma solli pa shfaqur asnjë shenjë dyshimi. Pra, libri është. Dhe pikërisht kjo është esenca e kësaj ndodhie të çuditshme. Çfarë do ky libër në dorën time?

o o o

Nëse do isha një prej atyre çunakëve që sapo kanë hedhur hapin e parë në fushën e pafund të vetëdijes, do ta gënjeja veten me gjithfarë arsyetimesh të zbu-kuruara, por unë ia kam përshkuar disa kilometra asaj fushe, e është e kotë t'i them vetes se ky libër është nisur nga lart (apo poshtë?) si kompensim i mungesës së muzës. Por do të isha budalla nëse s'do ta përdorja në favorin tim. Është e qartë tashmë se askush s'di gjë për të. Të zotët e shtëpisë së Konicës u kthyen për një ditë dhe Kamila më tha se ata i kishin dhënë një bakshish të majmë për punën e kryer. Nëse ata do ta dinin për librin, sigurisht që do interesohe-shin nëse ai ishte ende ku e kishin lenë. Për më tepër, një libër i tillë s'lihet poshtë nënkresës. Në rastin më të keq futet në një kasafortë, në më të mirin botohet, për t'i risjellë Konicës edhe njëherë lavdinë tashmë të pavdekshme... Pra, ata s'dinë gjë. Në fakt, askush s'di



gjë. Përveç meje. Përveç meje...

E diel, mëngjes

Kamila ka filluar të ankohet se nuk i kushtoj më vëmendje.

Më akuzon se më ka ikur fare dëshira për të, e se fajtori është ai libër i mallkuar me të cilin kaloj gati gjithë ditën. Përpiqem ta qetësoj, pasi s'dua asnjëfarë skandali që mund të më hapë telashe, dhe ia mbërthej trupin fort, e risjell eksitimën për të, që tashmë ka vdekur e është varrosur në skuta të largëta, dhe bëjmë «dashuri» si herën e parë.

Ajo nuk e di se, kur depërtoj brenda saj, jam duke e tradhtuar. Nuk është ajo që depërtoj, por libri. Kur e puth nuk puth Kamilën, por faqet e verdha të librit, që t'ia zbus kryeneçësinë e ai të ma japë kuptimin e vërtetë që pastaj ta rishkruaj me fjalët e mia. Nuk është trupi i Kamilës ai që bëhet imi në ato çaste. Është libri i Konicës. Dhe kur prishem, nuk janë sytë e tretur të Kamilës që më çojnë në orgazëm. Është ideja e triumfit, e suksesit të pashmangshëm që do bjerë si stuhi mbi qenien time...



–, mesditë

Tetoja vdiq. Ajo që menduam se ishte një grip i lehtë, u shndërrua në një furtunë virusesh të cilat trupi i saj s'kishte me çfarë t'i përballonte më. Rrjedhimisht me duhej të dilja nga shtëpia...

Por kjo s'ka rëndësi, pasi e kam marrë atë që kam pasur në mendje të marr. E kam shkruar librin tim!

E shtunë, darkë

Siç e prisja, libri që një sukses i menjëhershëm. I gjithë zhgënjimi i familjes e çdo të njohuri tjetër u shndërrua, sa hap e mbyll sytë, në justifikimin e faktit se kanë qenë të ashpër vetëm për të mirën time, e se ja, ajo ashpërsi i dha më në fund frytet e saj. Pështirosja që ndiej ndaj hipokrizisë së tyre tejkalohet vetëm nga lumturia që ndiej për veten.

Si çdo herë, kishte zëra kritike që veçse prisnin rastin për t'ju kundërvënë atij që më në fund e arriti atë që ata veç e ëndërrojnë. S'do mend që kishte edhe syresh, që pavarësisht ndryshimeve në stil, e kishin nuhatur dorën e Konicës, dhe kërkonin shpjegime të mëtejshme. Por shpjegime nuk kishte. Për më tepër, edhe nëse ua tregoj historinë time, ata s'do më besojnë,



do t'më quajnë modest e do t'më ngrenë edhe më lart. Përplasu të vërtetën në fytyrë e qeshin me të. Gënjeji dhe të ngrenë në pedestal.

E hënë, mëngjes

Sot erdhi të më takonte Kamila. S'di si e kishte gjetur kafenenë ku shkoj çdo mëngjes (të këqijat e famës?).

Me lot në sy, ajo me kërkoi shpjegime. Pse s'e telefonoja me? Pse se doja më?

Çfarë t'i thosha përveç se vërtetës: e vetmja dashuri që kisha në jetë ishte libri.

Prisja të më kuptonte. Që ta shihte pasionin që kisha e ta përligjte disi vakjen e ndjenjave të mia (më duheshin për famën?), por jo. Ajo me quajti egoist e arrogant. Mashtrues. Artist tipik që mendon vetëm për veten. Dhe në vend që të ndihesha keq, ndjeva një si lloj krenarie të çuditshme, sesi nevojitej gjithë ajo vuajtje dhe vetëmohim për të sjellë në jetë një kryevepër. Kryeveprën time.

Kur pa se mua aq më bëhej, Kamila iku duke qarë, e s'besoj se do t'më kërkojë më. Ndërsa unë ju riktheva kërkimit që ajo ndërpreu. Kërkimit të muzës për kryeveprën time të radhës...



E enjte, darkë

Asgjë. Absolutisht asgjë. Muza s'duket gjëkund.
(Është dukur ndonjëherë?)

Më duhet të bëj diçka, pasi e ndiej se vëmendja e publikut po zhvendoset tutje. Më duhet një tjetër Konicë!

E premte, darkë

Nuk e kisha menduar atëherë, por tek mbaja kopjen e çelësit të shtëpisë së Konicës në dorë, e kuptova se subkoshienca ime e kishte marrë me mend se do rikthehesha përsëri këtu.

Shpresova të mos ishte kush në shtëpi, dhe ashtu ndodhi.

Ngadalë, duke çapitur, mora drejt derës pas së cilës me siguri gjendej rimëkëmbja ime. Duhet të kishte më shumë se një libër të Konicës në atë dhomë. E ndieja. E dija.

Kur u futa brenda, u shtanga në vend. Konica, ai plak i pajetë, ecejakte si i humbur nëpër dhomë. Me të hyrë, ai u ndal e më vështroi aq thellë në sy, sa m'u bë se pashë vdekjen. Frika më shkundi aq fort, sa pa u menduar, pa u stepur, por përkundrazi duke marrë një hov mbinjerëzor, iu hodha plakut sipër e ja vura duart në fyt.



Sytë e tij s'më thoshin gjë. Nuk zmadhoheshin. Nuk cirreshin. Nuk kërkonin ndihmë. As mëshirë. Ata thjesht shihnin.

Kjo më tërboi edhe më. Më çmendi deri në atë pikë sa ia shtrydha jetën e pajetë prej syve.

Tani isha i sigurt që ai s'ishte më. Ai ishte – në realitet apo mendjen sime, kjo s'kishte rëndësi – por s'ishte. Kishte qenë.

Tani s'ishte më.

Nuk mendova më për librin. S'mendoja për asgjë. Veçse dola jashtë dhe ia mora vrapit të arratisjes. S'di sa kam vrapuar, por u ndala vetëm kur s'pata më frymë.

Hodha sytë përreth... Kundruall një kioske gazetash. Me tej një furrë buke. Dora ime mbështetur në dritaren e një librerie. Një librari! Ja dhe libri im. Ende në vitrinë. Ende ndër më të shiturit. Ende i famshëm.

Ç'po... Ç'po ndodh?! Ç'është kjo zbehje e papritur e librit tim?! Fiku kush dritat? Shoi kush diellin? Ç'po i ndodh librit tim? Pse po më fashitet emri nga kopertina?!

Ç'është kjo shaka, ky makth?! Mos! Jo emrin! Mos ma fshini emrin!

Por qe e kotë. Tashmë libri im ishte veç një fletë e bardhë.







Ligji

1.

La jmin për ligjin e ri e solli, si çdo herë, i njëjti person i dobët me vetëm ca fije floku mbi kokë. Sa herë vinte, i vëreja në fytyrë një të qeshur gjithë hare, a thua se ligjet ishin pjellë e mendjes së tij, e ai ishte krenar siç mund të jetë një baba për fëmijën e vet. Me një lloj impenjimi që e bënte figurën e tij të hollë goxha qesharake, ai ngulej si statujë te hyrja e vetme e fshatit dhe niste e kukuriste me gëzimin më të madh ligjet e reja të qytetit.

Ardhja e tij ishte gjithmonë e paparashikueshme.

Kishte javë kur hollaku vinte çdo ditë, e kishte herë kur ai nuk dukej për një muaj. Në këto herë ne merakoseshim disi, sepse ishim mësuar me fytyrën e tij dhe sepse në njëfarë mënyre e ndienim veten të privilegjuar që na kishin caktuar një nëpunës kaq entu-



ziast, i cili na i transmetonte kumtet qeveritare menjëherë pasi ato vinin në jetë.

Kaluan disa muaj dhe mungesa e kasnecit tonë hollak kishte krijuar shqetësim të përgjithshëm. Dy ishin arsytet përse ai mund të mungonte kaq shumë: ose hapin e tij të shpejtë e kishte kapur hapi i qoftëlargut, duke e çuar në takim të parakohshëm me vdekjen, ose qyteti ishte në ngërç, pra nuk prodhonte ligje si më parë. Gjithë njerëzia ishte bindur në një farë mënyre se vetëm këto ishin arsytet dhe duke mos marrë fare parasysh të tjerat, u ndanë në dy grupe të mëdha: nga njëra anë ata, të cilët me pëlqen t'i quaj fatkeqtë, pasi vetëm një fatkeqi i shkon mendja menjëherë tek më e keqja kur është në mungesë informacioni, dhe nga ana tjetër ata që mendonin se hollaku ishte gati-gati i pavdekshëm, se jeta e tij varej krejt nga jeta e ligjeve dhe se ai do të vdiste kur ligjet do reshtnin së krijuari.

Fatkeqësit, të bindur pak nga pak nga pavdekësia e hollakut, ose më mirë, nga lidhja e jetës se tij me atë të ligjeve, filluan të ndryshonin mendje e, pa i parë kush, kaluan nga ana tjetër e argumentit. Hollaku nuk kishte vdekur. Ai thjesht ishte plakur, dhe zyrtarët, për të vlerësuar punën e tij dhjetëra vjeçare, i kishin dhënë detyrën e shenjtë të të mësuarit gjeneratën e re me sekretet e tij për artin e lashtë të kumtdhënies. Por ky arsyetim, i ndeshur në ca replika tallëse të grupit tjetër, e humbi mbështetjen shumë shpejt. Si rrjedhojë e çoroditjes së fatkeqësve në pasigurinë e argumente-



ve të tyre, grupi tjetër, ai që ishte i bindur për shterjen e ligjeve e se mungesa e kasnecit ishte rrjedhojë e kësaj, filloi gjithashtu të ndryshonte pak nga pak mendim.

Më duhet të theksoj se ndryshime kaq të shpejta të mendimeve nuk kisha dëshmuar asnjëherë në fshat. Nëse ndonjërit prej tyre i ngulitej një ide në kokë, nuk kishte burrë nëne t'ia shkulte më prej andej, veçse me daltë. Por ngaqë këtë rast të gjithë lëkundeshin mbi fillin e hollë të pasigurisë, ngaqë koha kalonte e askush nuk dinte më shumë se tjetri, ndërrimi i mendimit vinte si diçka e natyrshme. Pothuajse të gjitha arsyetimet, qoftë dhe ato më absurdet, kishin po aq baza sa dhe ato që mund t'i cilësoje si krejt normale.

Pra, ligjshterësit nuk ishin më të mendimit se qytetit i kishte trokitur në derë koha e urisë ligjore. Tashmë ishin të bindur se njeriut i duhet kohë të merret me diçka vetëm kur është arritur në përfundimin se ajo diçka s'është më e nevojshme. E thënë ndryshe, ligjshterësat bënë me shtëpi e katandi se zyrtarët kishin vendosur të mos krijonin më ligje, jo sepse s'dinin t'i krijonin më, por sepse pas një studimi të gjatë, kishin dalë në përfundimin se bota nuk kishte më nevojë për ligje, se të gjithë rregullat e nevojshme ishin krijuar tashmë, dhe se kasneci ynë hollak nuk kishte vdekur e as që bërë mësues; ai thjesht kishte dalë në pension.



«Ç'marrí thoni», qeshnin ish-fatkeqësit me ish-shterësit.

«Bota do të ketë gjithmonë nevojë për ligje të reja.» Dhe ia krisnin një të qeshure të madhe bashkërisht, si për të treguar njëtrajtshmërinë e bindjes së tyre se ligjet po vonoheshin thjesht ngaqë ata po gatuheshin tani në kokat e gjeneratës së re, të cilëve sigurisht u nevojitej kohë e gjatë derisa të mësonin siç duhet të gjitha sekretet e të vjetërve.

Betohem se mund të vëreja dhe ndonjë copëz lot në sytë e ndonjë burri, gjë që nuk kishte bërë vaki kurrë në fshatin tonë, teksa kujtonte kasnecin hollak duke i mësuar të rinjtë e të rejtat me të njëjtin gëzim që na mësonte neve kumtet e botës së jashtme.

Aty nga mesi i debateve, u shfaq nga asgjëja një grup i tretë, i cili, pasi pati ndenjur për një kohë të gjatë në heshtje, nxorri më në fund kokën për të treguar arsyen e vërtetë të mungesës së kasnecit. Sipas tyre, ai ishte vendosur në fshatin fqinj, ndërsa neve na kishin caktuar një tjetër, i cili (dhe këtu ata fryheshin gjithë krenari), sipas informatave të tyre, as që ia ka idenë nga bie fshati ynë dhe se, siç e ka parë dhe i vetmi njëri që del nga fshati për furnizime (dhe bënin me dorë nga një mesoburrë që nënqeshte me një shtirje mbytyse) e ka parë tek sillej sa andej këndej në kufijtë mes fshatit dhe qytetit. Siç duket, kasneci i ri, pak nga turpi e pak nga frika mos do e pushonin nga puna, ngaqë kur kishte marrë punën ishte krenuar me kujtesën e



tij të pakrahasueshme dhe kishte refuzuar në mënyrë absolute të merrte ndihmë nga hartat, të cilat i konsideronte shpikje e djallit, tani e kishte gjetur veten mes katër rrugëve pa ditur se cilit kah t'ia merrte. Kujtesa, siç duket, e kishte lenë në baltë, e që të mos bënte të njëjtën gjë me familjen e vet që duhet ta ushqente çdo ditë, s'kishte guxuar të kërkonte ndihmë nga qyteti por ishte nisur nga ta çonin këmbët. Nga kjo ishte krejt e kuptueshme pse nuk qe dukur në fshatin tonë për javë të tëra, pasi po të mos kishe qenë të paktën njëherë tek ne, vështirë se mund ta gjeje udhën. Në ishim fshat legjendar, për të cilin qytetsat thoshin se gjithmonë i fshiheshim në mjegull syve të huaj. E pikërisht kjo ishte dhe arsyeja pse kjo ide dukej fare e pabesueshme. Qytetsat me siguri e dinin këtë gjë dhe nuk ishin pushtuar ende nga murtaja e çmendjes që të bënin të tilla gabime. Por nuk ishte kjo ajo që ua mbylli gojën grupit të ri. Një qyqar, i cili nuk kishte folur fare gjatë gjithë asaj kohe, iu drejtua gjithë qetësi atij që e mbante veten si ura e vetme mes qytetit dhe fshatit.

«Po mirë, e pse s'ia tregove ti rrugën, meqë e paske parë duke u sjellë si huti?»

Mjaftuan këto fjalë, që nënqeshja e tij krenare të fashitej e të mos dukej më asnjëherë.

Ashtu si çdo gjëje në fshatin tonë, kureshtjes, që kishte gjallëruar njerëzit si rrallë ndonjëherë, i erdhi fundi dhe secili doli nga dera e saj njëri pas tjetrit. Ki-



shte syresh që nuk lëviznin prej aty nëse nuk e shihnin komshiun e vet të dilte i pari, e nganjëherë kjo bëhej dhe lojë krenarie, e cila nuk ishte gjë tjetër veçse shkëndijë e vogël që ndizte zjarrin e dhjetëra ngatërresave të mëparshme, por edhe këta u lodhën me kohën dhe e zhvendosën betejën e fjalëve aty ku kishte qenë gjithmonë: nëpër shtëpitë e tyre.

Sidoqoftë, gjatë kësaj kohe qetësie, mua më sillej ndër mend një fjalë e gjyshit tim, i cili më kishte thënë se belanë duhet ta prisje pikërisht atëherë kur binte heshtja.

Dhe, siç ma ndiente gjithë trupi, belasë nuk iu desh shumë që të vinte.

2.

Në fillim u dëgjua një thirrje. Pastaj një tjetër. Pas disa çastesh shpërtheu një katrahurë nga e cila nuk kuptoje asgjë dhe që të mos humbje diçka që nuk kishte ndodhur ndonjëherë (që fshati të bashkohej i tëri nën një thirrje), duhet të dilje jashtë e të shkoje të hyrja e fshatit, aty ku ishte mbledhur njerëzia..

Të gjithë ndiqnin gishtin e atij që kishte lëshuar thirrjen i pari, rojes se trapit, të cilin e kishim menduar memec, sepse gjatë gjithë jetës ai veçse ngrihej në mëngjes, ulej në një karrige të vjetër tek trau i ven-



dosur të hyrja e fshatit, e ngrinte dhe ulte ato pak herë që vinte a ikte ndokush, e pastaj mbyllej në koliben e vjetër pa i thënë një copëz fjalë njeriu.

Pikërisht kjo ishte dhe arsyeja pse ajo thirrje tërhoqi vëmendjen. Thirrje të tilla ndodhin gati çdo ditë në fshat, e jemi mësuar të mos i marrim seriozisht sepse ose do jetë ndonjë i pirë nga nata e kaluar që mendohet të flasë me lopët e ngaqë ato s'i kthejnë përgjigje ai mendon se të folurit me zë të lartë do ta përmirësojë disi komunikimin mes tyre, ose është i marri i fshatit që e kap, gjithmonë në të njëjtën orë, sëmundja e tokës. Përveç kasapit që del për t'ia sjellë gjuhën në vend e ta rikthejë në marrëzinë e tij, s'kam parë ndonjëherë ndokënd në fshat të ndjekë një thirrje ashtu siç u ndoq ajo e rojtarit.

Dhe me siguri të gjithë po mendonin të njëjtat gjëra si unë, e madje, tek s'po kuptonin asgjë, disa nga fundi i turmës filluan të zbrapseshin duke e menduar si rreng të mendjes së rojtarit, e cila me siguri kishte luajtur nga gjithë ajo vetmi.

Disa prej nesh, me këmbët e vendosura tek ekstremi i kufirit mes fshatit dhe botës se jashtme, s'lëviznin që s'lëviznin nga vendi; sikur ngërçi i statujës se vetme të fshatit, një dele e ngrirë nga dimri më i acartë që kishim provuar ndonjëherë, ua kishte zaptuar trupat, e vetëm ndiqnin me sy të shqyer gishtin e rojës, i cili dridhej në një mënyrë të llahtarshme, a thua se kishte parë lugatin.



Shumë prej nesh do kishin preferuar të kishin parë lugatin sesa atë çka po vinte drejt nesh me hap tejet të ngadaltë, me gjymtyrë të holla të cilat ngjasonin më tepër me një skelet. Lajmësi ynë i vjetër, i cili kishte ndezur fshatin jo me lajmet më të çuditshme që kishte sjellë ndër vite, por me mungesën e tyre, po vinte drejt nesh me një çehre prej të vdekuri, e cila bëri që shumë veta të bënë kryqin ose të thoshin nën zë ndonjë falje arabe. Disa prej nesh gati ia mbathën nga sytë këmbët, pasi menduan se kufiri mes botës se nëndheshme dhe asaj të gjallë ishte hapur dhe të vdekurit kishin filluar të pushtonin tokën. Të tjerë, pikërisht ata që bënë kryqin, i kapën frikacakët prej leckash dhe i kthyen mbrapsht, duke iu kujtuar se e drejta për të kaluar atë kufi ishte dhënë vetëm njëherë, e se ai që po vinte drejt fshatit nuk ishte biri i zotit, por lajmësi.

Se ç'kishte ndodhur me fytyrën e tij, një dreq e din-te! Madje, ideja se atë e kishte pushtuar dreqi filloi të na vinte përsëri ndërmend, tek u ndal vetëm disa hapa larg nesh. Kishte zëra nga turma që thoshin se nuk kishin parë ndonjëherë një njëri të pushtuar nga qoftëlargu që të mos kishte një zgërdhirje të pështirë në fytyrë. Të tjerë pohuan në heshtje me tundje koke dhe shumë shpejt u arrit në përfundimin se lajmësi ynë ishte thjesht i mërzitur. Diçka do t'i kishte ndodhur në jetën private, me shumë mundësi do ketë qenë sëmurë, gjë që shpjegonte mungesën e gjatë. Ajo çka po dëshmonim tani s'ishte gjë tjetër, veçse mun-



gesë gjaku në fytyrën e tij. Pra, asgjë nga e cila lajmësi ynë besnik nuk mund të mos e merrte më veten. Me një gotë raki e një copë mish do t'i kthehej jeta në trup, ashtu siç dielli i kthehet tokës në mëngjes.

Por kumtësi ynë i vjetër filloi të fliste dhe atëherë çdo gjë u kthye kokëposhtë.

Ai nxori nga xhepi i brendshëm i xhakëtës një letër të zhubrosur, e filloi ta lexonte. Pra, ligjet s'kishin reshtur. Ky mendim u dhuroi një nënqeshje tinëzare atyre që në fillim kishin qenë kundër ligjshterësve, të cilët tani mundoheshin të tretnin sytë ose drejt qiellit ose hiqeshin sikur kërkonin diçka në tokë.

Prisnim që kasneci të mbante fjalim, i cili të përmbante jo vetëm ligjin e ri të vendosur nga qyteti, por të na shpjegonte arsyen e mungesës së gjatë, si dhe të na kërkonte falje, pasi, në fund të fundit, ai ishte fija jonë e vetme lidhëse mes qytetit dhe fshatit (nëse s'do merrnim parasysh endacakun i cili nuk kishte për të hapur gojë më). Por fjalimi ishte i shkurtër. Madje aq i shkurtër, sa disa menduan se në çastin që po merrnin shpjegimin aq të shumëpritur, ata ishin dënuar me shurdhim nga perëndia, e ngaqë koha mund të ndalej vetëm prej Tij, mendja s'kishte ku t'u shkonte tjetër veçse te mëkatet që kishin bërë, që të mund të fillonin lutjet e shpejta për falje. Ndërsa të tjerët, të cilët dolën në përfundimin se ishin të pastër dhe pa asnjë mëkat, kthyen sytë drejt kasnecit për të parë se mos vdekja u kishte zënë pritë tek fjalia e parë. Por siç u kuptua kur



kumtuesi ktheu majat nga kishte thembrat dhe mori rrugën përsëri drejt qytetit, ajo ishte fjalja e vetme.

«Që sot hin në fuqi ligji kundra qeshjes? Ça don me than kjo gja?» tha dikush me të madhe atë që të gjithë po mendonin me vete.

3.

Pak nga pak turma filloi të shpërndahej, e vetëm ditët në vazhdim u kuptua se sa i qeshur kishte qenë më parë fshati ynë. Tashmë të gjithë i kishte kapur një si mpirje, e cila shumicën e kohës vetëshkaktohej që të mësoheshin me gjendjen e re e ta bënim të zakonshme. Madje, kishte syresh që rrinin vigjilentë, jo për të zënë gafil ndonjë fatkeq e për ta paditur, por pikërisht për të kundërtën, që ta ruanin nga rënia në gabim. Kasapin tashmë e gjeje gatitu përpara dyqanit të vet, duke ruajtur mos i marri i fshatit do t'ia niste qeshjes pa arsye, ashtu siç bëjnë zakonisht të marrët, e nëse ndonjëherë vinte re në fytyrën e tij të çmeritur shenjat e një buzëqeshjeje prej marroku, kasapi turrej me vrap drejt tij, këtë herë për t'ia futur gjuhën brenda.

Në rrugën e vetme të fshatit filluan të shfaqeshin dhe ca tipa që nuk i kishim vënë re më parë. Disa pyetën, ashtu nën zë, mos ishin të huaj, dhe përgjigja,



po ashtu e zbehtë, a thua se e folura e mbante brenda rrezikun e qeshjes, shpjegoi se ata ishin prej tanëve. Se përse kishin nxjerrë kokën pikërisht tani, kjo s'u kuptua në fillim, por dalja e tyre e papritur u bë e qartë më pas. Dilnin gati çdo ditë, që nga mëngjesi deri në darkë, dhe shkonin përgjatë gjithë rrugës së fshatit. Disa fshatarë, të cilët nuk ishin bindur ende se ata ishin bashkëfshatarët tanë, deklararin se ata ishin punonjës të qytetit e ndodheshin këtu vetëm për një arsye: të vigjilonin zbatimin e ligjit. Por skeptikët e anës tjetër, të cilët edhe këto kohë nuk mund ta mbanin mbi shpinë barrën e të qenit gabim, u afruan tek gardhet prej druri e iu shtruan përgjimit.

Mesa dukej, ata nuk ishin vigjiluesit e qytetit, por disa qyqarë që pickonin veten me thonj, ose me raste të tjera edhe me pincë, që t'i shkaktonin vetes dhimbje. Ecejakja e tyre, e cila u emërua nga dikush si Parada e Dhimbjes, s'ishte gjë tjetër veçse zbatimi i ligjit. Disa thoshin se mjaftonte të mos qeshje që të quheshe zbatues i drejtë i ligjit (kishte pasur në fillim një mëdyshje të shkurtër në mos ligji nuk vlente vetëm për qeshjen, por edhe për nuancat të tjera si buzëqeshja apo shkëlqimi i syve, por ajo teori ishte hedhur poshtë pasi të bijës së plakut të fshatit i kishin shkëlqyer sytë kur kishte parë për herë të parë burrin që kishte ardhur për t'ia lypur dorën, dhe nuk kishte ndodhur asgjë. Disa, sidoqoftë, ishin të bindur se nuk kishte ndodhur gjë vetëm sepse kryeplaku shihej me sy të mirë nga krye-



qytetasi, kështu që vazhduan me mosbuzëqeshje dhe mosshkëlqim sysh, për parandalimin e se cilës ose i kthenin shpinën diellit ose vinin syze të zeza); pra, mosqeshja mjaftonte që ta gjeje veten brenda kufijve të vendosur nga ligji, por ndryshe nga ç'u mendua në fillim, sesi deliri i këtyre të shkretëve do të shuhej me kohën, paraduesit e dhimbjes, dita–ditës fituan për-krahës të mënyrës së tyre dhe rruga e vetme e fshatit, e cila zanafillën e saj e kishte nga kalimi i përditshëm i deleve të kryeplakut të parë, zuri të mbushej siç s'qe mbushur ndonjëherë, e nga mëngjesi në darkë qindra këmbë ecnin të lodhura nën rënkimet e zëshme të zotërve të tyre.

4.

Sidoqoftë, e gjitha kjo ishte veçse paraprijë e asaj që Sna priste në ardhmëri. Ditët në vazhdim, lajmi se vajza e kryeplakut nuk do të kalonte dhe shumë net në shtëpinë e saj, sillej nëpër ajër. Pa kaluar shumë kohë nga dera e shtëpisë së parë do të dilte nusja më me famë e fshatit. Buja e kësaj dasme s'qe e madhe thjesht se po martohej e bija e të parit tonë, por sepse koha e nusërisë i kishte kaluar dhjetë vite me parë, e deri para ca kohësh shpresa se e bija nuk do të përdorte me të njëjtin qenef me të atin i qe shuar edhe



kryeplakut, kur si një rrufe në qiell të pastër, ia behu në shtëpinë e beqares, vejushi i vetëm i anëve tona dhe ende pa hapur gojën për ta kërkuar siç duhet dorën e vajzës, kryeplaku iu hodh në qafë duke e puthur, «Është e jotja. Merre.»

Atmosfera e dasmës kish filluar që atë ditë me parapërgatitje të të gjitha llojeve, e fshati ynë me siguri do të kish marrë pamjen e një qyteze të lumtur, nëse s'do të kishte qenë për ligjin e ri, i cili ktheu çdo gjë kokëposhtë.

Një ndër pikëpyetjet e para që u shtrua nga vetë kryeplaku, i cili e kishte rrahur mendjen për net të tëra pa dalë në një përfundim, ishte nëse duhej të kishte muzikë apo jo. Nuk ishte parë a dëgjuar ndonjëherë, jo vetëm tek ne, por në gjithë rruzullin tokësor që kënga dhe vallja të mungonin në ditën më të lumtur të dy njerëzve, por nga ana tjetër, thoshte plaku, fytyra e të cilit ishte vjetruar në ato net sa për të gjitha vitet e pleqërisë së bashku, a mund të këndoje dhe kërcëje pa qeshur? A nuk këndohej dhe kërcëhej me qëllimin e vetëm që ta shprehje lumturinë? A nuk ishte qeshja forma më natyrale e lumturisë? Pra, si?

Kjo pyetje e mbajti fshatin pa gjumë për net të tëra. Dhe sa më shumë që mendonim, aq më shumë ngatërroheshim në mishmashin e logjikës së mbrapshtë.

Ishte e pamundur që martesë të bëhej pa festë. Kjo do të linte një njollë të përjetshme në biografinë e fshatit, e ajo ishte përtej çdo vuajtjeje njerëzore. Pra,



das-ma do bëhej. Por edhe nga kjo anë, historiku i fshatit do të njollosej gjithsesi. Në vend të martesës pa dasmë, do të shkruhej me shkronja të mëdha dasma pa gëzim. Sidoqoftë, pas ca kohësh zgjidhja u gjet. Dasma ishte pjesë e traditës qindrashekullore të çdo fshati nëpër botë. Ndalesa e saj do krijonte një shkëputje nga zinxhiri i pafund i traditës të së shkuarës e si rrjedhojë, çdo e padëgjuar tjetër do bëhej e mundur e kjo do të sillte veçse kaos. Por nëse bëje dasmë, e cila, si pasojë e klimës ligjore (pra, justifikimi ishte goxha i fortë), rastis të jetë pak ndryshe, atëherë zinxhiri i zgjatur me djersë e me gjak nga paraardhësit tanë nuk do të prishej, por thjesht do të krijohej një degëzim i ri, i cili me siguri që do të ishte jetim, pra, s'do të përsëritej më, dhe pasi të mbaronte, mund t'i ktheheshim përsëri udhës së vjetër e të duhur.

Por kjo lindte të tjera pikëpyetje. Si ta organizoje një dasmë të tillë? Ajo, e vjetra, normalja, ishte e thjeshtë, secili i dinte përmendësh të gjithë hapat. Nusja bëhej gati. Burri merrte udhën drejt shtëpisë së nuses (për fat dhëndri jetonte veçse disa shtëpi më tej), babai e nxirrte nusen nga dera e shtëpisë, njerëzit (zakonisht gratë) ia merrnin këngës, dhe e shoqëruar nga vaji i përjetshëm i shkëputjes nga dera ku u rrit, vajza merrej nga burri i saj. Në fund pastaj bëhej festa.

Shumica e njerëzve kësaj ia kishin frikën më shumë, festës, sepse mjaftonin disa gota raki që njerëzia të çlirohej nga kthetrat e vetëdijes e të harronte jo vetëm



ligjin, por edhe se në ç'botë ishin. Si ta kontrolloje? Ishte vallë e mundur? Disa thoshin që po. Të identifikoheshin të gjithë ata që njiheshin si më festivët, pianecët, ëndërruesit me sy hapur e të tjerë që frerët e vetes i kishin pak si të lëshuara e të mos ftoheshin në festë. Por kjo ishte vajza e kryeplakut. Ai do koritej nëse dora e tij s'do mirëpriste çdo fshatar që ushqehej me bukën e tij. Për me tepër, si kryeplak, duhej të ftonte edhe nga fshatrat fqinjë. Si t'i kontrolloje ata? Po nëse rastiste që njëri nga kryepleqtë e ftuar të ishte i pakontrollueshëm? Sigurisht që edhe ata ishin në dijeninë të ligjit (ishin vallë?), por rakia jonë kishte namin e mirë të të hedhurit tuç në tokë ata të fshatrave të tjerë, dhe një rrezik i tillë s'mund të kontrollohej as nga vigjiluesit më pasionantë.

Si ta zgjidhje këtë?

Një zgjidhje e mundshme erdhi prej atyre që s'e prishnim. Fetarët e thekur e morën këtë rast si një mundësi për të risjellë në jetë atë propagandë që u kishte dështuar sa e sa herë: të ndalohej alkooli. Në fillim njerëzit e qeshën këtë ide. Të ndalohej rakia? Kjo ishte edhe me e rëndë të ndaloje dasmën. Madje disa hoqën dorë prej saj vetëm nga të dëgjuarit e kësaj ideje, që nuk dihej nëse do të merrej seriozisht apo jo. Por sa më shumë që talleshim apo e refuzonim kategorikisht idenë e mosngopjes me rakinë me famë të kryeplakut, aq me shumë krijoheshin në nënvetëdijen tonë bindja se kjo, në fakt, mund të funksiononte. Në fund të fundit,



a nuk ishte vetë rakia ajo që bënte harenë? A nuk pinim që të vinim në qejf, të çliroheshim nga zinxhirtë e komplekseve, që ta shijonim veten, ta tretnim tutje frikën e përrjetshme të vuajtjes dhe vdekjes? A nuk pinim që të harronim e të bëheshim të lumtur? Dhe përtej çdo kundërshtimi, a nuk ishte kjo arsyeja pse pija duhej ndaluar nëse donim që dasma të ndodhte pa u shkelur ligji!

5.

| shoqëruar nga dhjetëra kundërshtime, vendimi u mor. Dasma do të bëhej pa alkool. Shumë prej atyre që e kundërshtuan, u matën ta fshinin emrin e tyre nga lista e të ftuarve, por pastaj u kujtohej mishi i bollëkshëm e me kokën poshtë i përuleshin vendimit të marrë, që në heshtje e mallkonin me gjak e me shpirt.

Por ndryshe nga ç'pritej, nuk u desh shumë që të vendoseshim përsëri në zgripin e vendimmarrjes. Dikush hapi lajmin se në dasmë ishin ftuar dhe zyrtarë të rëndësishëm nga qyteti (madje u theksua se vetë ligjvënësi i madh do na nderonte me praninë e tij), sa menjëherë filloi zbarkimi i shisheve të rakisë nga mushka e kasapit, të cilit i ishte dhënë detyra e mbartjes së tyre drejt një fshati tjetër, të paktën derisa të mba-



ronte dasma.

Pra, mirë që dasma do bëhej, por do kishte dhe al-kool. E thënë ndryshe, ajo do të ishte një tjetër dasmë e zakonshme. Sidoqoftë, dasma do dukej e zakonshme vetëm nga jashtë, sepse në fund, edhe pasi u shtrydhen të gjitha mendjet më pjellore të fshatit, nuk mbeti zgjidhje tjetër veçse të krijohej një milici e vogël kontrolli, e cila do vigjilonte çdo syresh në fytyrën e të cilit do të shfaqej qoftë dhe cifla më e pafajshme e buzëqeshjes. Për këtë detyrë u zgjodhën të rinjtë e fshatit, pjesë e të cilëve isha dhe unë.

Si më të madhin nga të rinjtë, mua me vendosën në mesin e orkestrës, e cila shihej si strumbullari i çdo belaje që mund të lindte papritur. Për ta ndalur këtë papritshmëri pa ndezur dyshim tek të ftuarit e nderit, na kishin thënë të visheshim jo me uniformat identifikuese të një skuadre që punon për një qëllim të vetëm, siç ndodh rëndom me ushtrinë apo skuadrat e futbollit, por të përziheshim me turmën, pra, të visheshim si gjithë të tjerët.

Më në fund, dasma filloi. Dua t'ia kursej vetes hollësitë e panevojshme, sepse në një farë mënyrë, ashtu siç e ndiejmë sikletin e dikujt që është duke bërë diçka të pabërë, ashtu e ndieja dhe unë pamjen ogurzezë të asaj turme fytyrëngrysur, që ishte mbledhur për bashkimin e dy jetëve njerëzore në një. Nëse ndonjë i huaj do shfaqej papritur në atë vend, me siguri do mendonte se ishim duke futur dikënd nën dhe. Por nëse unë ndihe-



sha keq, nga ana tjetër, edhe pse nuk e shfaqnin në fytyrë, ngaqë isha afër tyre, e ndieja fare qartë vetëkënaqësinë e heshtur të zyrtarëve nga qyteti.

Madje njëri prej tyre, me saktë, ligjvënësi i madh, në çastin kur kryeplaku vuri heshtjen në sallë dhe po bëhej gati të thoshte fjalët e mirëseardhjes, u çua në këmbë dhe duke e kapur plakun tonë të vjetër për krah, i tha se do ishte më mirë që fjalën e parë ta thoshte ai. Të gjithë ishin si nën gjemba për të dëgjuar atë që do thoshte (shumë veta po prisnin lëvdatat nga më të lartat për mënyrën e tyre të sjelljes, si për shembull zanafillësit e Paradës së Dhimbjes, të cilët bënë disa hapa para që të dilnin siç duhej në skenën e vëmendjes, apo fetarët, që afroheshin me qëllim afër pijeve alkoolike vetëm që t'i shtynin me shputën e dorës duke shtrembëruar fytyrën gjithë pështirosje, me njërin sy varur rakisë e tjetrin duke skanuar zyrtarët, apo dhe vetë kryeplaku, i cili gjithmonë e kishte urryer që dikush të merrte fjalën para tij, por që tani krekosi veshët e skuqur nga krenaria për të dëgjuar fjalët e kryeligjësit, që do ia shtonin edhe më rëndësinë dasmës së vajzës), por ato fjalë do të mbesnin përjetësisht mister për ne, sepse papritur, ashtu nga asgjëja, u dëgjua një e qeshur.

Në atë moment gati të gjithë donin të vdisnin, e me sytë që u dukej sikur kishin parë se ç'mbante bota e përtejme, kërkonin njeriun e mallkuar që kishte qeshur. Isha unë ai që e vuri re i pari. Si nuk na kishte



shkuar ndërmend! Si kishim qenë aq budallenj sa të harronim ata prej të cilëve na kanosej rreziku më i madh! Në rreshtin e parë të njerëzve që ishin në këmbë para ligjvënësit dhe kryeplakut, një fëmijë kishte drejtuar gishtin nga trupi i zyrtarit të madh dhe po qeshte me të madhe. Ngaqë të gjithë ishin si të ngrirë, sikur vetë koha të ishte ndalur e vetëm unë të kisha shpëtuar nga ngërçi i saj, vrapova drejt fëmijës që t'ia mbyllja gojën e ta nxirrja nga ai vend para se ta zinte belaja. Por sapo ia vura dorën te goja dhe ia mbuloja britmën e qeshjes që vetëm rritej, një tjetër fëmijë ia shkrepiti nga ana tjetër e sallës. Duke kërkuar burimin e dytë të qeshjes, sytë ndoqën gati instinktivisht gishtin e fëmijës, i cili shënjonte pantallonat e zyrtarit ligjvënës, të cilave u kishte harruar zinxhirin hapur. Në atë çast, duke e parë se ngurtësimi i turmës ishte i pazhbëshëm, që të kaloja vëmendjen e zyrtarëve nga fëmijët tek unë, fillova të qeshja me të madhe. Kjo funksioni për një copë kohë, pasi disa burra të veshur me të zeza, që s'i kisha venë re me parë, të cilët po bënë me shpejtësi drejt një fëmijë të tretë, ndërruan kah e morën drejt meje. Por ky veprim veçse e shtoi gazin e fëmijëve, të cilët u ndezën flakë kur panë se nuk po i ndiqnin më.

Me siguri tani s'do isha këtu duke ju rrëfyer këtë histori, nëse s'do të kishte qenë për bashkëfshatarët e mi, të cilët, kur panë se fëmijëve të tyre po u kanosej rreziku, për të mbuluar gjurmët e të vegjëlve, nisën të



qeshnin me të madhe. Si shtrati i një lumi të tharë nga një verë e pamëshirshme, që mezi ka pritur vjeshtën për të ndierë bekimin e përjetshëm të ujit, e qeshura e turmës u bë aq e madhe, saqë burrat me të zeza u zmbrapsën dhe ia mbathën me të katra. Zyrtarët, të cilët ishin mbledhur shuk rreth kryeplakut, duke parë atë gjullurdi të pakontrollueshme, as që u menduan dy herë që t'ia jepnin edhe ata një gazi të papërmbajtur, duke e llogaritur aty për aty se ajo ishte forma e vetme e daljes gjallë nga mesi i asaj turme të çmendur. Madje, në fund, kur nuk kishte mbetur më frymë njeriu pa u mbledhur rreth tyre, nuk u kuptua se kush po qeshte më shumë, ne apo ata.





Predikuesi

Gjithmonë e kam urryer shkrimin. Që nga momenti kur në mendjen time u ngjiz ideja se isha në këtë tokë që të bëhesha prift, leximi dhe shkrimi u kthyen në mjete të djallit, të cilat kishin një qëllim e një qëllim të vetëm: të shpërndanin blasfemitë e tij.

Po i filloj në këtë mënyrë këto shënime të shkurtra, që të mund ta theksoj sa me shumë çuditshmërinë dhe ironinë e këtij çasti, që po shprehem pikërisht me anë të asaj çka deri dje e kam urryer me gjithë shpirt. Tek dora ime rrëshqet në fletën e bardhë, vetëm tani e kuptoj tundimin e vërtetë të shkrimtarit. Ekziston një paqe e heshtur në të shkruarit veten në letër, gjë që nëse dje e shikoja si formë komunikimi me qoftëlargun, sot e cilësoj si një ndër format më efikase të rrëfimit.

Dhe kujt po i rrëfhem? Askujt tjetër veç vetes. Në një jetë të mbushur me rrëfimet e qindra të ashtuquajturve mëkatarë, mendoj se ka ardhur koha të dëgjoj



rrëfimet e atij që jam munduar t'ia mbyll gojën gjatë gjithë jetës.

Duke qenë njeri i vetëm një libri, siç thosh dhe Akui-ni, nuk është se e di sesi supozohet të rrëfëhet njeriu në letër. E gjithë kjo është diçka e re për mua, dhe nuk e di në do të ishte e nevojshme të tregoja nga jeta ime e mëparshme. Vetë shprehja që përdor, «jetë e mëparshme», tregon se nuk jam më pjesë e saj, e që vendin ia ka zënë një e re, e cila, më duhet ta pranoj, më frikëson tej mase. E në fund të fundit, ky është dhe qëllimi i rrëfimit, të davaritet frika.

Për vite me radhë, njerëzit vinin në kishën time e sapo futeshin në dhomëzën e rrëfimit, fjalët e frikës rridhnin lumë, e unë i pranoja sikur të ishin të miat. Dhe për shumë kohë ato ishin të miat, pasi frika e një njeriu të vetëm ishte gjithashtu frika e një njerëzimi të tërë. Por mbajtja e gjithë njerëzimit mbi shpinë vjen me çmimin e identifikimit me të, e si pasojë e harresës se përtej çdo gjëje, ti ke një *vetë*. Dhe detyra ime e përditshme ishte që t'u tregoja atyre të gjorëve që kërkonin shpëtim, se ai mund të vinte vetëm nga lart.

Duhet që ta harronin veten në krahët e zotit dhe atëherë djalli nuk kish rrugë tjetër veçse të këpuste qafën.

Vetëm tani mund ta kuptoj me të vërtetë vështirësinë që hasnin njerëzit në dhomën e rrëfimit për të thënë atë që jashtë atyre mureve s'mund të thuhej. Është diçka brenda teje që nuk mundet as ta shkruajë e



as ta mendojë atë që e gjithë qenia jote klith në heshtje. Në momentin kur kjo ndodh, në çastin kur gjuha ngec mes dhëmbëve gjithë dyshim, duhet të ndalesh e të hedhësh sytë mbi atë që të bren nga brenda. Ky është dhe funksioni i priftërinjve: të presin me durim derisa gjuha të çlirohet e ta thotë dyshimin ashtu siç vjen, pa e gëlltitur. Vetë e folura për frikën e mund frikën.

Por këta njerëz e kishin një vend ku ta çlironin veten; fytyrat e tyre ngjesheshin pas rrëfimitores e thjesht prania ime atyre u jepte qetësinë e nevojshme për të folur. Po kur një prift ka nevojë të rrëfëhet, ku të shkojë? Te një prift tjetër? Nuk bën efekt. Ai i njeh truket e zanatit të tjetrit. Për më tepër ekziston një lloj familjariteti brenda sektit, dhe është gjithmonë më e lehtë t'i rrëfesh një të huaji sesa një të njohuri. Pra, ku? Sigurisht, mbetet vetëm zoti. Dhe këtu fillon e gjithë historia ime. Unë nuk besoj më në zot.

o o o

Të arratisesh nga zoti është e pamundur, por ajo që mund të bëhet është largimi prej atyre që supozojnë të jenë zëri i tij. Në fillim veçse ndërrova banesë. Pra, nga kisha, ku kisha kaluar gati gjithë jetën time duke fjetur në një dhomëz modeste, u vendosa në një apartament nga ana tjetër e qytetit. Por pas ca kohësh, më dukej se



as kjo s'qe e mjaftueshme, se në fakt nuk kisha nevojë të kaloja ca kohë vetëm larg kishës, por edhe larg qytetit, kështu që u zhvendosa në periferi, në një qytezë, të cilës, për fatin tim të mirë a të keq, i qe rrënuar kisha këtu e një muaj më parë.

Ironia e fatit deshi që dhoma e vetme e lirë në atë vend të qe ajo e priftit të mëparshëm, i cili, sapo kish parë se i qe djegur faltorja, ishte zhdukur nga sytë këmbët. Sigurisht që unë nuk u paraqita si një prift, e aq me pak si ai që do zëvendësonte të mëparshmin, por si një pensionist i parakohshëm, të cilit i kishte ardhur qyteti në majë të hundës, gjë që, tek hidhja sytë mbi fushat e pafundme të rrethuara nga pyje pemësh e jo betoni, kuptova se ishte më se e vërtetë.

Në fillim, njerëzit e qytezës ishin dyshimtarë. Por ndryshe nga ata të qytetit, ditët që kalonin ishin në favor të shuarjes së dyshimit. Kur ata më pyesnin se ç'punë kisha bërë më parë, u thosha se isha marrë nga pak me të gjitha, e siç duket kjo u mjaftonte. Që të bëheshe pjesë e tyre, nevojitej që të kishe respekt për atë që bënin, e të qeshje. Me të parën nuk kisha ndonjë problem, ndërsa me të dytën, për habinë time, doli që s'isha më i zoti ta bëja.

Nuk e kisha menduar ndonjëherë më parë, sesi gjithë ato vite i mbyllur në kishë do të rezultonin në humbjen e asaj gjeje që për të tjerët vinte aq natyrshëm. Përpiqesha të kujtohesha se kur kishte qenë hera e fundit kur kisha qeshur, dhe jo nga ato të leh-



tat, simotrat e buzëqeshjes, por prej atyre që të bëjnë të kapësh barkun me dorë, por në syrin e mendjes nuk më shfaqej gjë.

Kjo me futi frikën, e për ca ditë as që doja ta besoja, dhe gati-gati u bëra ta ndaloj veten përsëri së menduari, pasi nëse arrita të zbuloja një gjë të tillë në kaq pak ditë, vallë sa përçudnime të tjera të së natyrshmes brenda meje më prisnin? Por nuk e ndalova veten dot së reflektuari, pasi po ta ndizje një herë motorin e mendimit, vështirë se mund ta ndaloje më.

Ndryshe nga ç'shpresoja, të fshehtës sime nuk iu desh shumë që t'i vinte fundi. Njëra nga pastrueset e bujtinës, e cila, siç duket, ishte e dhënë pas pastërtisë së çdo gjëje, kishte rrëmuar në gardërobën time gjatë kohës kur unë po bëja shëtitjen e përditshme të mëngjesit, dhe kish gjetur rrobën e vjetër të priftit. Në fillim u bëra gati ta qortoj, pasi nuk kishte asnjë të drejtë të rrëmonte aty ku s'duhej, por tek ia shihja sytë gati të përlotur (të cilët me shumë mundësi i kishte ashtu sepse sapo kish zbuluar se qyteza s'do të rrinte më pa prift, e jo sepse kishte cenuar privatësinë time), mendova se mos vallë nuk e kisha fshehur rrobën në ndonjë vend më të sigurt ngaqë nënvetëdija ime dëshironte që ajo gjë të zbulohej, e jo sepse doja t'i kthehesha profesionit të mëparshëm, por sepse nuk mund të duroja më të isha mister, as për veten e as për të tjerët.

Lajmi, sidoqoftë, pavarësisht lutjes ndaj pastrueses që të mos i thoshte kujt, u përhap brenda një nate



në të gjithë qytezën, dhe në mëngjes, tek po dilja nga dhoma, një radhë e tërë njerëzish më priste për t'më përshëndetur.

Impulsi i parë ishte që t'i vendosja të gjithë në radhë për një, e secili të futej në dhomë për t'u rrëfyer, por një mendim i dytë më kujtoi se kjo gjë i përkiste së shkuarës. Nuk kishte zgjidhje tjetër veçse t'u thosha të vërtetën.

Gjatë gjithë jetës sime kisha predikuar se e vërteta të çliron, dhe ashtu siç më thoshte eksperiencia, gjëja e parë që çlirohet është mohimi. Ajo turmë paqësore besimtarësh e ktheu sa hap e mbyll sytë mirëseardhjen e saj të paqtë në një revoltë të përgjithshme.

«Mos je mashtrues?» thoshin disa.

«Mos je çmendur gjë?» thoshin ca të tjerë.

«Si mund të shpriftërohet një prift? Me siguri po tallet me ne!» Dhe qeshnin hidhur sikur ajo gjë të ish një shaka pa kripë.

Por nuk mund të luaja nga vendimi që kisha marrë.

Jeta ime ishte përtej detyrës sime. Rroba ime nuk kishte më fuqi mbi kontrollin e qenies sime. E aq më pak ata njerëz.

Ua përsërita, këtë herë me zë të fortë e të lartë, që ta dëgjonin të gjithë, se unë nuk isha më prift. Reagimi që i përgjithshëm; një heshtje gjithë tension i kaploi të gjithë, e nëse s'do të fliste një syresh aty pranë meje, s'di dhe sa do kisha duruar pa thënë diçka, çfarëdolloj gjëje.



«Pra, ti s'beson më në zot?»

«Ka po aq arsye në besim sa dhe në mosbesim», ia ktheva unë. “Dhe të gjitha janë personale.»

«Mos je inatosur gjë me zotin?» tha pa të keq po i njëjti person.

«Ose ndoshta është inatosur zoti me të dhe e ka dënuar me dënimin më të tmerrshëm që ekziston: mosbesimin.»

Përgjigjet e pyetjeve vinin po aq shpejt sa dhe thuhe-shin, e shpesh ato vinin nga të njëjtat gojë.

«Me siguri i ka vdekur ndonjë i afërm.»

«Por vdekja supozohet të të afrojë me zotin, jo të të largojë prej tij.»

«Ja që s'ndodhka me të gjithë njëlloj.»

Më duhet ta pranoj që, edhe pse si natyrë jam e qetë, për të cilën ka ndikuar dhe mbrujtja disavjeçare e rrobës së priftit, tani që kisha hequr dorë prej saj, ndjeva emocionin e pagabueshëm të zemërimit tek më bëhej lëmsh në grykë, e nëse s'do të qe për Andrean, një zot e di ç'do të kisha thënë.

o o o

Nuk e di se si m'u përvodh vëmendja drejt tij. Ishte mbështetur te muri dhe po më shikonte me ca sy aq të trazuar, sa mund të vëreja fare qartë luftën që po



ndodhte brenda tij.

Turma, si çdo turmë, u lodh me pyetjet që u përgjigjej po vetë, e pak nga pak filloi të shpërndahej, e shoqëruar nga një shfryrje e gjatë mosbesimi e zemërimi ndaj meje. I vetmi që nuk kish lëvizur nga vendi ishte djaloshi. Tani që ishim vetëm për vetëm, luhatja e syve të tij qe edhe me intensive.

«Si quhesh?» e pyeta.

«Andrea», u përgjigj ai.

Po bëhesha ta pyesja se ku i kishte prindërit, kur ai më ndërpreu me po atë pyetje që më kishin bërë të tjerët.

«Me të vërtetë s'je më prift?»

«Po, me të vërtetë.»

«Pse?»

Nëse do t'më pyesnin përsëri ata që ikën, do të zhytesha edhe njëherë në ujërat diplomatike, por diçka brenda meje nuk më lejonte t'i thosha gjë tjetër veç së vërtetës. Ishte sikur para meje të mos ishte Andrea, por vetja ime i të njëjtës moshë.

«Sepse nuk besoj më në zot.»

Me po të njëjtin zë që dridhej, ai përsëriti:

«Pse?»

Dhe unë që i thashë të vetmen gjë që dija:

«Nuk e di. Të betohem që nuk e di.»

Me të vërtetë që nuk e dija. Por kjo s'do të thoshte që s'kisha arsye. Kisha sa të doja. I gjithë historiku i atij sekti që më kish strehuar për vite me radhë ishte



i mbushur me arsye për të mos besuar, por ashtu siç njerëzit besojnë përtej arsyeve apo fakteve që u thonë për të kundërtën, në të njëjtën mënyrë as unë nuk e dija se ç'kishte qenë ajo shkëndijë që ma kish ndezur zjarrin e kësaj gjëje të pidentifikueshme brenda meje. Vetëm më pas, kur shpirti im mori flakë, të gjitha faktet historike dhe shkencore morën atë nuancën e tyre objektive, të cilat tani mund t'i vlerësoja nën dritën e tyre të vërtetë. Por po të mos qe ndezur ajo shkëndijë, shpirti im do të vazhdonte edhe sot të qëndronte në hije.

Kur dy sy kureshtarë ma vodhën vëmendjen drejt shkallëve aty pranë, u kujtova se unë dhe Andrea po rrinim në heshtje përballë njëri-tjetrit në prag të dhomës sime. E pyeta nëse kishte pyetje të tjera dhe ai pohoi lehtë me kokë.

E ndieja se nuk do mund të flija i qetë derisa trazi-mi i syve të tij të shuhej sadopak, kështu që e ftova brenda.

Kur vura re një si tip hezitimi në të përgjigjur, shtova:

«Mendoje si një rrëfim.»

Një buzëqeshje gati e padukshme ia përshkoi fytyrën dhe pa u menduar më, u fut në dhomë.



o o o

Jashtë dielli ishte në të perënduar. Pas shpinës sime, aty ku po qëndroja me duart mbështetur në dritare, s'bëzante i ulur në karrige Andrea. Tensionin e trupit të tij mund ta ndieja fare lehtë tek gishtat e vegjël që trokisnin në krahun e karriges dhe frymëmarrja e shpeshtë që përpiquej ta kontrollonte.

Disa herë bëra të kthehem nga ai, por një forcë e pashpjegueshme më mbante të ngulur në atë pozicion ku isha. Përpiquesha të gjeja fjalët e para, të zbuloja se ku ishte gjeneza e mbarimit të asaj heshtjeje të rëndë plumb, por s'dija t'i bija në të. Dhe sa më shumë kohë kalonte, aq më shumë ajo rëndohej, si një tendë mus-hamaje mbi të cilën rëndonin ujërat e qiellit, derisa të vinte momenti i pashmangshëm i rënies në tokë, me ujën që shpërndahej nga të gjitha anët.

Por nga cila anë, atëherë, ta mbaja atë tendë që uji të mos binte në tokë? Si mund të predikoj, si mund t'i flisja atij djaloshi, kur e dija se fjalët e mia ai do i gëlltiste pa i përtypur, se trupi i jetës së tij do të ushqehej nga ajo që do t'i thosha unë?

Kush ishte ai që mund të mbante një barrë kaq të rëndë mbi shpinë? Cila ndërgjegje do lejonte që ai ta çonte jetën sipas asaj që thoshte ajo? Jo, kjo ishte një barrë që s'mund të mbahej nga njerëzit, por vetëm nga zotat.



Por zoti s' ishte aty në atë dhomë. Dhe në sytë e atij djaloshi unë isha lidhja e vetme me të. Unë isha lajmësi i fjalëve qiellore, që do ia heshtnin dridhjet e shpirtit nga dyshimet e përjetshme. Por unë nuk isha më prift. Kisha hequr dorë nga ajo detyrë pikërisht ngaqë nuk mund të flisja më në emër të zotit. Nuk mund të isha më mblesi i tij.

Sa herë që dëgjoja, në mesin e asaj heshtjeje të tmerrshme, hezitimin e buzëve të tij për të thënë diçka, trupin tim e kaplonte frika ndaj asaj që mund të më pyeste dhe, më e keqja, ndaj fjalëve që do t'më duhej t'i thosha. Dhe si t'i përgjigjesha një pyetjeje si «A ekziston ferri?» A nuk ishim unë dhe kolegët e mi që i kishim thënë se po, ferri ekzistonte, e nëse nuk besonte mjaftueshëm, atëherë atje do të përfundonte? A nuk pyetej gjithmonë për ferrin më shumë se për parajsën (sa i vakët është imazhi i saj!), ngaqë frika për ekzistencën ishte më e madhe se ideja e lumturisë së përjetshme? Si mund t'i thosha që nëse besonte më shumë te zoti, as që kishte pse të shqetësohej për ferrin, kur tani isha i mendimit se besimi i vërtetë nuk të ngujonte me duart mbërthyer pas një shtylle absolute, por të lejonte ta lëshojë veten në lumin e mistershëm të jetës! Madje tani as këtë s'mund t'ia thosha, as mendimet e mia të vërteta, jo si prift, por ato përtej asaj rrobe. Ideja e predikimit tashmë më fuste tmerrin.

Nëse s'do të kishte trokitur dikush në derë, nuk e di edhe për sa do kish vazhduar ajo heshtje e mallkuar.



Personi që trokiti ishte e njëjta grua që më kishte zbuluar identitetin që po përpiquesha të braktisja, e kur më pa se nuk isha vetëm, fytyra e saj shndriti nga mendimi se e kisha kuptuar gabimin e se i qeshë kthyer detyrës se rrëfimit. Por ndritja e fytyrës së saj u shua menjëherë, sapo u kujtua për arsyen pse kish ardhur aty.

Për të me dhënë lajmin, ajo m'u ngjesh gati në fytyrë, e një sy e kish nga unë, e tjetrin nga Andrea. Me zë fare të vakët, sikur të mos qe duke folur ajo, por dikush i largët, të cilit aty i vinte vetëm jehona e asaj që thoshte, gruaja më lajmëroi se sapo kish vdekur gjyshi i Andreas (dhe bëri me kokë drejt tij), e se unë kërkohesha që të lutesha për herë të fundit për shpirtin e tij.

Kur u ktheva në dhomë për të marrë xhaketën, sytë e Andreas po shndrisnin nga përlotja, e trazimi i tyre shprehte qartë dallgët me të cilat po ndeshej tani shpirti i tij. E mora për krah, e së bashku bëmë drejt dhomës ku pritej përsHPirtja.

Aty po na prisnin të gjithë. I ndjeri qe vendosur në mesin e tyre, mbi dysheme, i mbuluar me një cohë të madhe të zezë. Trysnia e shikimeve të të gjithëve më bëri t'ia lëshoj dorën Andreas e t'i afrohesha trupit të të ndjerit. Kisha qenë me dhjetëra herë në praninë e vdekjes, por kjo m'u duk se qe hera e parë. Pushteti i saj ishte i gjithanshëm, heshte çdo gjë përveç rrahjeve të zemrës.

I ndieja mbi shpinë të gjitha mendimet e njerëzve në



dhomë. Jetët e tyre peshonin mbi mua edhe me shumë se vdekja. Por ç'të bëja? Ç'të bëja?!

Gati instinktivisht, vendosa duart mbi gjoksin e të vdekurit, aty ku e ndieja se zemra e tij vazhdonte ende të ushqejej nga jehona e largët e jetës që kish kaluar në këtë tokë. Dhe në atë çast, ajo ishte e vetmja gjë që kishte vlerë për mua. T'ia nderoja të gjitha orët dhe ditët që nuk do kishte më mundësi t'ua provonte preken e butë e të fortë në lëkurë. Të lutesha që toka t'ia pranonte trupin, ashtu siç njerëzit e tij të dashur e kishin pranuar, përtej të gjithave, në mesin e tyre, e që ajo të ushqejej me trupin e tij ashtu siç ai u ushqye nga frytet e trupit të tokës. Dhe në fund, të shpresoja që shpirti i tij të jetonte në shpirtin e gjithë njerëzimit, e ta ndihmonte sadopak në luftën ndaj kaosit të këtij misteri të quajtur jetë.

Të gjitha këto fjalë më dolën si një mërmërimë, dhe të gjithë përreth po më shoqëronin, secili në mënyrën e vet. Pastaj u ngrita dhe bëra drejt dritares. Dielli kish mbërritur pikën me të ulët në qiell, por ca rreze dalloheshin ende pas vargmaleve të largëta, duke i dhënë errësirës, që po bëhej gati të na mbulonte edhe njëherë, një hije të kuqërremtë. Të dukej sikur ishe para një pikturë gjakatare, por njëkohësisht aq harmonike.

Mbi shpinë ndieja sytë e Andreas. E dija që gëlonin nga mijëra pyetje. Por përgjigjet e tyre ai duhej t'i gjente vetë. Ai dhe vetëm ai ishte zoti i jetës se tij.

Fija e fundit e perëndimit u fsheh pas maleve, e në



zemrën time shndriti një tjetër dritë. Në atë çast të lumë, si një vazhdim vetjak i përshpirtjes, nga goja që më dridhej dolën këto fjalë: «O jetë e bekuar, sa herë të kam harruar, sa herë të kam përdhosur, sa herë s'më ke mjaftuar. Ti je gjithë ç'ka qenë e gjithë ç'ka do të jetë. Ti je. Ti je. E kjo mjafton.»





Hakërrim

Pjesa e parë

Nuk e di se kur ka filluar të më mendojë kjo ndjesi, por sa herë që ulem në një vend, pavarësisht se sa i paqtë mund të duket, më bëhet sikur kam një çekan mbi kokë, që ushtron presion, që më këlthet në veshë sesi dhe çfarë duhet të bëj nëse dua të jetoj. Kudo ku hedh sytë më janë dhënë kushte për të mbijetuar:

«Nëse nuk e bën këtë, atëherë nuk mund të kesh këtë, por nëse e bën këtë, pas kaq e kaq kohësh do mund të bësh këtë.»

Ju e dini se pa kërkuar pak vrull, të qenit i ri nuk ka dhe aq kuptim, – të kesh eksperiencë që të shkundin nga monotonia e jetës, që ju me aq krenari më thoni se më pret.

«Jetoje tani, që mbrapa të mos pendohesh!»



Ky është mësimi i njerëzve të kësaj bote. Ky është mësimi juaj. Pyes veten, vallë, e keni vënë re se si ky mësim bie në kundërshtim me mësimin tjetër:

«Puno tani, që më vonë të mos kesh nevojë të shqetësohesh për mbijetesën tënde!»

Në mesin e dy urdhëresave të tilla, të cilat shoqëria i vesh me petkun e fjalës «këshilla», gjendet paradoksi, madje dhe absurditeti. Por unë e di që absurditeti nuk ekziston në zemrën e njeriut. Absurditeti nuk ekziston as tek bota. Absurditeti lind kur zemra e njeriut takohet me botën. Është mosmarrëveshja e këtyre të dyjave ajo që sjell në jetë të pakuptimtën. Nëse i shohim veprimet e zemrës pa lapsin dhe kritikën e arsyes, atëherë ajo nuk gjendet as në mbretërinë e të arsyeshmes, as në atë të së paarsyeshmes. Veprimet e zemrës thjesht janë. Por kur dëshira e zemrës takohet me mënyrën se si shoqëria pret që të jetohet jeta, këtu është e pashmangshme të mos ndeshem në mospajtim. Zemra që akoma nuk e njeh veten, kur ndeshet me të panjohurën, frikësohet dhe shpesh herë, që të mos ndihet e vetmuar dhe e veçuar, bashkohet me atë që e frikëson. Kështu frika zhduket dhe pak nga pak mbi krevatin e saj bie gjumi i rehatisë. Po për zemrën që kërkon mënyrën e vet? Që nuk pranon të flejë në krevatin që i japin të tjerët? Ç'fat i kobshëm ruhet për të?

Në fund, e gjitha përmbledhet tek ajo që të gjithë deklarojnë se e njohin më së miri: te jeta. Në jeton më



shumë a më pak. Nëse i pi gjithë lëngun ditës apo në përton të hedhësh hapin. Të tilla mëdyshje ta gërryeyjnë zemrën. E përtypin ngadalë dhe koha të kalon veç duke menduar. E gjitha bëhet lëmsh dhe ndjesia që ndjen në stomak është ajo e humbjes. Të duket sikur je i pafuqishëm. Sikur e gjithë jeta u vendoskërka në zgripin e një vendimi të vetëm, dhe nëse për fat të keq ti nuk zgjedh të duhurën, atëherë e gjithë jeta jote humbet. Një tjetër gur i harxhuar më kot, i cili në vend që të vendosej në kështjellën e civilizimit perëndimor, rrokulliset pa kuptim në kotësinë e dëshirave të zemrës vetjake. Zemra kolektike, në fund, u dashkërka të fitojë. Por zemra ime nuk do t'ia dijë për këtë fat. Ajo është aq e vendosur, saqë këmbëngulja e saj, të tjerëve u duket si mospërfillje. Kujtdo i shfaqet nën hijen e moskokëçarjes, e një rebeleje të heshtur, por që në buzëqeshjen e saj naive, shndrit një dritëz të bezdisshme për çdo sy kureshtar. E në vend që rru dhja e fytyrave të njerëzve përreth ta demoralizojë zemrën time, në vend që t'ia ndryshojë mendimin, a, të paktën, ta vërë në dyshim se është duke bërë një marrëzi, ajo ndizet me shumë, inatoset më shumë, hakërrehet më shumë.

Që ta mundësh këtë paradoks të shoqërisë, pasojat e luftës duhet të bien mbi kokën e dikujt apo diçkaje. Ajo kokë është koha. Nëse unë vendos të luftoj në dy fronte, koha që u kushtoj njerëzve vjen e zvogëlohet. Pak nga pak shkëputesh fare nga e shkuara dhe ajo që

mbetet është gjurma e lehtë në tokën e zemrës, sa për të treguar që ka qenë aty. Kjo mungesë e kohës për njerëzit, në fund, të shkëput nga njerëzit. Ata kërkojnë dhe duan vëmendje; është një element i pandashëm i jetës se tyre. Nëse një syreshi i teket që të mbyllet në kafazin e zemrës së vet, për të kërkuar kush e di se çfarë, atyre aq u bën. Ka plot të tjerë, të cilët japin dëshpërimisht vëmendje, që më pas, me pakëz fat, ta marrin borxhin mbrapsht. Por zemra ime as që do t'ia dijë. Ajo është aq e vendosur, saqë të vetmet gjëra që i interesojnë janë luftërat që ka vendosur në lëvizje. Njëra luftë luhet jashtë, me ushtarët e pashpirtë të shoqërisë, ndërsa tjetra, ajo më gjakatarja, atje, në dhomat e errë-ta të saj.

Nuk e di ç'është më e kobshme: lufta e shoqërisë, e cila qëndron përherë e pandryshueshme, ngaqë të duket sikur një element i vetëm nuk mundet ta ndryshojë të gjithë bashkësinë; apo lufta e zemrës, e cila edhe pse fle çdo natë mbi dyshime dhe nëpër pragjet e dorëzimit, është më e pangopshme sesa çdo lloj zjarri që shoqëria të hedh përsipër.

Nëse s'gjendet guximi të dalësh nga ky burg letrë, atëherë, vallë, ç'ndodh? Mos do të ecje në të njëjtat vija të bardha, të vendosura nga kushedi kush, me urdhra të kushedi kujt, të cilët supozojnë se e dinë ç'është më e mira për jetën? Nëse zemra merr kthesë të keqe, kush të fajësohet? Në fillim, sigurisht, fajësohen njerëzit që të kanë rritur dhe ata me të cilët ke jetuar, por



shumë shpejt kupton se ata nuk dinë gjë. Nuk është faji i tyre! Nëse do mundohesh për të gjetur një fajtor, duhet të kthehesh tek supozimi i mëkatit fillestar. Por në të vërtetë, mëkat fillestar nuk ka. Është e gjitha një lojë faji, dhe fajtori, thuhet, ka vdekur me kohë. Ç'të bëjmë tani, që nuk kemi askënd për të goditur me gurë?

Të gjithë jemi viktima të pavetëdijes. Këtu lind dhe thënia aq e adhuruar nga turma: të jesh injo-rant është lumturi. Ngaqë të qenit i pavetëdijshëm lind kryesisht nga të qenit injorant, atëherë problemet e botës dhe të zemrës janë krejtësisht inekzistentë. Si pasojë, të qenit i lumtur është një rezultat pothuaj automatik. Të jetosh në një botë me paqe është një dëshirë universale, por të jetosh me një zemër ku nuk ka luftë, është mallkim që s'ia uroj askujt. Vallë, atëherë, si do e dija që ekzistoj? Nëse gjithçka është për t'u venë në dyshim, atëherë asgjë s'është e sigurt! Ky është logjikimi i Dekartit. Gjithsesi kemi diçka të sigurt: që gjithçka është për t'u dyshuar. Dhe ngaqë unë mendoj mbi këtë dyshim, si pasojë e di se ekzistoj. Pra, ngaqë mendoj, e di se ekzistoj. Por të menduarit nuk vjen asnjëherë pa pasoja. Nuk vjen asnjëherë pa peshën e rëndë të të qenit i vetëdijshëm. Dhe vetëdijshmëria nuk vjen asnjëherë e pashoqëruar. Me të vijnë vuajtjet e botës që ka ikur dhe është. Vijnë gënjeshttrat që dëgjon çdo ditë, e qëndrojnë çekan mbi kokë. Që nuk mund ta kapësh tjetrin për fyti e ta bësh të mendojë. Vijnë me

gabimet e zemrës sate, me barrën e kohës së ikur dhe me udhëkryqet e vendimeve. Të rrjedhë në udhën e vjetër, të dëgjojë prindërit, të cilët edhe pse ta duan të mirën, pavetëdija e tyre mbi atë që kërkon zemra jote, e bën të dëmshëm imponimin e tyre mbi ty; apo të rrjedhë në udhë të panjohura, atje në xhunglën e pamasë të ndjenjave që sapo ke filluar të njohësh?

Udha e vjetër është ftuese. Çdo pyetjeje i është gjetur një përgjigje me kohë, ndaj mendja dhe zemra nuk kanë nevojë të bien në kundërshti me njëra-tjetrën. Koka mund të prehet e qetë mbi nënkresë. Edhe pse liria është ajo që njerëzit mendojnë se duan, zakonisht përfundojnë të tunduar nga rehatia. Ashtu si zogjtë, ata ecin në jetën e tyre pa menduar me veten: përse po e hedh këtë hap në këtë mënyrë? Nga ç'skutë doli kjo arsye që po e ndjek kaq verbërisht? Këto pyetje janë çekani i udhës se re, në fundin e se cilës të pret kulla jote e ngujimit.

Në udhën e vjetër vetmia është sëmundja. Në udhën e re vetmia është ilaçi.

«Çfarë gjendet në atë kullë?» pyesni.

Djajtë, sigurisht. Nëse kalon mjaftueshëm kohë me veten, është e pashmangshme të mos e hedhësh përtokë perden me të cilën ke mbuluar gjysmën e vetes. Ndoshta ja përse djajtë shihen nga turma si entiteti kundërshtues i së mirës. Siç dihet, turma është përherë në kërkim të kësaj të fundit. Por mënyra si turma e kërkon të mirën s'më bind. Ajo merr medaljen



në dorë, e kthen sa nga njëra anë në tjetrën, dhe thotë:

«Fshijeni të keqen. Vetëm e mira duhet të jetë këtu. E keqja s'ka vend mes nesh.»

Dhe ajo fshihet. Ajo që nuk kuptohet është se, siç thotë dhe një poet i vjetër, kur djajtë vdesin, engjëjt vdesin gjithashtu. Nëse vendos ta fshehësh të keqen që ke brenda vetes, të mos e njohësh atë, atëherë njëkohësisht je duke hequr dorë nga një pjesë e rëndësishme e vetes, je duke e vendosur në hije, duke e quajtur të panevojshme. Si pasojë nuk je me i vetëdijshëm për të. E fsheh në harresë dhe mendon se ajo nuk është më pjesë e jotja. Por ajo është ende aty. Gjithmonë. Aty, në heshtje, vështrohet dhe rritet, e ngaqë nuk je vigilent, ngaqë nuk beson më në ekzistencën e saj, ajo është e lirë të zgjohet kur të dojë, t'i marrë në dorë veprimet e tua dhe t'i kthejë përmbys. Pasi përfundon misionin, kthehet përsëri në qoshkun e saj, në hije.

Kur kupton se ç'ka ndodhur, kë do fajësosh? Nëse nuk je i vetëdijshëm për monstrat që fsheh brenda vetes, është e pamundur të identifikosh fajtorin. Gishti yt do jetë gjithmonë i drejtuar në vendin apo personin e gabuar. Duke qenë i verbër ndaj errësirës sate, pak nga pak ti shuan dhe atë pak dritë që ke.

Ç'gjetet në kullën e ngujimit? Kush arkitekt e ka ndërtuar? Ç'shakatar tallet kështu me ty? Mungesa e përgjigjes veç shton shqetësimin. Ka ditë kur ankthi arrin kulmin dhe bëhesh gati të dorëzohesh. Shkon deri te dera e rëndë e kullës dhe e sjell të gjithën në

kokë: largimi nga kulla, ajri i freskët që të hyn në mushkëri e të jep gjallëri, dielli që shndrit dhe ngroh. Nga larg dëgjon gumëzhima njerëzish. Duket si festë. Hare. Sa kohë që s'ke qenë mes haresh?! Sa kohë je harruar në mesin e ferrit të pamëshirmshëm! Pak nga pak muskujt shkrijnë. Hedh hapin dhe zemra fillon të rrahë më shumë, e lumtur me çdo metër që largohesh nga ai ngujim i panevojshëm. Vallë pse ishe futur aty? Ç'doje të zgjidhje? Mos do zgjidhje problemet e botës? Do shfarosje urinë e botës aty brenda? Do gjeje burimin e lumturisë së përgjithshme? Ç'iluzionist! Je ngujuar, gjasmë do gjesht ndonjë kurë për vuajtjen e njerëzimit. Para, djalosh! Drejt festës... Hapat shpejtohen. Buçitja e zemrës arrin në veshë. Një buzëqeshje e gjerë ta kaplon mendjen. Çdo gjë të gjetur në kullë e le atje brenda. Më në fund arrin tek festa. I gjen të gjithë duke kërcyer. Të gjithë duke pirë. Të gjithë të harruar... Bashkohesh me ta. Futesh në mesin e valles dhe harrohesh, harrohesh, më në fund harrohesh...

Me dorën mbështetur tek dera, e kalon këtë fantazi disa herë në kokë. Bind veten se atje jashtë ashtu do të jetë. Por në mendimin e fundit, aty në mesin e valles iluzionuese, të kap një ndjesi. Është diçka e vakët, gati e padukshme, por përsëri kaq ngulmuese. Të duket sikur të thërret. Thirrje e largët, që duket e huaj, por në zemër të zemrës e di se është e jotja.

«Mos ik», të thotë. «Rri dhe pak.»

Dora jote e lëshon derën. Zëri, që e di se vjen nga



maja e kullës, bëhet më këmbëngulës. Fillon e merr shkallët ngadalë. Pastaj shton shpejtësinë. Zëri tashmë hakërrehet.

«Eja», të thotë dhe jehona e tij përplaset në muret e buta të zemrës.

Pa frymë arrin në majë; ulesh, lëshon duart mbi gjunjë, mbyll sytë dhe kërkon përsëri atë që zhurma e gënjeshtërt e botës jashtë u mundua ta mbysë. Kërkon edhe njëherë zërin tënd.

Pjesa e dytë

Njeriut, që të durojë vdekshmërinë, i duhet njeriu. Këtu hyn ajo që ju më keni dhuruar. Më keni dhënë njerëz përtej meje.

Nuk ka ditë që s'jam në dyshim, jam unë i çmendur, apo të tjerët? Ndoshta e vërteta mbijeton me të vërtetë e vetme, por tek lëviz në këtë botë, ku zotat janë dëbuar, e ku i vetmi shkëmb ku mund të mbështetem janë njerëzit, e vërteta shkërmoqet para syve të mi në mijëra dromca gënjeshttrash, në rrenat që u keni thënë këtyre njerëzve, të cilët kur zgjohen, për të krijuar të vërtetën e gjithëpushtetshme të shoqërisë që kanë krijuar, i ngjisin me lëngun e mbetur të shpirtit.

Zotërinj, besomëni! Nuk do të doja gjë tjetër veçse të kuptoja sa lëng u ka mbetur dhe a do të mjaftojë për të ngjitur ditët që do vijnë? Lëngu im, e ndjej, po shteret. Kur zgjohem, thërrmijat nuk i gjej më të bashkuara në një madhështi të vetme, por të shpërndara kudo. Janë aq shumë, sa shpesh duhet të qëndroj në shtëpi që t'i ngjis, dhe është kaq e vështirë. Nganjëherë më zë nata duke ngjitur vetëm fundin e këtyre çikërrimave. Pastaj çdo çikërrimë ka nga një



version ndryshe, të cilin duhet ta vendos në koherencë me versionin e mëparshëm, me atë që vjen më pas, dhe mbi të gjitha, me atë që krijojnë të tria së bashku, të cilin duhet ta ngjisësh veçanërisht me shumë lëng. Fatmirësisht kam blerë një ngjitës të mirë, që nganjëherë mban për javë të tëra, por më kanë mbetur dhe shumë pjesëza pa u plotësuar. S'e di në do t'ia dal ndonjëherë.

T'ju falënderoj a t'ju mallkoj?

Ka ditë që e ndiej veten fatlum, se të paktën, jam duke dhënë një kontribut në ndërlidhjen e pjesëzave të shkërmoqura të së vërtetës njerëzore, por ka ditë (dhe këto janë të këqijat!) kur e ndiej veten si qenien më të mallkuar. As Sizifi nuk ishte kaq fatkeq. Ai të paktën e dinte se ç'kishte për të bërë. Kishte punë të mërzitshme. E njëjta çdo ditë. Por me ju, me njerëzit që më keni dhuruar, mërzia është gjëja e fundit që më jepet.

Dhe kjo s'është gjë e mirë. Oh, jo! Ky është tmerr! Përse nuk më dhuroat mërzi më mirë? Do ishte shumë më e lehtë. Do e ngrija gurin tuaj drejt çdo mali. Vetëm të ma hiqnit qafe këtë barrë, këtë detyrë, e cila po ma thërrmon shpirtin në qindra pjesë... Dhe është e pashmangshme që pjesët e mia të mos bashkohen me pjesët tuaja. Pastaj puna rëndohet, sepse tani me duhet të gjej edhe të miat, duhet t'i vendos në një anë të veçantë dhe në fund, nëse mbetet ndopak ngjitës, t'i vendos brenda meje në rregullin e duhur.

Puna që më keni dhënë (që kam marrë përsipër!), në thelb është e pamundur, por nuk është pamundësia ajo që ma bren shpirtin. Është mënyra si copëzat ndryshojnë nga dita në ditë. Nëse një mëngjes merrem me një pjesë të caktuar të tablosë, ditën tjetër ndiej se piktura ka ndryshuar.

Nuk e kuptoj! Si mundet tabloja e së vërtetës të ndryshojë nga njëra ditë në tjetrën? Sidoqoftë, e ul kokën, sepse ju kështu më keni mësuar, ndaj i futem punës me më intensitet dhe shpresë se ditën e mëparshme. Ama, shpresa është dredharake. Dhe ju, jeni mjeshtrit e saj. E dini se ajo është droga më e fuqishme? E dini mjaft mirë! Ja përse ato mijëra, miliona thërrmija të tablosë, para se bota të flejë gjumë, i injektoni me shiringën e shpresës. Ja përse, ditën tjetër, edhe pse të shteruar nga lëngu e të shkërmoqur në aq shumë pjesëza sa nuk mbajnë mend as fytyrën e tyre, ata dalin nga shtëpia me buzëqeshjen më të bukur që mund të shohësh ndonjëherë e që mua më tmerron. Po, po! Mos u habisni! Më tmerron! Një dozë e tillë droge është e pashëndetshme. Është iluzionare. Është arsyeja përse lëngu shterohet aq shpejt. Përse copëzat nuk e gjejnë njëra-tjetrën pa pasur nevojën time. Përse tabloja bie çdo natë nga muri dhe thyhet, e thyhet, e thyhet...



o o o

Siç e dini, ne jetojmë në një shtëpi dykatëshe. Ju ndodheni në katin e parë, ndërsa unë në të dytin. Dëshira juaj, e ndjej, është të vini dhe të shikoni se ç'ndodh në katin tim. Por, fatkeqësisht, kjo ndërtesë është pakëz e veçantë. E keni ndërtuar ju, por gjatë ndërtimit keni harruar të vendosni shenjat e gishtave tuaj në këtë ashensor super-teknologjik ndaj, si pasojë e këtij gabimi fare të vogël, ju nuk mund të vini tek unë. Por keni menduar për mua! Nuk di si t'ju falënderoj. Keni menduar për mua, vetmitarin e katit të dytë. Sa herë dua, mund të hyj në ashensor, të zbres në kat të parë, e të dëshmoj përtej xhamit transparent, aktivitetet e trurit dhe zemrës suaj. Dhuratë e bukur, por kam ca ankesa. Nganjëherë, ndihem i vetmuar. Kati im ka pak banorë. Mblidhemi nëpër darka, por zhurma e festës suaj i mund bisedat tona. I thërrmon në qindra pjesëza dhe ne, sigurisht, zhytemi përsëri në punë për të gjetur copëzat e rëna në tokë. Jeni përpjekur për të hipur në ashensor. Jeni përpjekur edhe për ta gënjyer e mashtruar ashensorin për identitetin tuaj, por ashensori mund të lexojë mendimet. Çfarë perëndish jeni! Një shpikje e mrekullueshme! Kështu mund të dëbohen të gjithë sharlatanët nga ndërtesa, nga kati i sipërm që keni ndërtuar me aq mund. Sigurisht, që pamundësia juaj për të ardhur tek unë

s'është gjë tjetër veçse një gabim teknik i ashensorit. Duke mundur të lexojë mendimet, ndoshta ai është bërë ndopak njerëzor dhe ju ka marrë zili. Sidoqoftë, zonjat dhe zotërinjtë e mi, mos kini merak. Mërzinë e syve tuaj mund ta shoh që nga lart. Ja përse zbres çdo ditë, që ta rregulloj atë dreq ashensori. Kaloj orë të tëra brenda tij. Punoj si i marrë, duke i shtypur butonat në miliona kombinimet e tyre të mundshme, por akoma nuk i kam rënë në të. Ndoshta faji është imi, që nuk di mjaftueshëm, por nuk mund të mos i vë sadopak faj dhe disave të katit tuaj, që, kur më shohin duke punuar, me drejtojnë gishtin dhe më quajnë të marrë që merrem me një punë që nuk ka të ndrequr. Ndoshta kanë të drejtë. Por duhet ta provoj! Dhe më vjen keq ta pranoj se, nganjëherë, tek e gjej veten të pashpresë dhe mendoj për arsyet pse po e bëj gjithë këtë, përveç dëshirës për t'u bërë njësh me ju, është dhe dëshira e fortë që një ditë ju të bëheni njësh me mua. Mund të më quani egoist, por ju keni eksploruar aq pak nga kati im, nga dimensionimi i këtij kati që e keni ndërtuar me duart tuaja, sa më duket e padrejtë ndaj meje, ndaj këtij punëtori të palodhur, që të ma neglizhoni punën dhe të thoni se e bëj vetëm për veten; se dëshira që të vij në katin tuaj, na qenkërka për të futur hundët në ekzotizmat që vetëm ju mund t'i sillni në jetë. Sigurisht, do të ishte e gënjeshtërt nga ana ime nëse do të thosha që nuk kam dëshirë për ju, zonjat e mia, sepse në katin tim shterpësia është çdo ditë në rritje, por më



shumë se kjo, dëshira ime që katet tona të bëhen një, i tejkalon të gjitha.

Kur e mendoj pak më gjatë, bie në dyshimin mos e keni bërë me plan që kati ynë, pra ai i dyti, të lindë si pasojë e juaja, apo mos nga jeta juaj shumë e zënë, si një mendim revolucionar, e keni ndërtuar këtë ashensor për ne (mua dhe disa të tjerë të mjerë) dhe e keni bërë çelësin të tillë me qëllim që ne të vijmë atje, por ju të mos keni pse të vini këtu... Në fakt, ju jap të drejtë. Ç'doni ju tek ne? Këtu jeta është e mërzitshme. Festat dhe orgjitë bëhen te ju. Ah, i kam parë. Po! I kam parë përtej xhamit. Janë plot ngjyra. Qeshja juaj është kaq ngjyëse, sa ndonjëherë, harroj pse dreqin jetoj në katin e dytë dhe bashkohem me ju. Festoj! Pi alkool e drogë. E humbas edhe atë pak lëng jete dhe vetëdije që më ka mbetur. Dhe, që ta dini, ato janë të paktat momente të lumtura të jetës sime. Po, besomëni! Tani e dini pse ju kam zili. Tani kuptojeni përse punoj çdo ditë në ashensorin tuaj.

Dua që atë festë ta sjell tek kati i dytë. Sigurisht që ju dua edhe juve. Pa ju nuk bëhet festë. Jeni arsyeja e mundit tim. E vetmja gjë që dua është të jetojmë bashkë, të kuptojmë materialin ndërtues të çdo kati, të festojmë me njëri-tjetrin.

Por, për dreq, ai gabim teknik!

Në djall me të! Do ta gjej fajtorin. Kush dreqin kishte punë me të njëherë?! Ndoshta ju? Jo, nuk mund të jetë e vërtetë. Ose ndoshta po. Ndoshta e keni parë mër-

zitjen e shpeshtë të fytyrës sime, kur mendoja për katin tuaj. Ndoshta e keni marrë si mëshirë, si keqardhje për izolimin tuaj ndaj katin tim? Në një farë mënyre keni të drejtë. Ç'po them! Jo, nuk keni të drejtë. Ato fytyra nuk janë në asnjë mënyrë faji juaj. Ajo fytyrë, ai shpërthim mjerimi në mua nuk është pasojë e keqardhjes ndaj jush. Nuk keni nevojë për keqardhje. Aq më pak prej meje. Ajo fytyrë është shenjë dëshpërimi që unë nuk jam ju. Është fati im i mjerë, që jam ngjitur në kat të dytë e nuk zbres dot më. Që s'mund të harroj se ç'kam parë në atë kat. Nëse s'do kisha njohur ekzistencën tuaj, atëherë ndoshta diçka e mirë do ndodhte me mua. Ndoshta nuk do e kaloja kohën duke ngjitur copëza pikturash. Do merresha me krijimin e pikturave të reja.

Gjithsesi, ajo që u bë u bë. Nëse ju nuk mund të vini tek unë, do vij unë te ju. Do ta rregulloj atë dreq ashensori, që më në fund të shihni katin tim, dhomën time, pikturat e mia. Të kuptoni se edhe ju mund ta krijoni një kat të tillë. Ju siguroj se nuk do të ktheheshit më në kat të parë. Do t'ju dukej i rëndomtë. Do habiteshit si keni mundur të jetoni atje për aq kohë; si nuk e kishit mobilizuar veten për ta rregulluar ashensorin. Jam i sigurt se, nëse do vendosnit për ta rregulluar, do vinte momenti kur ai do rregullohej. Kam besim në fuqinë tuaj!

Por, tani për tani, jeni të zënë me festa, me buzëqeshje dhe dehje. S'mund të rri pa përmendur dhe



shkatërrimin paksa të qëllimtë të pikturave të mia. Ju shijon të kërceni e t'i hidhni përtokë, por nuk ju vë faj. Ju lejohet. Jeni me të shumtë në numër. Jeni shumica e kësaj shtëpie dykatëshe. Jeni zotat e rinj. Nuk keni kohë të merreni me çikërrima. Ato m'i lini mua, teknikut të ashensorit, ngjitesit të pikturave, shkruesit të këtyre fjalëve.





Jehona

Prej aty ku qëndronte, oborri i jetimores i dukej më i madh se asnjëherë. Një borë e lehtë kishte mbuluar rrugicën kryesore dhe shenjat e kalimtarëve mbe-teshin për pak kohë, derisa mbuloheshin nga e bora e re. Përtej derës ai ndjeu hapa. E dinte se po vinin për të. Kishte dëgjuar zëra nëpër korridore që më në fund dikush po vinte ta shpëtonte nga ai vend, nga ajo vetmi e tejskajshme. Hapat u dëgjuan më afër. Pastaj u ndaluan fare. Një trokitje e lehtë mbi derë. Pastaj një zë i hollë.

«Arbër, aty je?»

Arbri nuk u përgjigj. Një si ndrojtje e lindur aty për aty e kishte kapluar të tërin.

«Po», tha ai më në fund, por iu duk se nuk kishte folur ai. Zëri i kishte ndryshuar, e pat humbur natyrshmërinë.

E përsëriti përgjigjen, këtë herë duke u sforcuar.

Dera u hap ngadalë. Një mesogrua, e thinjur para kohe, me sy blu dhe një qeshje të ftohtë, u shfaq përpara Arbrit, e shoqëruar nga një burrë, i cili ishte serioz dhe nuk kishte drojë ta shfaqte ashpërsinë e fytyrës.

«Arbër, ky është zoti Kurt... Afrohu, mos ki frikë. Zoti Kurt do jetë babai yt. I ke bërë rrobat gati? Të lumtë.»

Arbri herë shikonte gruan që s'pushonte së foluri, herë të panjohurin, Kurtin, babanë e tij të ri.

«Po më dëgjon?»

Arbri pohoi me kokë.

«Merre pra valixhen tënde, ç'pret.»

Përtimthi, ai bëri drejt krevatit. Bashkoi duart tek mbërthyesja e valixhes dhe e ngriti në ajër. Por ajo ishte e rëndë, kështu që e lëshoi pa fuqi në tokë.

Pa ndryshuar aspak çehren e tij, Kurti bëri drejt valixhes dhe e futi nën krah. Me dorën tjetër kapi dorën e djaloshit dhe mori drejt derës. Kujdestarja e jetimores bëri t'i ndjekë, por vendosi të kthehej. Hyri përsëri në dhomë dhe doli në dritare. Bora i kishte fshirë tashmë gjithë hapat njerëzorë.

o o o

«Arbër!»

Ishte e disata herë që e dëgjonte atë thirrje, por një



pezmi i çuditshëm nuk e linte të përgjigjej. Në fillim e kishte gënjer veten se ishte normale. Tashmë ishte pjesë e një familjeje të huaj, me gjuhë tjetër mirëkuptimi; ishte normale të ndihej ashtu. Por ajo ndjesi nuk ishte larguar edhe pse kishin kaluar muaj.

«Arbër!» përsëritej e bërtitura përherë e më egër, e shkulme rrëqethjeje ia përshkonin trupin rinor. Pezmi pastaj largohej, për t'i lënë vendin një mpirjeje të ftohtë e të huaj, brenda se cilës kujtime të një të shkuare jo fort të largët i regëtinin vagëllimthi.

Nuk duhej shumë që të dëgjonte shkapetjen e furishme të derës. Shqiptimi i ngadaltë i shkronjave të emrit të tij e bënte të strukej poshtë velenxës. E dinte se nuk kishte shpëtim, por përsëri, iluzioni i mbrojtjes dhe i ngrohtësisë e zhyste në shpresën mos ndoshta e kaluara do kthehej, do evokohej brenda tij, e gjithçka do të ishte veçse një ëndërr e keqe. Por sa ndiente mbërthimin e fortë të të atit, gjithçka venitej drejt haresës, drejt asgjësë së pamëshirshme.

«Përse nuk përgjigjesh?» thërriste i ati dhe hiqte rripin e lëkurtë nga pantallonat. «Sa herë të kam thënë? Sa? Të bësh atë që të them unë. Vetëm unë!»

Kishte herë kur bënte të përgjigjej, t'i bindej, por përherë e ndalte diçka. Ajo jehona e dobët, e largët, vinte furishëm drejt tij e i ngecte në lukth, duke ia gëlltitur fjalët e lotët.

Goditja e parë ishte përherë më e keqja. E godiste në kraharor, krejt afër zemrës. Pastaj ulej drejt bar-

kut dhe, në fund, i binte këmbëve, për t'ia ndërprerë mundësinë e arratisjes. Në fund Arbri lëshohej për-tokë, duke hapur gojën aq sa të përgjigjej, por tashmë ishte pafuqia ajo që e ndalonte. Vetëm kur dëgjonte zhurmën e rëndë të këmbëve të të atit duke zbritur shkallët qetësohej disi dhe hapte sytë i çliruar.

Kishte herë kur i ati ndryshonte tërësisht. E merrte përdore, e shëtiste kudo nëpër qytet, i blinte akullore dhe e hipte në të gjitha lojërat e parkut. Në fillim Arbri stepej. Shenjat mbi trup e ndalonin të bënte qoftë dhe një hap të pasigurt. Por pastaj gënjehej dhe lehtësia e mendjes ia stiste në harresë shenjat e trupit. Fillonte të ndihej më mirë, më i mbrojtur; sikur çdo gjë e ndodhur më parë të kishte qenë një keqkuptim, një vuajtje e domosdoshme për hir të lumturisë që do vinte më pas. Ky mendim e bënte të fliste për familjen e tij të vjetër, se si në fillim e kishin quajtur Ilir, e më vonë ia kishin ndërruar në Arbër. Dhe se si atij i pëlqenin të dy emrat, sepse vinin nga e njëjta rrënjë, nga i njëjti burim mendësie. Gjithë ngazëllim kthente kryet drejt fytyrës së të atit, vetëm për të gjetur dy sy të akullt dhe entuziazmi i shuhej aty për aty.



ooo

Një jehonë e vakët brenda tij i thoshte se diçka kishte lënë pas. Një ide të vjetër, rrënja e së cilës kishte mbetur akoma diku thellë, e shpëtuar prej zjarreve të harresës; a ndonjë shkronjë e ndonjë gjuhë që nuk e dinte më. Vinte bast me veten se disa shkronja i mungonin dhe emrit të tij, por nuk rrekej dot t'ua gjente origjinën.

Përherë e kishin quajtur Ab. Ab kur i ati i mësonte traditën e familjes. Ab kur i tregonte të mirat e ideologjisë, e fenë e atit të atit të tij. Ab kur Kurti iku për disa vite. Ab kur ai u kthye përsëri. Ab kur shikonte reflektimin e tij në sytë e të tjerëve. Vetëm në një vend nuk ishte Ab: vetëm kur dilte para pasqyrës. Rrekej gjithë ç'mund ta kuptonte zanafillën e asaj paqartësie, e asaj thirrjeje të shurdhër e të largët, por zjarri kishte lënë pak ose aspak gjurmë. Mund të gjendej ndonjë cifël e vjetër, ndonjë e zezë mes fushës së gjakut të së shkuarës, a ndonjë shkronjë, që s'e dinte pse përpiqej t'ia vinte emrit të tij, por përherë pa sukses. Ab, thoshte me vete, por thellë diku në brendësi, jehona e përjetshme e zemrës krijonte një emër tjetër, më të vjetër se ai, më të vjetër se Kurti, se i ati i Kurtit, se gjithë ç'ka njihnte a kishte për të njohur ndonjëherë.



Rozafa

1.

Sot u zgjova pa lindur drita e diellit. Jashtë, një mjegull e dendur e ka mbuluar qytetin nga çdo anë, e tek s'mund të shihja gjë nga dritarja, verbëria e syve më futi në kujtimet e largëta të fëmijërisë së kaluar në fshat.

Ai kujtim më ndenji për një copë kohë mbi krye, pastaj e shkunda nga supet siç dhe dielli shkundi mjegullën, e mora drejt tregut të qytetit. Ndryshe nga ç'bëja përditë, për një arsye që s'e di as vetë, nuk i rashë rrugës së përhershme, por mora atë që kalon poshtë kodrës së madhe.

Po ecja i përhumbur në mendime, kur syri m'u vodh drejt tre burrave që po thyenin gjithë mund ca gurë të mëdhenj. Mollokë. Gjithë kureshti u afrova t'u flisja.

«Puna e mbarë, o trima.»

Tre burrat u kthyen përnjëherësh.

«Mbarë paç, o plak», thanë ata. «Po ku na e sheh të mbarën! Kemi gjithë ato javë që punojmë në këtë kodër, e nuk po shohim hajër; e ngremë murin ditën, e na shembet natën.»

Ai që dukej si më i vogli, m'u afrua e më pyeti gjithë ndrojtje.

«A di ti gjë, o plak i mirë? A di ndonjë derman për hallin tonë?»

Fjalët e tij më ndërmendën menjëherë kujtimin e tim gjyshi dhe mësimet e tij të lashta kanunore.

Edhe pse s'isha i sigurt, ua thashë atë që mendoja. Në fillim ata u trandën, por s'u desh shumë që të binin në paqe me të. Më falënderuan në heshtje, pastaj vazhdova rrugën drejt tregut, me një si boshllëk të krijuar në gjoks.

2.

Sot përsëri e njëjta histori. Edhe pse jemi marrë me Sketë mur për javë të tëra, përsëri dështojmë si ditën e parë. Një magji e ka pushtuar këtë kodër; ose neve.

Në fillim ja vumë fajin erës. Si rrallë ndonjëherë, kjo verë ka qenë e thatë, me një si stuhi shkretëtire, e plogësht, me pak diell, i cili edhe kur del na bëhet se na thotë: «As unë s'kam ç't'ju bëj». Por në fund erdhi



vjeshta e shpresa na u ngroh disi, paçka se ajo është veçse paraprijësja e dimrit. Prapëseprapë na duhej të shpresonim.

Por ishte e kotë. Natën muri shembej që shembej.

As sot nuk ishte ndryshe. U zgjova më herët se vëllezërit, të cilëve u bie të lodhen më shumë pasi janë më të vegjël. U solla nëpër shtëpi, por pas kaq shumë kohe që merrem vetëm me ndërtimin e këtij muri të mallkuar, më duket vetja i huaj në shtëpinë time. Dola jashtë me hapa të shpejtë. Nusja më pa, bëri të thoshte diçka por e mbajti gojën. Me t'ju afruar murit, nga mjegulla e dendur, m'u dha iluzionit se muri i kishte qëndruar natës e mallkimi që mbaruar më në fund. Por jo. Kur u afrova, çdo gur që hedhur përtokë, sikur një shtrigan t'i kishte goditur me shkopin e tij të lig, e diku prej së largu ai po qeshte me mua.

U kapa aq keq pas kësaj ideje, sa për pak iu hodha sipër një plaku që kaloi pranë nesh. Fatmirësisht e kuptova marrëzinë time kur ai na përshëndeti e u ndal të kuvendonte me ne.

Sidoqoftë, kur ai mori rrugën përsëri, e qeshura e largët e magjistarit m'u kthye përsëri ndër veshë, pasi ajo çka na tha plaku veç prej të ligut mund të vijë. Por në fund të fundit, ishim ne ata që e pyetën. Në fakt e pyeti vëllai i vogël, por po të mos e kishte marrë ai atë hap, do e kisha marrë unë.

3.

Sot u zgjova më herët se zakonisht. Këto ëndrra të Smalluara s'ka natë që t'më lënë rehat. Është gjithmonë e njëjta ëndërr: një mjegull e zezë ma mbulon gjysmën e trupit e sado përpiqem, s'mund të shkëputem prej saj. Zgjohem ujë në djersë, por nuk duhet shumë që ta kuptoj se qe thjesht një makth. Çohem e shkoj te djepi i të voglit tim, të cilin edhe pse s'ka më shumë se disa muaj që e kam lindur, më duket se kam gjithë jetën që e njoh. Duart e tij të vogla, që luajnë me ajrin e kërkojnë fytyrën time, ma heqin pezmin e ëndrrës sikur të mos kishte ndodhur kurrë.

Trimat janë zgjuar herët. Kanë hallin e murit, e di. Sa net u bënë që asnjëri prej tyre nuk vë gjumë në sy prej tij. U shtihet dhe në ëndërr, si mua ajo mjegull e mallkuar... Sot është radha e kunatës së madhe për t'u çuar bukën. Nesër është e kunatës së mesit. Pastaj e kam unë. I mbaj ditët shënim, pasi kështu e di kur t'i jap gjë djalit në mëngjes, e kur jo...

Nga mesdita ndodhi diçka e çuditshme. Po nderja rrobat në oborr, kur pa dashje dëgjova dy kunatat duke folur në dhomën përbri. Diç kishte ndodhur. Këtë e kuptoja nga mënyra si pëshpëritnin. U bëra kurreshtare dhe u afrova më shumë.

Një plak kishte folur me trimat para ca ditësh e nga



biseda kishin mësuar më në fund si ta mbanin murin në këmbë. Plaku u kishte thënë se njëra prej vashave, ajo që do u sillte bukën, duhet të murosej. Vetëm kështu do qëndronte.

Tek i dëgjoja ato fjalë, një si komb m'u bë në fytyrë. M'u dhimbs kunata e madhe, se fati kish dashur të ishte dita e saj për t'ua çuar bukën trimave.

Nuk u desh shumë që mendimi im të vinte në jetë, sepse aty për aty u dëgjua zëri i nënës plakë tek thërriste kunatën e madhe. Prita që ajo t'ia jepte kujës, por jo. Zëri i saj doli i ndryshuar, i vargur, sikur papritur t'i kishte rënë sëmundja, e pa dalë nga dhoma ajo i tha nënës se s'mund të ikte dot se qe sëmurë.

Atëherë nëna ju kthye kunatës tjetër. Por as ajo nuk pranoi. I tha se kishte për të shkuar në gjini.

Në fund, nëna m'u kthye mua. Kur dëgjova emrin tim, ndjeva të ma çante zemrën në gjysmë një shkrep-timë. Dhe e kuptova. Burrat do ta kenë bërë me fjalë të mos u tregonin nuseve, e vetëm trimi im e ka mbajtur fjalën.

Nëna më thirri për të dytën herë. Kur hodha hapin, gjunjët po më dridheshin. Shkova në dhomë e mora djalin në krahë. E përqafova me gjithë shpirt. Ja putha këmbë e duar. I shkreti i nënës qeshte.

Nëna thirri prapë. E vura djalin në djep e dola jashtë.

Qe bërë gati të më thërriste prapë, por kur më pa me bukë e ujë në dorë, nëna plakë buzëqeshi lehtë. Qëmoti s'e kisha parë të buzëqeshte ashtu. Në sytë e

saj shndriste një shkëlqim plot dhimbje. Më dha ura-tën e u nisa.

4.

Nuk kam vënë gjumë në sy gjithë natën. Në fakt, ka muaj që gjumin e bëj më të keq se moti, por netët e fundit gjumi është huajtur me mua. Kthej kryet nga gruaja, e kur e shoh ashtu të fjetur, më pikon në zemër. Nuk mund t'ia them. Do të ishte e padrejtë... Por çfarëdo që të bëj, të hesht a të flas, unë bie në padrejtësi.

E njoh mirë. E di se nuk do e kursente jetën për askënd, qoftë dhe për murin. Është kokëmushkë. Por zemra e saj del mbi kokëfortësinë. E ndiej kur e shoh tek luan me djaln tonë. Në ato çaste, më duket se vetë zotat po i shohin bashkë me mua.

Por po ata zota që i kam falënderuar për jetën që më kanë dhënë, po ata zota i mallkoj për gjëmën që më lëshuan mbi krye. Por kujtohem... Ajo nuk ka qenë dita e gruas sime për ta sjellë bukën. E sa ia shoh sytë e mëdhenj e të bukur, sa fitem brenda në shikimin e saj, i kuptoj të gjitha... E përqafoj fort dhe e puth në ballë. I pëshpëris në vesh se sa e dua, e i kërkoj falje... Ajo nuk flet. Shikimi i saj më pret si shpatë, që me futet thellë në zemër e ma ndan në gjysmë.

Te vendi ku do fillonim murin vajta vetëm unë.



Vëllezërit ndenjën pak më larg. Një hije e rëndë ua ka pushtuar fytyrat. E njoh mirë atë hije.

E bukura ime nuk flet. Pastaj diç i kujtohet.

«Kam parë një ëndërr», më thotë. «Sikur një mjegull me ndan në gjysmë e s'mund të shqitem prej saj.»

Mua më rrodhi një lot. Qe loti im i parë si burrë, edhe pse burrë s'mund ta quaj më veten. Pastaj hodha sytë mbi fytyrën e saj për herë të fundit, brenda syve të mëdhenj e të bukur, të cilët para se të mbylleshin përjetë, m'u lutën për djalin tonë.

5.

Këto mure i mbaj mend qysh në vegjëli. Aroma e Ktyre e thatë ma mbush trupin me një qetësi të paemër, e më bëhet sikur jemi vetëm ne në këtë botë, e kjo mjafton.

Im atë është plakur tashmë. Forcat e kanë lenë, e rrallë ndonjëherë del jashtë. Ende dhe sot më duket e pabesueshme që ai dhe xhaxhallarët e ndërtuan të vetëm gjithë këtë kala. Kur ia shpreh admirimin tim, në fillim ai qesh, por pas një çasti rrudh vetullat, e me zë të prerë më thotë:

«Kështjellën e ka ndërtuar veç një njeri, e ajo është mëma jote.»

Ati nuk flet kurrë për nënën. Por ka ditë kur ai men-

don se është vetëm, që e dëgjoj tek flet me veten. Ose me të. Nuk e di. Ajo që di është dhimbja që ia gjej të fshehur brenda syve. Përpiqet ta fshehtë prej meje duke buzëqeshur hidhur, por dielli s'mund të mbulohet me shoshë.

Më në fund, dje doli nga kështjella. U përpoqa ta kap për dore, pasi fuqitë e kanë braktisur me kohë, por s'më dëgjoi dhe mori drejt një qosheje ku s'kisha qenë me parë.

Tek e prekja murin, u habita nga lagështia e tij e freskët, pasi dielli jashtë shkëlqente fillimin e pranverës. U ktheva të pyes babanë, por ai qe larguar pak me tujtje. Aty habia ime u shtua edhe më, pasi ai po lotonte...

Atëherë e kuptova. Të gjitha. Kuptova mbi ç'themel qëndronte ajo kështjellë, ai qytet. Kuptova mbi ç'themel qëndronte i gjithë njerëzimi.

Me lot në sy bëra ta përqafoj, por sakaq e ndala hapin.

Ai po përqafohej me dikë tjetër. Dhe zotat po i shihnin bashkë me mua.





Gottman

Hyrje e shkurtër në kokën e Gottmanit

Gottmani asnjëherë nuk e kishte kuptuar atë shprehjen e lashtë, se si njeriu nuk shkel dy herë në të njëjtin lumë.

Deri dje, kjo i qe dukur si një lojë fjalësh, e cila ua gënjente mendjen njerëzve vetëm ngaqë tingëllonte bukur. Në të vërtetë, kishte menduar ai, ndryshe nga ç'dëgjonte rëndom, ajo shprehje nuk kishte ndonjë urtësi në vetvete. Por sot e mendonte ndryshe. Nuk është se kishte ndodhur diçka konkrete që e kishte bërë të ndërronte mendim. As s'ia kishte mbushur kush mendjen me ndonjë oratori të zotë.

Nëse ai kishte diçka zët, ato ishin fjalët e bukura e të stërzgjatura, sjellja në jetë e të cilave ishte një shenjë e qartë e paqartësisë se folësit. Çdo gjë mund të thuhej thjesht, nëse personi që shpjegonte e dinte mirë se për

çfarë fliste. Në të kundërt, në të njëjtën mënyrë siç përpiqemi të kemi sa më shumë njerëz në krahun tonë kur besojmë në diçka, pasi sa më shumë mbështetës të kemi, aq më pak të pasigurt ndihemi, po ashtu edhe e folura e pafund ishte një simptomë e dukshme e pakthjelltësisë së personit.

Pra, nuk ishin këto arsye pse Gottmani kishte ndryshuar mendje. Se çfarë ishte, këtë nuk mund ta them as unë, pasi në të vërtetë në jetën e tij nuk kishte ndodhur ndonjë gjë që mund ta cilësojë si pikëndryshim.

Përkundrazi, ajo pikë, e cila zakonisht hamendësohet si ngjarje konkrete në kohë e hapësirë, në fakt shtrihej përgjatë gjithë jetës së Gottmanit. Mund ta mendoje si një lloj evolucioni në miniaturë, e se në asnjë pikë të vijës së jetës s'mund të bësh me gisht drejt çasteve kur ndodhin ndryshimet. Ato, shpeshherë, mund të shfaqen vonë; efektet e tyre mund të jenë të vonuara; pasojat e një shkakut të shtrirë përgjatë një jete të tërë mund të shfaqen veçse në vdekje. Pra, pa e zgjatur më, për një arsye të mistershme, ajo shprehje e vjetër tashmë kishte marrë kuptimin e saj të vërtetë: lumi s'kish si të ishte i njëjtë në asnjë sekondë të rrjedhjes së tij, pasi ai rrjedh, e gjërat që rrjedhin kanë në palcën e tyre atë që e bën jetën të sillet rreth vetes e të mos lodhet kurrë; po flas për ndryshueshmërinë.

E njëjta gjë vlen edhe për njeriun. Vetëm një kokëgdhe, i cili e gjen vlerën e jetës tek absolutja, guxon ta mbajë veten si një kënd absolut brenda një rrethi. Ky



kokëgdhe mund ta bindi veten sa të dojë për fronin e tij në mbretërinë e së pandryshueshmes, por mjafton të shikohet një herë në pasqyrë që të kuptojë se vetë rrudhat në fytyrë ia tradhtojnë besimin e tij më të thellë; gjë që tregon se themelet e një besimi, që të jenë të vërteta, duhet t'i mbijetojnë kohës dhe asaj çka ajo zbulon. Në të kundërt, e vetmja gjë që e mban besimin të gjallë është deluzioni.

Gottmani nuk binte pre e deluzioneve të të tjerëve; zakonisht ai ishte aq i mprehtë, sa mjaftonte të shikonte sytë e folësve për të kuptuar se cilat fjalë mbështillehin nga manteli i gënjeshtërs. Sytë, sipas tij, ishin ata që e tradhtonin atë njëri që përpiquej të tradhtonte. Një lëvizje e gabuar dhe perdja e gënjeshtërs binte përto-kë, duke zbuluar, për një çast fare të shkurtër, atë që fshihej pas të gjitha fjalëve. Kishte syresh që dinin t'i kontrollonin sytë goxha mirë; ua kishin kuptuar të gjitha hilet dhe shkonin deri në atë pikë sa nënvetëdijen e syve ta bënin të vetëdijshme. Por edhe këta, pas njëfarë kohë binin në grackën e lodhjes dhe, për të marrë pak frymë, ia lëshonin frerët vetes. Pikërisht këtë pristte Gottmani. Por ngaqë si ligj natyre njeriu s'mund të kafshonte dhëmbët e vet, as Gottmani nuk mund ta kapte veten në ato veprime që aq shumë i urrente tek të tjerët. Deluzionet që ua zhvishte atyre, rrallë dinte t'i njihte tek vetja. Për shumë njerëz kjo është hipokrizi, por për të qenë i tillë, njeriu duhet të jetë të paktën i vetëdijshëm, dhe personazhi ynë nuk ishte i

tillë. Ai ishte i pavetëdijshtëm mbi shumë veprime të tijat, e një njeri i këtij soji, sado i vërtetë që mund të jetë në gabimet që u zbulon të tjerëve, nëse s'është i vërtetë me veten, atëherë fjala e tij pak vlerë ka. Këtu nuk duhet të ngatërrohem i mes koncepteve të vlerës dhe së vërtetës. Gottmani mund t'ua thoshte të vërtetën njerëzve, por nëse këta të fundit e kuptonin se ai kur-sente veten, atëherë ajo e vërtetë zhvlerësohej. Sado e vërtetë që mund të ishte kritika, duke qenë e pabarabartë, ajo kthehej në gënjeshtëri. Kjo ishte në favor të personave të kritikuar nga Gottmani, pasi nëse për një çast ata ndiheshin keq me veten e bëheshin të vetëdijshtëm për një gabim në qenien e tyre, kur e kuptonin se ai që po i kritikonte ishte dikush që nuk besonte në atë që thoshte, atëherë, si me magji, ata pushonin s'u ndjeri keq, dhe vetëdija e fituar kthehej përsëri në formën e saj të mëparshme; e thënë ndryshe, ia fuste përsëri gjumë. Pra, dielli nuk mbulohet me shoshë vetëm me anë të një deluzioni të fortë, por edhe nga e vërteta që nuk e kupton vetveten.

Edhe pse vetëdija e tij ishte goxha e dobët, Gottmani sidoqoftë e kishte njëfarë ideje për të. Për ngushëllim, ai zakonisht e bindte veten me idenë se edhe vetë filozofët, këta kampionë të mendimit, nuk u shkonin deri në fund fjalëve që thoshin. Sa filozofë që reflektojnë mbi vetëvrasjen keni parë që e kanë çuar mendimin e tyre deri në pikën më të fundit të veprimit, që të provojnë teoritë e tyre? Sigurisht, nëse do e çonin veprën



deri në fund, atëherë ata s'do të ishin rrotull për t'u ndjerë mirë mbi vërtetësinë e asaj që thonë.

Dhe kjo nuk është diçka tunduese. Pavarësisht mijëra ideologjive, njeriu mund ta provojë kënaqësinë a athtësinë e triumfit vetëm nëse është gjallë. Do të ishte diçka jubilarë nëse një i vdekur do të kthehej nga tjetërbota për t'ia plasur në fytyrë kundërshtarëve të vërtetën. Madje dyshoj se i vdekuri, nëse do guxonte ta bënte atë hap, do e harxhonte kohën e rifalur për t'ju kthyer betejës së fjalëve që kish pasur para se të vdiste. Gottmani është dakord me mua në këtë pikë. Nëse i vdekuri do të kthehej në jetë, trupi i tij do të kërkonte të vetmen gjë që kishte mësuar para mendimit: jetën. Gottmani të vetmen gjë para racionales vendos irracionalen. Për të mos rënë në keqkuptime, kjo duhet shpjeguar.

Nuk mund të biem në idenë e gabuar se Gottmani parapëlqente më shumë atë që s'mund të shpjegohej, sesa atë që e kishte tashmë një shpjegim. Ajo që doja të thosha ka të bëjë me disa lloje ndjesish që nuk është se e vendosin në rrezik arsyen njerëzore, por që sidoqoftë kjo e fundit nuk mjafton për t'i shpjeguar të plota. Njeriu mendon në fjalë, arsyeton Gottmani, dhe është goxha e vështirë që ai të mendojë në një formë ndryshe (përveç imazheve, të cilat sidoqoftë ligjërohen nga ai zëri brenda kafkës). Fjalët pastaj krijojnë arsyen e tij. Por ka ndjenja dhe emocione të cilave nuk u mjafton simboli, por kërkojnë diçka me

shumë. Dhe është pikërisht kjo *diçka me shumë* që e detyron Gottmanin ta vendosë arsyen poshtë tyre, pasi nëse arsyeja s'mund t'i shpjegojë, atëherë i bie që dimensionin e këtyre ndjesive të jetë pak më i lartë se i saj. Në këtë rast, unë pyes veten se ç'janë këto ndjesi? Nëse hamendësoj se janë ndjenja madhore e hyjnore, jam gabim. Ato janë emocione të së përditshmes, por që për një arsye a tjetër, nuk dinë të përkthehen në fjalë. Janë ato ndjesi që sjellin në jetë poezitë, të cilat lindin nga emocionet e pashpjegueshme e të mjegullta. Kjo është dhe arsyeja pse Gottmani i dashuronte poemat. Ato, bashkë me muzikën, ishin manifestimi i diçkaje të pakuptueshme tek vetja që sidoqoftë të bënë ta kuptojë veten më shumë. Jeta e Gottmanit mëtonte të sille rreth të tilla paradokseve.

o o o

E thashë mirë: ishte jeta e tij që i kërkonte paradokset dhe jo Gottmani. Dhe kjo ndodhte ngaqë vetëdija e Gottmanit nuk mund ta honepste për asnjë çast idenë se nënvetëdija e tij dinte ca gjëra më shumë. Pra, nëse ai e lejonte jetën të rridhte në rrjedhën e vet, ideja që trupi po i merrej para nga një lumë mbi të cilin nuk ushtronte asnjëfarë kontrolli, e bënte të ndihej i pafuqishëm. Nëse nga njëra anë Gottmani urrente absolu-



ten, nga ana tjetër ai dëshironte kontrollin.

Këtu dalim tek ajo që thamë pak më sipër, se si ai, pa e ditur, ishte i rrethuar nga paradoksi. Të urresh absoluten, e njëkohësisht të duash kontrollin, nuk e di në do të këtë kundërshtim me të madh se ky, pasi vetë ideja e kontrollit është absolutja. Të jesh nën komandën e çdo ngjarjeje, jo vetëm tënden, por edhe të mjedisit përreth, kjo është detyra e zotave, dhe këta të fundit janë definicioni i absolutes.

Është e pamundur që Gottmani të ketë një fuqi kaq të madhe në trupin e tij, pasi pavarësisht se sa e shtrëngon atë trurin e tij të shtrenjtë për të mbajtur universin nën kontroll, sapo të dalë në rrugë, mjafton që një makinë apo një biçikletë të bëjë një kthesë të gabuar dhe universi shkërmoqet. E thënë ndryshe, ngaqë numri i variableve të ngjarjeve që ndodhin është gati-gati i pafund, Gottmani e ka të pamundur t'i llogarisë të gjitha, e aq më pak t'i vendosë nën këmbën e tij totalitare. (Si unë, ashtu dhe Gottmani, kemi një urrejtje të veçantë për fjalën e fundit që përdora, por nëse na duhet të jemi të vërtetë, vetë tentativa për të kontrolluar procesin e jetës mban në vetvete cifla të diktaturës, dhe vetë mohimi i vazhdueshëm ndaj rrjedhshmërisë së pakontrollueshme të atij procesi, edhe pse në fillim mund të duket si një rebelim i përligjshëm, ashtu siç duken të gjitha rebelimet në fillim, më pas ai mund t'i humbasë premiset e para, e siç na tregon historia, rebelimi kthehet në revolucion e revo-

lucionit në mbretërim; pra, nuk bëhet gjë tjetër veçse hidhet nga fronti një mbret që të ulet një mbret tjetër).

Vallë përse kërkon Gottmani të ketë nën thembra jetën? Në fund të fundit, njeriu do kontroll mbi diçka vetëm nëse ajo i shkakton vuajtje ose i ndjell urrejtje. Nëse ndjen lumturi, ai as që mendon përse, por thjesht ndjen. Dhe kjo i mjafton. Pra, diçka e shqetëson Gottmanin.

Si pasojë e këtij shqetësimi të paemër, Gottmani përpiket të kontrollojë gjithë ç'ka ndodh në jetën e tij: të tashmen, të ardhmen... Ndodh që ai përpiket të kontrollojë edhe të shkuarën, dhe kjo po, që është diçka për të cilën ja vlen të flitet, pasi e shkuara, në vetvetë, është diçka absolute; ajo që ka ndodhur, ka ndodhur. Por edhe absolutja, kur është nevoja, mund të ndryshohet. Një veprim ndodh e s'mund të mohohet nga askush. Por mund të mohohen arsyet e atij veprimi, mund të ndryshohen a përçudnohen qëllimet e tij. Gottmani mund të ndihmojë një njëri, e më pas t'u thotë njerëzve se ai e bëri atë veprim si pasojë e dashurisë së tij për njerëzimin, e se një njëri që vuan është i gjithë njerëzimi që vuan, por ekziston dhe mundësia që ai ta ketë bërë këtë veprim vetëm e vetëm që ta ketë mundësinë t'u *tregojë* të tjerëve mbi dashurinë e tij për njerëzimin. Por ngaqë kjo e fundit është kaq e fshehur, kaq e vështirë për t'u pranuar, Gottmani tenton (dhe ia del) ta ndryshojë qëllimin e vërtetë të një veprimi të së shkuarës dhe si pasojë, e shkuara ndryshon. Po



e përsëris, nuk ndryshon veprimi dhe pasojat e tij fizike. Ndryshojnë vetëm idetë dhe emocionet rreth atij veprimi, të cilat mund të manipulohen fare lehtë.

Në fund të fundit, nëse ne i ndryshojmë mendimet dhe ndjenjat rreth një ngjarjeje të ndodhur dje, atëherë ajo ndodhi ndryshon bashkë me to. Shembulli perfekt i kësaj mund të jetë një vrasje në rast vetëmbrojtjeje. Nëse e marrim veçan konceptin e vrasjes, të gjithë biem dakord se ky veprim duhet ndëshkuar. Por mjafton të shtosh motivin e saj, dhe e gjithë historia ndryshon. Pra, vdekja është që është. Nuk shkon gjëkund. Ndëshkimi, ama, ndryshon. Dhe ai ose ajo që vrau për t'u vetëmbrojtur, nëse pak më parë e kishte të sigurt të ardhmen e tij në burg, tani është i lirë, pasi veprimi i tij përligjet nga motivi.

E thënë ndryshe, duke rrëmuar në të shkuarën, nga që Gottmani e di se nuk është zot që të ndryshojë atë që ka ndodhur njëherë, sidoqoftë e merr vendin e këtij të fundit duke ndryshuar pasojat dhe efektet metafizike të së shkuarës. Abrahami u bë gati ta vrasë fëmijët e vet, Isakun, për të treguar dashurinë dhe nënshtrimin absolut ndaj zotit; ose Abrahami u mashtrua nga mendja e tij që fantazonte zëra zotash, e që gati të bënte një ndër krimet me të tmerrshme njerëzore. E parë nga ky këndvështrim, e kaluara është veçse një manekin lakuriq që vishet e zhvishet sipas interesit, qoftë ai fizik apo shpirtëror.

Flutura dhe stuhitë e saj

Një ditë, tek po bënte asgjë, Gottmanit i ra një pjesëz e dhëmbit të parmë në tokë. S'ishte gjë e madhe, thjesht një copëz, por kjo mjaftonte që gjuha t'i rrëshqiste gjithë ditën e ditës në gropëzën e re të gojës së tij. E lëpinte nga të gjitha anët, ia njohu gjer dhe cenet më mikroskopike, e edhe pse një zë i thoshte që të shkonte te dentisti, një zë tjetër, pak më i fortë e këmbëngulës, i thoshte që ta linte ashtu, të shikonte se si ndryshonte sjellja e tij përballë njerëzve. Që një gjë kaq e vockël, e cila fshihej me një mbyllje të gojës, të kishte impakt mbi marrëdhëniet folëse të Gottmanit me njerëzit, kjo për të ishte si një shaka, pasi ai e mendonte veten të sigurt në vetvete. Por ja që s'ishte ashtu. Siguria u shkërmoq me të parën herë që i erdhi rasti, e goja, ajo gojë që dashuronte të fliste, të qeshte, të tallej dhe të ironizonte koncepte nga më të voglat e deri të me grotesket, s'bëri gjë tjetër veçse mbeti e mbyllur. Në këtë rast, njeriu detyrohet të reflektojë mbi efektin e krahëve të fluturës dhe stuhive që ato shkaktojnë. Përtej Gottmanit, vallë sa gojë janë kyçur e sa duar janë burgosur, qoftë dhe për një çast fare të shkurtër, si pasojë e një cifle mikroskopike, e cila shumicën e kohës mund të këtë qenë e padukshme, jo në dritë të diellit si dhëmbët e një buzëqeshjeje, por e fshehur thellë në ndonjë skutë të mendjes a shpirtit,



aty ku s'arrihet prej askujt veç personit që e ndjen!

Sidoqoftë, Gottmani mundi të përfitojë disi nga kjo ndodhi e vogël. Në fakt, nga çdo ndodhi mund të përfitohet në një mënyrë a tjetër. Gjithmonë nëse personi është i hapur ndaj mësimave të pazëshme që ajo afron. Dhe Gottmanin, heshtja e rënë papritur nga një aksident banal siç është rënia e një cifle dhemb, nëse ia mbylli gojën, njëkohësisht e bëri të kuptonte se ç'rol kishte pasur ajo në jetën e tij.

Gjithmonë kishte dëgjuar se organi kyç i trupit, mbi të cilin madje bëheshin dhe betimet më të zjarrshme, ishte syri, dhe frika ndaj errësirës e kishte detyruar të mos e vinte kurrë në dyshim këtë gjë, por tani nuk ishte më i sigurt. E vërtetë, pa syrin bota do të mbetej gjithmonë jashtë teje, s'do mundje ta shihje me qiellin, detin, malet, harkun ndjellës të belit të një gruaje, e pa këto jeta s'ish jetë, por ç'të duhej syri, nëse nuk kishe gojë që t'i flisje asaj gruaje që ta bëjë belin e saj për vete? Ç'të duheshin qielli dhe deti nëse gjithë ç'ka ndieje përbrenda ndalej në kufirin e fytit, e kthehej përsëri mbrapsht, për të vdekur në varret e stomakut? Jeta mund të ishte e plotë vetëm nëse mund të flisje për jetën, vetëm nëse zhyteshe në të, e jo të ishe thjesht një spektator, që veçse e sheh nga televizori i syve. Vetë udhëtimi prej lindjes gjer në vdekje s'ishte gjë tjetër veçse një odise e gjetjes së zërit tënd. S'kish filozof që s'na e kishte lenë këtë mësim.

Rëndësinë e këtij mësimi Gottmani e kish hasur edhe

në një rast tjetër, por në atë kohë nuk i kishte kushtuar shumë vëmendje. Bëhet fjalë për një filozof të Perëndimit, i cili shpjegonte mësimet e filozofisë Lindore. Në fillim i kishte lexuar disa libra dhe disa mësimet të vyera i kishin ngecur në kujtesë, si për shembull: njerëzit e Perëndimit s'mund ta analizojnë kulturën e tyre duke pasur si subjekt studimi vetëm kulturën e tyre. Krahassimi vlen atëherë kur ka një subjekt të dytë a të tretë. Pra, Perëndimi, që ta kuptojë vetveten, duhet të vendoset përballë Lindjes; mua më duhet gjithmonë *Tjetri* nëse dua të kuptoj *Veten*... Por këto fjalë, sado goditëse, nuk kishin pasur efektin e duhur deri në çastin kur Gottmani kishte dëgjuar zërin e filozofit, mënyrën se si thuhej fjala, intonacioni dhe vendosja e theksit në ato zanore që përmbanin gjithë esencën e kumtit, e pastaj e qeshura e tij, e cila kumbonte nëpër sallat ku jepte leksione, e qeshur që mbante në vetvete mësimin më të vyer, që mos t'i merrnin seriozisht ato që ai thoshte, që ai nuk ishte aty për të predikuar por për të treguar një prej pikturave të universit që kishte rastisur t'i pëlqente, e nëse dikush tejet serioz do e pyeste se vallë përse fliste atëherë, ai do ia kthente duke qeshur se s'kishte rrugë tjetër. Ishte përtej tij. Ashtu siç këndonin zogjtë, ashtu siç zhurmonte ujëvara, ashtu dhe ai fliste. Prandaj, që nga ai çast, për Gottmanin shkrimtar i mirë ishte ai ose ajo që zërin e vet e kishte dhe në zërin e shkruar. E thënë ndryshe, po ai zë që ia kishte diktuar fjalët shkrimtares, t'ia lexonte fjalët



edhe Gottmanit. Vetëm atëherë përcillej i plotë kumti. Vetëm atëherë mund ta kishe shpirtin e një libri brenda teje. Rastet e tjera ishin veçse gjymtime të së plotës, pjesëza të nxjerra nga konteksti, skica bardhë e zi të një pikturë shumëngjyrëshe, një Mona Lizë pa buzëqeshjen e saj enigmatike.

o o o

Pavarësisht kësaj që thamë, Gottmani nuk ishte aq naiv sa t'i vendoste organet përballë njëra-tjetrës, pra t'i krahasonte.

Ata nuk ishin kultura, dhe Gottmani e dinte se nuk kishte ndonjë organ që ishte superior ndaj të tjerëve. Në fund të fundit, njeriu mund të vdiste edhe nga apendiciti, i cili në dukje s'është se ka ndonjë funksion madhor. Është njeriu ai që ua cakton atyre rëndësinë apo vlerën. Për të cituar Shekspirin te Hamleti: «Nuk ekziston as e mira e as e keqja, ato krijohen nga të menduarit.» Sigurisht që kjo shprehje tingëllon bukur në rrafshin teorik, por në atë praktik njeriu i thjeshtë s'di të bëjë gjë tjetër veçse t'i ndajë gjërat në këto dy kategori. Dhe siç e thamë diku më sipër, vlera që njeriu i jep syrit mund të faktohet dhe nga mizëria e shprehjeve folklorike për të. Por sytë sidoqoftë janë pasive. Ata janë spektatorë. Veçse marrin

informacione, e ndonjëherë, atëherë kur goja hesht, mund të japin ndonjë sinjal të vogël me një mbyllje të shpejtë të qepallave ose me ndonjë shkëlqim dashurie, por në rastet e tjera, marrëdhënia e tyre me botën është njëkahëshe. Nëse shikohet diçka që s'duhej parë, nëse goja vendos të heshtë, sekreti mund të vdesë bashkë me dëshmitarin (të shkruarit është veçse një tejzgjatje e gojës për të arritur epokat e së ardhmes, ashtu siç dhe teleskopi është një tejzgjatje e syrit për të arritur hapësirat e pafundme të universit). Nga kjo rrjedh që strumbullari i çdo gjëje është goja. Ajo vendos verdiktet e historisë. Ajo e afron ose largon hënën, e si pasojë vendos se kur duhet të ketë baticë e kur zbaticë. Gottmani as që ia ka idenë e syve të Niçes, por goja e tij i pëshpërit gjatë gjithë kohës në vesh. Madje, edhe tek vrasjet më banale, ato që lindin vetëm nga një shikim, nëse njëri s'do të thoshte: «Pse më shikon?», tjetri s'do të ishte sot i vdekur para kohe.

Ndoshta prandaj, mendon Gottmani, e donin disa filozofë heshtjen aq shumë. Mungesa e predikimit heq përgjegjësinë nga shpatullat e predikuesit. Por heshtja shikohet nga filozofë të tjerë si bashkëpunëtore e së keqes.

Të mos flasësh atëherë kur goja jote mund të heshtë një luftë, është në vetvete një krim moral me pasojat të tmerrshme fizike e shpirtërore. Si rrjedhojë, Gottmani jo rrallë e gjen veten në mesin e një lufte të



brendshme, verdikti i së cilës mund të këtë pasoja të jashtme. Një flutur mund t'i rrahë krahët në Antarktidë, e të shkaktojë një stuhi në shkretëtirë. Por stuhinë, në fund të fundit, janë esenca e ndryshimit, e prerja e krahëve të një fluturë, nëse nga njëra anë parandalon stuhinë, nga ana tjetër lejon që shkretëtira të vazhdojë mbretërimin.

Por Gottmanin e shqetëson dhe diçka tjetër, që shumë mirë mund të lidhet me shprehjen e famshme të shkretëtirave: «Dunat ndryshojnë, por shkretëtira mbetet e njëjtë.» Goja duket sikur ndryshon kahet e historisë, por kjo duket se ndodh vetëm në të shkuarën. Vetëm kur shikon pas mund të shohësh që kjo gojë a tjetër gojë ia ka ndryshuar kahun lumit, ndërsa në të tashmen kjo duket e pamundur.

Në të tashmen mund të ndryshohet një dunë, por pafundësia në dukje e shkretëtirës të tremb. Dhe njeriu s'mund të presë me qindra vite që ta shikojë shkretëtirën të ndryshuar. Ai e do të ndryshuar brenda jetës se vet. Do që ta shohë frytin e lodhjes se tij. Do që ta shijojë triumfin e asaj që bën goja e tij. Pikërisht kjo mund të jetë dhe arsyeja pse ai e kalon kohën duke u marrë veç me dunat, e nuk fokusohet tek rrënja, tek vetë shkretëtira. Tri sekonda triumf kanë më vlerë se e ardhmja e fëmijëve të vet.

o o o

Mbi të gjitha, goja është ajo që e fakton ekzistencën e Gottmanit si Gottman. Sytë mund të dashurohen, por është goja ajo që shkëmben lëngjet e trupave, është goja ajo që në fakt mund të ndryshojë atë që sheh syri, i cili që nga lindja evolucionare është organ naiv, kaq lehtë i gënjeshtë nga iluzionet, nga besimet e vetvetes se ajo që ka parë është ajo që mendon se ka parë, që do të thotë se ajo çka shihet, më shumë se nga vetë objekti i jashtëm, varet nga mënyra sesi perceptohet nga individ. Këtu Gottmanit i vjen ndërmend ajo thënia e vjetër, që në jemi ajo çka shohim, e cila mund të kthehet kaq lehtë kokëposhtë: «Në shohim atë që jemi». Por kush e vendos se kush jemi? Ose, për ta thënë më mirë, kush ka më së shumti pushtet që të krijojë, ndryshojë, përçudnojë a nënshtrojë atë që jemi? Për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje, Gottmanit s'i duhet të bëjë gjë tjetër veçse të kujtojë qindra gojët që kanë shkruar mësimet e jetëve të tyre mbi trupin e jetës së tij.

Njeriu–Zot

Këta kapituj janë veçse pjesëza të mendjes së Gottmanit, pasi është e pamundur të shkruhet në letër një



mendje e tërë; nga cילו kënd që ta shohësh, ajo shfaqet e pafundme.

Për më tepër, edhe rrëfimi në mënyrë lineare është goxha i vështirë, pasi mendja e tij kërcen sa nga njëra ide në tjetrën pa mundur që ta kontrollojë dot procesin e mendimit as ai e as unë. Ja pse këta krë të vegjël janë shkruar në këtë rrëmujë të pakuptimtë. Në njëfarë mënyre, ata janë metaforë e rrëmujës në mendjen e tij.

o o o

Gjatë jetës së tij të shkurtër, Gottmani ka parë shumë ëndrra, që nga më të frikshmet e deri tek ato më të ngarkuarat emocionalisht, pas të cilave i duhej një ditë e tërë ta merrte veten. Kur e krahason me këto, ëndrra për të cilën do flas mund të duket fare e rëndomtë; pa aksion, pa biseda, pa ndjekje me vrap apo rënie nga lartësia, pa profetizime për të ardhmen apo ndriçime të errësirave të së shkuarës. Ndryshe nga ëndrrat e zakonshme, ku njeriut i duket se kalon me orë të tëra në një ëndërr të caktuar, kur në të vërtetë në realitet e gjitha zgjat vetëm pesë sekonda, ëndrra që kam zgjedhur zgjat me të vërtetë pesë sekonda.

Në këtë aspekt ajo i ngjan krejt realitetit të jetës së njëmendtë. Në aspektet e tjera, gjithçka është e kun-

dërta e jetës, për faktin e thjeshtë se do të ishte fort e çuditshme nëse do e gjeje veten në një fushë të stërmadhe pa njerëz, pa ndërtesa, pa male, pa planet, pa diell, pa yjet e tjerë, pra pa asgjë, e si pasojë e mungesës së gjithçkasë që njihet, edhe pa kohë.

Kur u zgjua, ai qe bërë qull në djesë, gjë që e çuditi, pasi ajo ëndërr nuk e kishte frikësuar dhe aq, veçse i qe dukur disi e çuditshme.

Por më vonë, kur domethënia e saj u përtyp disa herë nga nënvetëdija e tij, ai arriti (ose mendoi se arriti) të mendonte njëfarëlloj shpjegimi. Për këtë i erdhën në ndihmë mësimet e filozofisë lindore mbi kohën dhe iluzionin madhështor që sillet rreth saj.

Sipas Gottmanit, ëndrra po i thoshte se e gjithë esenca e kohës ishte përsëritja. Ajo fushë pa njerëz, pa male e yje ishte imazhi i botës nëse hiqje njerëzit, malet dhe yjet.

Arsyeja pse njeriu e ndjente peshën e kohës mbi supe ishte rrotullimi i objekteve rreth vetes ose rreth njëra-tjetrës; universi që fryhet e shfryhet, galaktikat që rrotullohen rreth vrimave të zeza, planetët që rrotullohen rreth diellit, stinët që i rikthehen, ditët që alternohen me netët për t'ju rikthyer përsëri ditëve, akrepat e orës që luajnë përjetësisht me vetëm dymbëdhjetë numra, fryma që bën e do bëjë të njëjtin ritëm derisa t'i vijë vdekja... Hiqjani të gjitha këto dhe Gottmani do e gjeje veten përsëri në ëndërr, në mesin e një fushe ku koha s'ka kuptim, ku ora s'ka as fund



e as fillim, pasi fundi e fillimi i saj janë një pikë e cila shtrihet kudo.

o o o

Përfundimi i parë që nxirret nga kjo ide ka të bëjë me rrafshin teorik të kaosit; diçka që nuk shërben dhe aq në jetën e përditshme, por që sidoqoftë i eksiton ato pak mendje teorike si ajo e Gottmanit... Kjo ide na tregon se universi ynë, i cili në rrafshin kozmik na shfaqet si një kaos i pazgjidhshëm, e ka sidoqoftë njëfarë rregulli pikërisht si pasojë e *përsëritjes* së proceseve brenda tij. E thënë ndryshe, kaosi që përsëritet nuk është kaos, pasi përsëritet.

Përfundimi i dytë është me praktik, por që, siç ndodh rëndom me Gottmanin, është gjithashtu dhe paradoks.

Për Gottmanin vetë jeta është përsëritje, e ai pikërisht kësaj përsëritjeje përpiket që t'i arratiset... Ngaqë ditët e tij, si çdo njeriu që e humbet mendësinë e fëmijërisë, kanë filluar t'i ngjasojnë njëra-tjetrës, i lodhur që i ri nga rutina vrastare e civilizimit perëndimor, ai ndihet si i burgosuri i një qelie pa mundësi arratisjeje. Dhe në atë qeli nuk janë vetëm ditët të njëjta. Janë dhe mendimet. Është dhe e njëjta dritare pranë se cilës mblihet i gjithë njerëzimi. Janë të njëjtat gojë që

mbllaçisin të njëjtat mite që nga fillimi i historisë. Është e njëjta mënyrë jetese, që rrihet e rrihet si një kalë i ngordhur qysh kur s'mbahet mend (pikërisht ai kali që donte të shpëtonte Niça). Dhe si t'i shpëtojë Gottmani këtij paradoksi? Si të dalë ai nga qelia ku e kanë hedhur pa e pyetur, pa i dhënë asnjë copë shpjegimi, pa i dhënë madje as të drejtë zgjedhjeje? Si të jetojë ai një jetë që s'është jetuar (përsëritur!) me qindra herë? Si ta gjejë ai një jetë të veçantë, të rrallë, unike si shenjat e gishtave të tij, të cilët i mbledh grusht sa herë që ndjen revoltën ndaj absurdit të kësaj qelie?!

Por revolta e tij nuk është vetëm ndaj jetës? Është edhe ndaj meje, krijuesit të tij...

Siç Gottmani e di, emri i tij nuk është një fjalë që ekziston në vetvete, por është bashkim i emrave gjerman Gott dhe Man, të cilët përkthehen përkatësisht në Zot dhe Njeri. Pra, Gottmani është Njeriu-Zot. Pikërisht këtu ngrihet Gottmani kundër meje, pasi ai vetëm si zot që nuk ndihet...

Por ç'është një zot? Si mund të jetë njeriu zot? Dhe zot i çkaje?

Këto pyetje kanë mijëra përgjigje. Por unë do zgjedh atë që ma bën Gottmanin pak më të afërt, pak më të shpjegueshëm.

Një ndër funksionet e një zoti është kontrolli total, qoftë ai ndaj vetes apo ndaj subjekteve që ka krijuar. Këtu na shfaqet përsëri kontrolli, kjo dashuri e vjetër e Gottmanit, e cila në dritën e këtij arsyetimi të ri, na



shfaqet ndryshe; nuk na shfaqet më si një dëshirë që ndjell nevojën për t'ju kundërvënë jetës, por si nevojë që lind nga dëshira për t'u arratisur nga qelia ku e ka hedhur jeta.

Por Gottmanin nuk e ka hedhur jeta në atë qeli. E kam hedhur unë. Dhe vetëm unë mund t'i përgjigjem pyetjeve të tij...

o o o

Për ta hedhur Gottmanin në letër, më duhet ta tkurr universin e tij brenda disa ngjarjeve e mendimeve të kufizuara; kufizimi i tyre fillon tek fakti se ata ndodhin në një planet mes miliardave të tillëve, i ndodhin një njeriu që ka lindur në një copë tokë të atij planeti, vendndodhja dhe kufijtë e së cilës e paravendosin një pjesë të mirë të jetës së tij (këtu Gottmanit i kujtohen fjalët e gjyshes, kur në raste fatkeqësie i thoshte se kishte edhe më keq se aq, si për shembull të kishte lindur në Afrikë; për të Afrika ishte sinonimi i varfërisë së tejskasshme). Pastaj është lloji i familjes ku lind, mendësia, gjendja e saj financiare, që ndikon në llojin e edukimit, në llojin e shoqërisë, në zgjedhjen e vajzave me të cilat do shoqërohet, e cila ndikon në llojet e zemërthyerjeve që s'ka kurrsesi si t'i evitojë, të cilat pastaj ndikojnë në mënyrën si do e shohë jetën.

(Pozicioni që i vihemi jetës, përballë e përkrah, shpesh varet nga këndi prej ku vështrojmë thyerjen e zemrës).

Nëse marr parasysh veç këto, Gottmani duket me të vërtetë si një i burgosur i «fatit» dhe revolta e tij është e përligjshme. Por ai harron se, edhe pse s'mund të arratiset nga qelia, sidoqoftë mund të lëvizë brenda saj. Harron se qelia nuk ka vetëm një dritare, por në fakt ka po aq sa edhe të «burgosur». Dhe së fundmi ai harron se (për të huazur dhe ndryshuar pak fjalët e një filozofi të dashur për mua) kërkimi i asaj dritareje mjafton për ta mbushur zemrën e njeriut... Nuk kam pse ta imagjinoj Gottmanin të lumtur. Më mjafton që ai të kuptojë se nëse fuqia e Zotit mund të kulmojë në Gjykimin e fundit, ku ai të shpjer ose në ferr ose në parajsë, fuqia e Njeriut–Zot gjendet tek vendimi i tij për parajsën ose ferrin brenda jetës... Të përqafojë vuajtjen e kotë të burgosjes pa arratisje, apo të kridhet në lumin e lumturisë së faktit që është gjallë pavarësisht se do vdesë: kjo është fuqia e vetme e Gottmanit... Dritarja e rrallë dhe e veçantë, që pranon vetëm sytë e tij, do të shfaqet kur ai ta kuptojë këtë fuqi. Kur ta kuptojë se një vendim lind *nga* dhe vdes *te* vetja e tij. Dhe se gjithçka do të mbetet siç është tani, nëse ai nuk flet me veten. Nëse nuk e dëgjon veten. Nëse nuk këshillohet me të. Nëse s'grindet me të. Nëse s'hahet, s'rrihet, s'bën luftë e paqe me të. Vetëm në aktin e të bërit dashuri me veten mundet Gottmani



të jetë Njeriu–Zot. Çdo gjë tjetër do ishte gënjeshtër.

Të qenit

E shoh të udhës ta mbyll këtë rrëfim të shkurtër për Gottmanin me një nga ndjesitë më sublime që ai ka përjetuar ndonjëherë. Ndjesia është pa emër. Shoqëria s'ka gjetur, ndoshta si pasojë e rrallësisë së saj, ndonjë përcaktim të veçantë për të; mund të gjesh libra të tërë që përpiqen ta përshkruajnë, e nganjëherë ia dalin disi, por gjithmonë mungon diçka, një cifël i shpëton fuqisë së fjalës, e cila edhe pse shpesh merr pamjen e mbretëreshës, pushteti i saj, si çdo pushtet i shpikur nga njerëzit, është jetëshkurtër. Ja pse pas përfundimit të këtyre librave, edhe pse në fillim zemra jote përmbytet nga qartësia, s'duhet shumë që turbullima të shfaqet përsëri, e nëse më parë do mendoje se të paktën tani je një hap më para, ndodh pikërisht e kundërta; nga ardhja e një qartësie të çastit, gjithçka e mëpasshme bëhet edhe më e turbullt. Nëse do më dëgjonte tani, për Gottmanin do të ishte e qartë se po flas për ndjesinë e të qenit gjallë.

Ndodh nganjëherë, sidomos kur je duke dëgjuar një muzikë të arrirë, që i gjithë trupi yt pushtohet nga vetëdija e ekzistencës, e në atë çast të lumë të bëhet të bërtasësh nga gëzimi, t'ia marrësh këngës me trup

e ta flasësh shpirtin me kërcim, si Zorba. Fjala këtu e gjen veten jashtë territorit të saj. Kjo është toka e trupit; universi i të bërit, jo i të thënit.

Trupi i Gottmanit, i bërë njësh me universin e shpirtit, këndon me anë të mishit; këmbët, duart, sytë, fytyra, çdo gjë e tij kërkon të shpërthejë, do që të rikujtojë edhe njëherë big bengun, çastin e lindjes... E gjithë qenia e Gottmanit mëton të rikrijojë shpërthimin e gjenezës së gjithçkaje.





Përmbajtja

Unë dhe unë	5
Diktatori.....	9
Kulla e ngujimit.....	31
Konica	43
Ligji.....	63
Predikuesi.....	83
Hakërrim	97
Jehona	115
Rozafa	121
Gottman.....	129

CIP

Biblioteka Kombëtare